FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 52

Tiranë – E mërkurë, 17 prill 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 26, datë 28.3.2019	Për miratimin e rregullores "Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të sistemeve për shlyerjen e titujve".....	3985
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 27, datë 28.3.2019	Për miratimin e rregullores "Për raportin e mbulimit me likuiditet"..	4009
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 33, datë 3.4.2019	Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e nivelit të ushtrimit të kompetencave në Bankën e Shqipërisë për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka".....	4075

VENDIM
Nr. 26, datë 28.3.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR LICENCIMIN, RREGULLIMIN DHE MBIKËQYRJEN E OPERATORËVE TË SISTEMEVE PËR SHLYERJEN E TITUJVE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b", nenit 43, shkronja "c", nenit 53, pika 4, paragrafi i fundit, dhe nenit 72, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të neneve 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 14, dhe kreut III, të ligjit nr. 133/2013, datë 29.4.2013 "Për sistemin e pagesave"; me propozimin e Guvernatorit dhe të Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të sistemeve për shlyerjen e titujve", sipas tekstit bashkëlidhur vendimit.
2. Ngarkohen subjektet e kësaj rregulloreje me zbatimin e saj.
3. Ngarkohet Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës në Bankën e Shqipërisë me zbatimin e rregullores.
4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e tij në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR
Gent Sejko

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Rregullorja synon të garantojë sigurinë, qëndrueshmërinë, mirëfunksionimin dhe efikasitetin e sistemeve për shlyerjen e titujve në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Objekti

Objekti i rregullores është përcaktimi i kritereve, afateve, dokumentacionit dhe procedurave, për:

a) licencimin e operatorëve të sistemeve për shlyerjen e titujve në Republikën e Shqipërisë;

b) dhënien e miratimeve paraprake nga Banka e Shqipërisë dhe detyrimet për njoftime nga operatorët në Bankën e Shqipërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë;

c) rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së operimit të sistemeve për shlyerjen e titujve në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Baza juridike

Rregullorja nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 1, pika 4, shkronja "b", nenit 43, shkronja "c", nenit 53, pika 4, paragrafi i fundit, dhe nenit 72, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;

b) neneve 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 14 dhe kreut III, të ligjit nr. 133/2013, datë 29.4.2013 "Për sistemin e pagesave";

c) marrëveshjes "Për bashkëpunimin për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të shlyerjes së titujve dhe shtëpive të klerimit të titujve", nr. prot. 4915, datë 5.10.2018 ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 4
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë personat juridikë që kërkojnë të licencohen si operatorë të

sistemeve për shlyerjen e titujve në Republikën e Shqipërisë.

Neni 5
Veprimtaria e subjekteve

Subjektet e kësaj rregulloreje licencohen dhe mbikëqyren për veprimtarinë e shlyerjes të titujve nëpërmjet një sistemi për shlyerjen e titujve sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për sistemin e pagesave.

Neni 6
Përkufizime

1. Për qëllime të zbatimit të rregullores, termat e përkufizuar në nenin 5 të ligjit për sistemin e pagesave kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore.

2. Në këtë rregullore, fjalët në njëjës mund të interpretohen në shumës dhe anasjelltas, kurdoherë që një gjë e tillë është e nevojshme nga përmbajtja e dispozitës ose nga konteksti.

3. Termat në gjininë mashkullore nënkuptojnë dhe gjininë femërore dhe anasjelltas.

4. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të rregullores, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Administrator" është personi fizik sipas kuptimit të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;

b) "Aktive likuide" është cash-i dhe instrumente të ngjashme me cash-in; si për shembull: certifikatat e depozitës ose instrumente të tjera të ngjashme të lëshuara nga banka, të cilat përfshijnë detyrimin për t'u rimbursuar me vlerë nominale;

c) "Autoriteti" është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

d) "Banka" është Banka e Shqipërisë;

e) "Banka e shlyerjes" nënkupton një bankë, e cila mban llogaritë në lidhje me pagesat, ku zhvillohet shlyerja e detyrimeve të cilat rrjedhin nga një sistem;

f) "Ekspozimi ndaj kredisë" është një sasi ose vlerë, në bazë të së cilës ekziston rreziku, që një pjesëmarrës nuk do të shlyejë vlerën e plotë në maturim ose në çdo kohë pas kësaj;

g) "Klerimi" është procesi i transmetimit, rikonsilimit dhe, në disa raste, konfirmimit të urdhërtransfertës përpara shlyerjes, potencialisht duke përfshirë netimin e urdhrave dhe vendosjen e pozicioneve përfundimtare për shlyerje;

h) "Kushtet ekstreme, por të mundshme të tregut" nënkupton një set supozimesh bazuar në kushtet historike dhe ato hipotetike, duke përfshirë periudhat më të paqëndrueshme të përjetuara në tregjet ku sistemi operon;

i) "Ligji për sistemin" është ligji nr. 133/2013, datë 29.4.2013 "Për sistemin e pagesave";

j) "Ofrues likuiditeti" nënkupton një ofrues të parave/mjeteve monetare ose aktiveve, i cili mund të jetë një pjesëmarrës i sistemit ose një palë e tretë/e jashtme.

k) "Operator" është personi juridik, shoqëri aksionare, që i vetëm ose në bashkëpunim me persona të tjerë juridikë, operon një sistem për shlyerjen e titujve; forma e organizimit si shoqëri aksionare rrjedh nga parashikimet për Regjistrarin në ligjin në fuqi "Për titujt";

l) "Palë të interesuara" janë pjesëmarrësit ose operatorët e sistemeve, të cilët ndikojnë dhe ndikohen, në dhe nga, rreziqet në një sistem, dhe, rast pas rasti, aktorët e tjerë të prekur (interesuar) të tregut;

m) "Rreziku i investimit" është rreziku i humbjes nga ana e operatorit ose nga një pjesëmarrës kur operatori investon burimet financiare të tij ose të pjesëmarrësit të tij, p.sh. kolateralin;

n) "Rreziku i kredisë" është rreziku që pala tjetër, qoftë një pjesëmarrës apo subjekt tjetër, nuk do të jetë në gjendje të përmbushë plotësisht detyrimet e tij financiare në maturim ose në çdo kohë në të ardhmen;

o) "Rreziku i kujdestarisë" është rreziku, i cili shkaktohet nga humbje në aktivet e mbajtura në kujdestari nga një kujdestar apo nënkujdestar, si rrjedhojë e neglizhencës, mashtrimit, administrimit të dobët ose gabime në regjistrimin e të dhënave/kontabilizim;

p) "Rreziku i likuiditetit" është rreziku që pala tjetër, qoftë ajo një pjesëmarrës apo subjekt tjetër, nuk do të ketë fonde të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e saj financiare kur ato maturohen, edhe pse ai mund të ketë fonde të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet në të ardhmen;

q) "Rreziku i përgjithshëm i biznesit" është çdo dëmtim i mundshëm i pozicionit financiar të sistemit nga pikëpamja e biznesit si pasojë e një

rënieje në të ardhurat ose një rritjeje në shpenzimet e tij, në mënyrë të tillë që shpenzimet tejkalojnë të ardhurat dhe si rrjedhojë humbjet duhet t'i ngarkohen kapitalit;

r) "Rreziku i tregut" është rreziku i humbjeve, si në rastin e pozicioneve të regjistruara në bilanc ashtu dhe ato jashtë bilancit, që rrjedhin nga lëvizjet në çmimet e tregut;

s) "Rreziku ligjor" është rreziku i cili rrjedh nga moszbatimi ose zbatimi jo i duhur i ligjeve/akteve nënligjore apo detyrimeve kontraktore, zakonisht duke rezultuar në një humbje;

t) "Rreziku operacional" është rreziku i krijuar nga mangësitë në sistemet e informacionit ose procedurat e brendshme, gabimet njerëzore, dështime në administrimin e situatave, ndërprerje të shkaktuara nga ngjarjet e jashtme ose nga shërbimet e kontraktura të cilat shkaktojnë zvogëlimin, përkeqësimin apo pezullimin e shërbimeve të ofruara nga një sistem;

u) "Rreziku principal" është rreziku që pala tjetër të humbasë vlerën e plotë të përfshirë në një transaksion, për shembull: rreziku që një shitës i një aktivi financiar të dorëzojë pasurinë në mënyrë të pakthyeshme, pa marrë pagesën, apo rreziku që një blerës financiar të paguajë për të në mënyrë të pakthyeshme, por të mos marrë aktivin;

v) "Sistem" është sistemi për shlyerjen e titujve;

w) "Sistemet e ndërlidhura" dy ose më shumë sisteme, të cilat nëpërmjet marrëveshjeve kontraktuale ose operacionale lidhin infrastrukturat/sistemet e tyre në mënyrë direkte ose nëpërmjet një ndërmjetësi;

x) "Sistemi i shlyerjes neto (DNS)" nënkupton një sistem i cili shlyen mbi një bazë neto në fund të një cikli të shlyerjes të paracaktuar, si për shembull në fund ose gjatë një dite pune. Ky sistem mund të jetë me garanci ose pa garanci, duke nënkuptuar garantimin ose jo të pozicioneve neto;

y) "Sistemi për shlyerjen e titujve" është një marrëveshje formale ose një bazë rregullative, e cila është e detyrueshme ndërmjet 3 apo më shumë pjesëmarrësish, me rregulla të përbashkëta dhe marrëveshje të standardizuara për ekzekutimin e urdhërtransfertave të instrumenteve financiare ndërmjet pjesëmarrësve. Ekzekutimi përfshin llogaritjen (klerimin) e detyrimit të pjesëmarrësve dhe shlyerjes së tyre;

z) "Shlyerje" është përfundimi/realizimi i një transaksioni ose përpunimi me qëllim përmbushjen e detyrimeve të pjesëmarrësve nëpërmjet transferimit të fondeve dhe/ose titujve. Shlyerja mund të jetë përfundimtare ose e përkohshme.

KREU II
LICENCIMI

Neni 7
Autoriteti licencues

Banka është autoriteti përgjegjës për licencimin e operatorëve të sistemit për shlyerjen e titujve në përputhje me dispozitat e ligjit për sistemin dhe të rregullores.

Neni 8
Kërkesa për kapitalin

1. Shuma e kapitalit fillestar minimal për t'u licencuar si operator i sistemit për shlyerjen e titujve është 50,000,000 lekë.

2. Kapitali minimal për regjistrarin, i cili ofron shërbime të klerimit dhe shlyerjes, duhet të jetë të paktën sa kapitali më i madh midis kapitalit minimal të kërkuar nga Autoriteti për regjistrarin dhe kapitalit minimal të kërkuar nga Banka për sistemin e shlyerjes së titujve.

3. Shuma e kapitalit fillestar minimal nuk:

a) duhet të jetë hua, kredi ose paradhënie nga subjekte të treta;

b) përfshin pagesat dhe/ose shpenzimet për blerjen ose për marrjen me qira të ambienteve dhe pajisjeve të punës për operimin e sistemit të shlyerjes për titujt.

4. Banka ka të drejtë të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime të mëtejshme lidhur me burimin/et e krijimit të kontributeve/fondeve që do të shërbejnë si kapital fillestar minimal.

5. Banka në konsultim edhe me Autoritetin, ka të drejtë t'i kërkojë në çdo kohë operatorit të rrisë kapitalin dhe burimet e tij financiare dhe të adoptojë përmirësime në procese e në procedura, për të siguruar funksionimin e sigurt, të rregullt dhe të vazhdueshëm të sistemit.

6. Kapitali minimal, së bashku me burime të tjera financiare (fitimi dhe rezervat) të sistemit,

është proporcional ndaj rreziqeve që mbart aktiviteti i kryer, dhe në çdo kohë duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar:

a) që sistemi garantohet ndaj rreziqeve operacionale, ligjore, të kujdestarisë, të investimit dhe të biznesit;

b) plotësimin e nevojave kritike gjatë ndërprerjes ose ristrukturimit të veprimtarisë për një periudhë të paktën 6 (gjashtë) mujore nën supozimet e skenarëve të stresit.

7. Operatori miraton dhe rivlerëson rregullisht politikat e nevojshme:

a) në lidhje me rritjen e kapitalit shtesë bazuar në përqasjen e kapitalit aksionar ose sipas përcaktimeve të pikës 6 të këtij neni;

b) të cilat garantojnë ndërprerjen ose ristrukturimin e veprimtarisë dhe shërbimeve në mënyrën e duhur në rastet kur nuk mund të rrisë kapitalin.

8. Politikat e përcaktuara në pikën 7 i dërgohen Bankës, e cila mund t'i kërkojë operatorit t'i rishikojë përsëri kur ato konsiderohen si jo të mjaftueshme për garantimin e një funksionimi të sigurt dhe efikas të sistemit.

Neni 9
Licenca

1. Licenca është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patjetërsueshme.

2. Licenca përfshin emrin tregtar të operatorit, emërtimin "Sistem i shlyerjes së titujve", numrin dhe datën e lëshimit.

3. Licenca miratohet dhe nënshkruhet nga Guvernatori i Bankës.

Neni 10
Kërkesa në lidhje me dokumentacionin

1. Kërkesa për licencim për sistem për shlyerjen e titujve bëhet me shkrim nga aksionarët ose administratori i subjektit (sipas formularit nr. 1, bashkëlidhur rregullores) ose nga një person i autorizuar ligjërisht prej tyre (sipas formularit nr. 2, bashkëlidhur rregullores).

2. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) statutin e shoqërisë;

b) aktin e themelimit në rastin e një shoqërie të sapokrijuar;

c) listën e aksionarëve dhe pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë, në mënyrë të tillë që të identifikohen qartë aksionarët e fundit kontrollues, vendregjistrimi i tyre dhe pjesëmarrja në kapitalin e shoqërisë;

d) ekstraktin e regjistrimit të subjektit si person juridik në Regjistrin e Qendrës Kombëtare të Biznesit[1], në të cilin të jetë e përcaktuar veprimtaria për të cilën kërkon të licencohet;

e) vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit territorial për aksionarët, administratorin dhe/ose përfaqësuesin ligjor:

i. se personi nuk është në ndjekje penale;

ii. se personi nuk është në gjykim për vepra penale;

iii. se personi nuk është i dënuar penalisht;

iv. nga Regjistri qendror i përmbaruesve gjyqësorë pranë Ministrisë së Drejtësisë, se personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera;

Dokumentet e sipërcituara duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes në Bankë.

f) dokumentacionin për kapitalin dhe burimin e tij:

i. deklaratë noteriale të aksionerëve se burimi i kapitalit fillestar të paguar të subjektit nuk është hua, kredi ose paradhënie nga subjekte të treta,

ii. deklaratë noteriale të aksionerëve mbi burimin e krijimit të kapitalit fillestar të paguar dhe për çdo shtesë të tij gjatë zhvillimit të veprimtarisë, të shoqëruar me dokumentacionin vijues: evidenca e burimit të krijimit të fondeve, e paraqitur në një formë të pranueshme ligjore (raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, bilanci kontabël vjetor, dhurata ose burime të tjera të destinuara për blerjen e aksioneve të subjektit) dhe certifikata e autoriteteve kompetente që siguron të dhëna për bilancin e shoqërisë dhe rregullshmërinë e pagesës së tatimeve dhe taksave,

iii. vërtetim nga banka ose dega e bankës së huaj të licencuar nga Banka, që subjekti ka bllokuar, në një llogari pranë saj, shumën e kapitalit të kërkuar sipas nenit 8, pika 1 dhe

[1] Ose çdo institucion i barasvlershëm ku regjistrohen bizneset.

kriteret e pikës 2 ose 3 sipas rastit. Kjo shumë zhbllokohet nëpërmjet njoftimit të Bankës, në përfundim të procedurës së licencimit;

g) dokumentacionin për aksionarët në rastin kur ata janë persona juridikë:

i. statutin dhe ekstraktin e regjistrit tregtar (për personat juridikë të huaj – aktet e barasvlefshme /ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit /juridiksionit të huaj),

ii. vendimin e organit vendimmarrës të shoqërisë për pjesëmarrjen në kapitalin e operatorit,

iii. vërtetimin nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale (për personat juridikë të huaj – aktet e barasvlefshme /ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit /juridiksionit të huaj);

h) dokumentacionin për aksionarët në rastin kur ata janë persona fizikë tregtarë ose individë:

i. për personat fizikë tregtarë ekstraktin e regjistrimit në regjistrin tregtar dhe vërtetim nga organet e tatim-taksave për shlyerjen e rregullt të detyrimeve fiskale,

ii. për individët:

- dokumentin e identifikimit (emër, mbiemër, kombësi, shtetësi), adresën e saktë të vendbanimit dhe një CV të nënshkruar;

- listën e bizneseve në të cilat aksionari ka pjesëmarrje influencuese, ekstraktin e regjistrit tregtar për secilin rast, si dhe të dhëna mbi ndonjë rast paaftësie paguese dhe/ose falimentimi;

i) dokumentacionin për administratorin:

i. vendimin e organeve vendimmarrëse të shoqërisë për emërimin e tij;

ii. dokumentin e identifikimit;

iii. CV-në e nënshkruar;

iv. diplomën universitare dhe dokumente që vërtetojnë kualifikimet e tjera të administratorit;

v. të paktën një referencë nga punëdhënës të mëparshëm;

vi. deklaratën personale për shlyerjen e rregullt të detyrimeve fiskale.

j) një përshkrim të detajuar të aktivitetit të subjektit dhe të pasqyrave financiare të audituara për tri vitet e fundit ose për periudhën e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të rastit kur është një shoqëri në proces themelimi;

k) planin e biznesit, për një periudhë jo më pak se 3 (tre) vjet, me përmbajtje si më poshtë:

i. një plan për zhvillimin dhe konceptin ekonomik të aktivitetit të subjektit, i cili duhet të bazohet në vlerësime realiste dhe të justifikojë aftësitë e subjektit për të përdorur burimet teknike dhe financiare, si dhe sistemet dhe procedurat në mënyrë të tillë që të garantojë një funksionim normal dhe të qëndrueshëm të veprimtarisë, për të cilën subjekti kërkon të licencohet; parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për 3 (tri) vitet e para të veprimtarisë bëhet sipas formularit nr. 3, bashkëlidhur rregullores;

ii. një analizë të rreziqeve ndaj të cilave subjekti dhe/ose pjesëmarrësit janë të ekspozuar ose mund të ekspozohen në të ardhmen, parimet dhe masat për administrimin e rreziqeve,

iii. një përshkrim të pajisjeve teknike dhe burimeve të nevojshme për të kryer veprimtarinë, duke përfshirë këtu sisteme të përshtatshme kompjuterike, informatike, kontabël dhe të regjistrimit;

iv. një informacion lidhur me mjediset/vendndodhjen/ambientet ku subjekti parashikon të kryejë aktivitete, pajisjet përkatëse, si dhe masat e sigurisë për ruajtjen e tyre; dhe

v. një përshkrim të organigramës, duke përfshirë skemën organizative;

l) rregullore/manuale dhe dokumente në lidhje me administrimin e sistemit duke përfshirë:

i. strukturën organizative dhe përgjegjësitë kryesore për çdo funksion ose njësi organizative;

ii. sistemet dhe procedurat për identifikimin, administrimin, kontrollin dhe raportimin e rreziqeve ku operatori i sistemit ose pjesëmarrësi janë të ekspozuar ose mund të ekspozohen në të ardhmen;

iii. sistemet dhe mekanizmat e auditit të brendshëm, procedurat administrative dhe kontabël, të cilat përfshijnë metodat dhe mjetet e monitorimit dhe kontrollit efektiv të rrezikut, duke përfshirë këtu edhe rrezikun e përdorimit të sistemit për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

iv. masat që sigurojnë vijueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e ofrimit të shërbimeve të sistemit,

v. procedurat dhe masat për një drejtim sa më të mirë të konflikteve potenciale të interesit që

mund të lindin gjatë kryerjes së veprimtarisë me palët e lidhura;

vi. përshkrim të organizimit dhe administrimit të sistemit të informacionit, duke përfshirë mënyrën e ruajtjes dhe mbrojtjes së informacionit dhe të dhënave personale për pjesëmarrësit apo për subjektet e tjera të interesuara për t'u përfshirë në sistem;

vii. rregullat e operimit të sistemit;

viii. shërbimet që operatori parashikon të kontraktojë/nënkontraktojë me palë të treta;

ix. projektmarrëveshjen tip me pjesëmarrësit, e cila përmban rregullat e përgjithshme dhe procedurat standarde për klerimin dhe shlyerjen e transfertave. Kërkuesi dorëzon të paktën tri marrëveshje të nënshkruara me tre pjesëmarrës, të lidhur me kushtin e hyrjes në fuqi pas marrjes së licencës;

x. kriteret e përgjithshme për pranimin, përjashtimin dhe mbikëqyrjen e pjesëmarrësve, si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve;

xi. përcaktimin e agjentit shlyerës dhe mënyrën e garantimit të parevokueshmërisë së urdhërtransfertës,

xii. mënyrën e pranimit të urdhërtransfertës, si dhe formën dhe strukturën e saj;

xiii. mënyrën e pranimit, si dhe formën dhe strukturën e informacionit për transaksionet në llogaritë e shlyerjes;

xiv. afatet kohore të pranimit të urdhërtransfertës, si dhe përcaktimin e çastit kur urdhërtransferta konsiderohet e hyrë në sistemin për shlyerjen e titujve;

xv. përcaktimin e çastit kur urdhërtransferta konsiderohet si e parevokueshme nga sistemi për shlyerjen e titujve;

xvi. metodat që garantojnë fondet për shlyerjen e urdhërtransfertave të pranuara në sistem,

xvii. tarifat dhe komisionet e aplikuara ndaj pjesëmarrësve/nënpjesëmarrësve.

3. Dokumentacioni sipas pikës 2 paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse në shtete të huaja, të ndryshme nga Republika e Shqipërisë, dokumentacioni paraqitet i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse.

4. Dokumentacioni dorëzohet në Bankë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar/ose forma të tjera elektronike të pranuara nga Banka.

5. Subjekti, përveç dokumentacionit të përcaktuar në këtë nen, dorëzon pranë Bankës edhe formularët nr. 4 dhe nr. 5, bashkëlidhur rregullores.

6. Formularët 1–5 bashkëlidhur, janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 11
Kërkesa për administratorët

Administratorët e operatorit plotësojnë të paktën kriteret e mëposhtme:

a) të kenë diplomë universitare ose minimalisht të kenë kryer programin e ciklit të dytë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë (në rastin e administratorëve, të diplomuar në Shqipëri), si rregull në ekonomi ose teknologji informacioni;

b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se 3 (tre) vjet, në pozicione drejtuese, në fushën financiare ose në ndonjë fushë tjetër të konsideruar të përshtatshme nga Banka;

c) të kenë reputacion të lartë etik dhe profesional;

d) të mos kenë shkaktuar ose të mos kenë qenë përgjegjës për falimentimin e ndonjë subjekti që ushtron aktivitet ekonomik;

e) të mos jenë në ndjekje penale ose të mos jenë shpallur fajtorë nga gjykata për një vepër penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore;

f) të mos kenë qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese ose falimentimit, si dhe të jenë të çliruar nga pagesa e detyrimeve pasurore të kaluara;

g) të mos jenë ndëshkuar nga Banka gjatë 5 (pesë) viteve të fundit për shkelje të rënda të legjislacionit bankar.

Neni 12
Kriteret për dhënien ose refuzimin e licencës

1. Banka merr vendim për dhënien e licencës vetëm kur krijon bindjen se operatori plotëson kërkesat e ligjit për sistemin dhe të rregullores.

2. Në rastet kur operatori do të operojë një sistem për shlyerjen e titujve si pjesë e aktivitetit të një regjistrari, operatori merr licencën nga

Banka vetëm pas licencimit nga Autoriteti për këtë veprimtari;

3. Banka refuzon dhënien e licencës kur nuk plotësohen kërkesat e ligjit për sistemin dhe të rregullores, veçanërisht në rastet e mëposhtme:

a) në gjykimin e saj, plan biznesi i propozuar nuk paraqet besueshmëri për realizimin e veprimtarisë së sistemit;

b) të paktën njëri nga administratorët nuk përmbush çdonjërin prej kritereve të parashikuara në nenin 11 të kësaj rregulloreje;

c) të paktën njëri nga aksionarët:

i. ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese ose falimentimit,

ii. nuk paraqitet informacion lidhur me identitetin e tij;

d) vërtetohet se të paktën njëri nga aksionarët:

i. është në ndjekje penale ose është dënuar nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore,

ii. është në ndjekje penale ose është dënuar nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që lidhet me pastrimin e parave ose me financimin e terrorizimit,

iii. ndaj tij është marrë vendimi nga gjykata për moslejimin e ushtrimit të profesionit;

e) nuk zotëron shumën e kapitalit fillestar minimal të kërkuar nga Banka;

f) mënyra se si do të organizohet dhe realizohet veprimtaria nga subjekti nuk trajton në mënyrë të mjaftueshme ekspozimet ndaj rreziqeve të ndryshme;

g) nuk paraqiten evidenca bindëse në lidhje me sigurimin e vijueshmërisë dhe qëndrueshmërisë në ofrimin e shërbimeve të sistemit, administrimin e sistemit të informacionit, si dhe mënyrën e ruajtjes dhe mbrojtjes së informacionit dhe të dhënave personale.

4. Banka bashkëpunon me Autoritetin, si dhe autoritete të tjera vendase ose të huaja me qëllim shkëmbimin e informacioneve dhe bashkërendimin e veprimtarive në kuadër të licencimit të operatorit për shlyerjen e titujve.

5. Banka, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së vendimit sipas pikës 1 ose 3 të nenit, i njofton subjektit vendimin për dhënien e licencës ose e njofton atë me shkrim mbi refuzimin e dhënies së saj, të shoqëruar me arsyet përkatëse.

6. Në rastin e vendimit për dhënien e licencës, Banka njofton me shkrim subjektin edhe mbi detyrimin e tij për të marrë miratimin nga Autoriteti për veprimtarinë e klerimit dhe të shlyerjes përpara fillimit të veprimtarisë.

Neni 13

Procedurat dhe afatet për shqyrtimin e kërkesës për licencim

1. Banka shqyrton dokumentacionin e paraqitur në përputhje me kërkesat e ligjit për sistemin dhe të rregullores.

2. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë dhe/ose nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në rregullore, Banka brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune i dërgon njoftim subjektit për mangësitë ose për mospërputhjet me dispozitat e ligjit për sistemin dhe të rregullores, së bashku me kërkesën për informacion ose dokumentacion shtesë.

3. Banka jep ose refuzon dhënien e licencës brenda 3 (tre) muajve nga data e pranimit të kërkesës për licencë.

4. Data e pranimit të kërkesës për licencë konsiderohet data kur kërkuesi ka dorëzuar të gjitha kërkesat për dokumentacion sipas nenit 10 të rregullores. Kjo datë i njoftohet me shkrim subjektit nga Banka.

5. Banka ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për licencë në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për licencim nuk plotësohet brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar për licencë. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës për licencë, Banka njofton me shkrim subjektin.

6. Banka pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë sipas kërkesave të ligjit për sistemin dhe të rregullores, si dhe pas plotësimit të informacionit shtesë sipas pikës 2 të nenit:

a) shqyrton dhe analizon dokumentacionin e paraqitur;

b) vlerëson aftësinë profesionale të administratorëve;

c) nëse e çmon të nevojshme, organizon takime me operatorin për të diskutuar planbiznesin e paraqitur dhe probleme të tjera të lidhura me veprimtarinë e propozuar;

d) vlerëson sistemet në bashkëpunim edhe me ekspertë të jashtëm, nëse konsiderohet e nevojshme.

7. Banka mund të inspektojë mjediset/zyrat ku do të zhvillohet veprimtaria e subjektit, me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve teknike dhe të sigurisë për ushtrimin e tyre.

8. Shqyrtimi i dokumentacionit të licencimit dhe inspektimi i mjediseve/zyrave të punës kryhet nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, në bashkëpunim rast pas rasti me Departamentin Juridik, Departamentin e Mbikëqyrjes, Departamentin e Teknologjisë së Informacionit dhe me Departamentin e Sigurimit dhe Mbrojtjes në Bankë.

Neni 14
Publikimi i vendimit/urdhrit për dhënien e licencës

Banka publikon vendimin/urdhrin për dhënien e licencës të operatorit të sistemit në mënyrën që e gjykon më të përshtatshme.

Neni 15
Komisioni

1. Subjekti që kërkon dhënien e licencës për të operuar sistemin paguan një komision për përpunimin e kërkesës për licencë në shumën 30,000 (tridhjetëmijë) lekë në Bankë, në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit përkatës.

2. Komisioni nuk rimbursohet në rast refuzimi të dhënies së licencës nga Banka.

Neni 16
Revokimi ose pezullimi i licencës

1. Banka mund të revokojë ose pezullojë licencën në rastet:

a) e përcaktuara në nenin 7, pika 1, të ligjit për sistemin;

b) e moszbatimit të masave të parashikuara në nenin 49, pika 1, shkronjat "a" dhe "b" të rregullores, të cilat në opinionin e Bankës mund të çojnë në kërcënimin e stabilitetit të sistemit financiar të vendit;

c) propozimit nga Autoriteti dhe arritjes së dakordësisë me Bankën, në vijim të konsultimeve të përbashkëta;

d) kur kërkohet nga vetë operatori.

2. Rastet e parashikuara në pikën 1, shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni konsultohen dhe me Autoritetin.

3. Në rastin e revokimit të licencës nga Banka, operatori krijon dhe zbaton procedura të cilat garantojnë se shlyerja dhe transferimi i aktiveve të klientëve, pjesëmarrësve dhe infrastrukturave të tjera kryhet në kohë dhe në mënyrën e duhur.

4. Në rastin kur pezullimi ose revokimi i licencës kërkohet nga vetë operatori:

a) operatori duhet të njoftojë Bankën e Shqipërisë 3 (tre) muaj përpara pezullimit ose ndërprerjes së veprimtarisë;

b) kërkesa për pezullim ose revokim nga ana e operatorit duhet të shoqërohet me një plan veprimi, i cili duhet të parashikojë të gjitha masat e nevojshme për përmbushjen në kohë të të gjitha detyrimeve të operatorit ndaj pjesëmarrësve, të krijuara nga procesimi i transaksioneve në sistem.

5. Banka menjëherë pasi informohet mbi kushtet dhe arsyet e pezullimit ose revokimit të licencës sipas pikës 4 të këtij neni konsultohet me Autoritetin mbi vendimin për pezullim ose revokim të licencës.

6. Banka mund të pezullojë pjesërisht operatorin për veprimtari, aktivitete ose instrumente financiare të caktuara, të cilat vlerësohet se janë në kundërshtim me parimet mbikëqyrëse të përcaktuara në këtë rregullore dhe akte të tjera nënligjore të Bankës dhe cenojnë qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemit.

7. Vendimi/urdhri për pezullimin ose revokimin e licencës, i arsyetuar, i komunikohet menjëherë me shkrim operatorit dhe publikohet në mënyrën që gjykohet më e përshtatshme nga Banka.

8. Operatori ndalohet të kryejë veprimtaritë e përcaktuara në licencë pas hyrjes në fuqi të vendimit/urdhrit të Bankës për revokimin ose pezullimin e saj, për aq kohë sa zgjat afati i pezullimit në këtë rast.

9. Vendimi/urdhri për revokimin ose pezullimin e licencës miratohet dhe nënshkruhet nga Guvernatori i Bankës.

KREU III
MIRATIMET PARAPRAKE DHE DETYRIMET PËR NJOFTIM

Neni 17
Miratimet paraprake

1. Operatori i sistemit, pa miratimin paraprak të Bankës dhe në vijim të Autoritetit, nuk mund:

a) të zvogëlojë kapitalin;

b) të emërojë një ose disa administratorë;

c) të nënshkruajë marrëveshje me të tretët për kontraktimin e një shërbimi të caktuar (*outsourcing*) që ka lidhje me veprimtarinë për të cilën është licencuar.

2. Banka jep ose refuzon, në mënyrë të arsyetuar, miratimin paraprak, sipas pikës 1, brenda 2 (dy) muajve nga paraqitja e plotë e kërkesës, mbështetur në dokumentacionin e përcaktuar në nenin 18 të rregullores.

3. Miratimet paraprake ose refuzimet nënshkruhen nga zëvendësguvernatori i parë i Bankës.

Neni 18
Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për miratimet paraprake

1. Operatori i sistemit për të marrë miratimet paraprake të parashikuara në nenin 17 të rregullores paraqet një kërkesë me shkrim pranë Bankës të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) për zvogëlimin e kapitalit:

i. vendimin e asamblesë për zvogëlimin e kapitalit;

ii. relacionin shoqërues me arsyet e këtij ndryshimi;

b) për të emëruar administratorin/ët:

i. vendimin e strukturës vendimmarrëse për emërimin e administratorit/ëve;

ii. dokumentacionin sipas shkronjës "i", të pikës 2, të nenit 10, të rregullores;

c) për marrëveshjet me të tretët (*outsourcing*) dhe ndërlidhjet me infrastruktura të tjera:

i. kontratat përkatëse (të lidhura me kushtin e hyrjes në fuqi pas dhënies së miratimit paraprak nga ana e Bankës), të cilat duhet të parashikojnë edhe detyrimin e nënkontraktorit/kontraktorit për të raportuar pranë Bankës, si dhe të drejtën e Bankës për t'i mbikëqyrur, në varësi të rëndësisë që paraqet për sigurinë e sistemit për shlyerjen e titujve, shërbimi i nënkontraktuar/kontraktuar,

ii. vendimin e organit drejtues për lidhjen e marrëveshjeve me të tretë (*outsourcing*);

iii. analiza/vlerësime dhe dokumentacione të organeve drejtuese të operatorit, të cilat sigurojnë:

- se cilësia e shërbimeve dhe vijimësia e veprimtarisë nuk cenohen apo komprometohen nga transferimi i aktiviteteve;

- se ofruesi i shërbimit ka reputacion, eksperiencën e duhur, si dhe një situatë financiare të qëndrueshme;

- njohjen dhe kontrollin mbi rreziqet që mund të rrjedhin nga transferimi i aktiviteteve.

2. Banka, sipas rastit, mund të kërkojë edhe dokumente shtesë, përveç sa është parashikuar në këtë nen.

Neni 19
Detyrimet për njoftim

1. Operatori njofton menjëherë Bankën në rastet e:

a) ngjarjeve të jashtëzakonshme në rast të paaftësisë paguese ose ndërprerjen e veprimtarisë së pjesëmarrësve në sistem;

b) ngjarjeve të jashtëzakonshme në rast të problemeve në funksionimin e sistemit, duke përfshirë masat korrigjuese të ndërmarra;

c) ngjarjeve të veçanta që mbulojnë të dhënat specifike të kërkuara nga Banka me qëllim kryerjen e mbikëqyrjes mbi operacionet e sistemit;

d) vlerësimit se ka shkaqe të justifikuara për ndërprerjen ose pezullimin e ndonjë prej aktiviteteve të sistemit;

e) vlerësimit se ka shkaqe për revokimin e licencës;

f) çdo ndryshimi në listën e pjesëmarrësve dhe nënpjesëmarrësve të sistemit.

2. Operatori njofton Bankën brenda 30 (tridhjetë) ditëve, për:

a) ndryshimin e emrit;

b) ndryshimin e statutit;

c) zmadhimin e kapitalit;

d) ndryshimet në strukturën e kapitalit;

e) ndryshime në strukturën organizative;

f) ndryshim të selisë dhe adresës;

g) largimin e administratorëve;

h) ndryshimin e rregulloreve të brendshme /metodat/çdo dokumentacion tjetër që shërben për të siguruar mirëfunksionimin e sistemit;

i) studimin e fizibilitetit për projekte të reja;

j) ndryshime në përmbajtjen e kontratave me pjesëmarrësit dhe në kontratat me operatorët e tjerë;

k) çdo ndryshim tjetër që është i detyrueshëm për regjistrim në regjistrin tregtar.

3. Në rastin e ndryshimit të emrit, pas kërkesës së operatorit, Banka e pajis atë me një format të ri licence në të cilin pasqyrohet emri i ri.

KREU IV
PARIMET QË RREGULLOJNË VEPRIMTARINË E OPERATORIT

Neni 20
Përputhshmëria me parimet

1. Operatori kryen veprimtarinë e tij në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të Bankës Qendrore Evropiane (BQE) dhe Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (BRN), të udhëhequra nga parimet e administrimit të kujdesshëm.

2. Në përmbushje të administrimit të kujdesshëm, operatori:

a) merr masat e duhura për kufizimin e rreziqeve direkte dhe indirekte, duke përfshirë dhe masat për mashtrimin dhe neglizhencën;

b) siguron nivele të larta të transparencës dhe përpikmërisë;

c) merr masa për funksionimin e vazhdueshëm dhe efikas të sistemit.

3. Parimet e administrimit të kujdesshëm, që do të shërbejnë për mbikëqyrjen e operatorëve, përcaktohen të përmbledhura në nenet 22 deri 43 të rregullores dhe do të detajohen në mënyrë të hollësishme me akt nënligjor të posaçëm të Bankës.

4. Në rastin e ndryshimeve të rëndësishme të funksionimit të sistemit, të shërbimeve të ofruara dhe futjes së shërbimeve të reja, operatori organizon forma të përshtatshme konsultimi me përdoruesit, në mënyrë që të vlerësohet ndikimi i nismës dhe përshtatshmëria e funksionaliteteve të ofruara.

5. Në mënyrë që të sigurohet ofrimi i shërbimeve të sigurta dhe efikase nga sistemi, operatori përmbush kërkesat specifike teknike, organizative dhe funksionale të përcaktuara në aktet nënligjore të Bankës.

6. Banka, për qëllime të mbikëqyrjes së sistemeve të licencuara në bazë të kësaj rregulloreje, publikon politikat e mbikëqyrjes, si dhe procedurat specifike për mbikëqyrjen e sistemit.

7. Zbatimi i parimeve mbikëqyrëse, të përcaktuara në këtë rregullore dhe në akte të tjera nënligjore të Bankës, nga ana e operatorit, monitorohet/mbikëqyret nga Banka në bashkëpunim me Autoritetin sipas Marrëveshjes "Për bashkëpunimin për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të shlyerjes së titujve dhe shtëpive të klerimit të titujve".

Neni 21
Mjediset dhe kushtet teknike

1. Operatori i sistemit siguron mjedise të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së tij. Këto mjedise konsiderohen të përshtatshme nëse ato përmbushin kërkesat teknike për të garantuar vijueshmëri të qëndrueshme të aktivitetit dhe përmbushin kriteret në vijim:

a) burimet teknike janë të dedikuara për aktivitete të caktuara;

b) garantojnë respektimin e rregullave teknike për instalimin dhe shfrytëzimin e pajisjeve në dispozicion, si dhe kryerjen e veprimtarisë së stafit nën kushtet optimale;

c) janë pajisur me një sistem alarmi kundër vjedhjes dhe zjarrit;

d) janë pajisur me masa sigurie, të cilat garantojnë ruajtjen e të dhënave edhe në raste zjarri;

e) ka burim kryesor të energjisë elektrike dhe një *back-up*;

f) garanton elemente të tjera të sigurisë së mjediseve sipas standardeve ndërkombëtare.

2. Kur operatori i sistemit përdor objekte/godina të marra me qira, kontrata e qirasë duhet të jetë me afat të përcaktuar për jo më pak se tre vjet.

3. Operatori i sistemit duhet të zotërojë pajisje të përshtatshme teknike për kryerjen e aktivitetit të licencuar.

4. Pajisjet teknike konsiderohen të përshtatshme nëse lejojnë një administrim të vazhdueshëm, të besueshëm dhe të qëndrueshëm të aktivitetit lidhur me operimin e sistemit.

Neni 22
Rreziku ligjor

1. Për qëllime të licencimit dhe mbikëqyrjes së operatorit, si dhe informimit të klientëve, operatori i sistemit miraton dhe zbaton rregulla, procedura dhe kontrata të qarta dhe të kuptueshme.

2. Operatori harton rregulla, procedura dhe kontrata, të cilat garantojnë siguri edhe në rastet e paraqitjes së paaftësisë paguese nga një pjesëmarrës.

Neni 23
Qeverisja

1. Operatori ka objektiva të dokumentuar, të cilët mbështesin sigurinë dhe efikasitetin e sistemit. Objektivat mbështesin stabilitetin financiar, si dhe ekzistencën e një tregu financiar të hapur dhe efikas.

2. Operatori ka rregulla efektive dhe të dokumentuara për qeverisjen, të cilat përcaktojnë linja të qarta dhe direkte në lidhje me përgjegjësitë dhe llogaridhënien. Këto rregulla duhet t'u paraqiten pronarëve, autoriteteve kompetente, pjesëmarrësve dhe në një nivel më të përgjithshëm edhe publikut. Operatori duhet të vendosë në dispozicion të publikut një version të përmbledhur të këtyre rregullave.

3. Rolet dhe përgjegjësitë e bordit drejtues janë të përcaktuara qartazi dhe marrin në konsideratë:

a) krijimin e objektivave strategjikë për sistemin;

b) krijimin e procedurave të dokumentuara për funksionimin e sistemit, përfshirë këtu dhe procedura për identifikimin, adresimin dhe administrimin e konfliktit të interesit;

c) rishikimin periodik të performancës së bordit, si dhe anëtarëve të tij.

4. Bordi drejtues përbëhet nga anëtarë me aftësi dhe incentiva të përshtatshme, të cilat mundësojnë përmbushjen e roleve të shumëfishta që ata kanë.

5. Rolet dhe përgjegjësitë e administrimit përcaktohen qartazi. Administrimi i operatorit të sistemit ka eksperiencë të mjaftueshme, aftësi dhe integritet që garanton operimin dhe administrimin e rrezikut me efikasitet dhe shmangien ndaj ekspozimeve.

6. Bordi krijon dhe mbikëqyr një kuadër për administrimin e rrezikut, i cili:

a) përfshin politikat e tolerancës ndaj rrezikut të sistemit;

b) përfshin përgjegjësitë dhe llogaridhënie për vendime në lidhje me administrimin e rrezikut dhe marrëdhëniet me palët e lidhura;

c) adreson procesin vendimmarrës në raste krizash ose emergjencash;

d) adreson funksionet e auditit të brendshëm.

Strukturat vendimmarrëse garantojnë se funksionet e administrimit të rrezikut dhe të auditit të brendshëm kanë kompetenca, pavarësi dhe akses të mjaftueshëm në procesin vendimmarrës.

7. Bordi garanton që vendimet e rëndësishme në lidhje me funksionet, rregullat dhe strategjitë e sistemit, dhe në veçanti në lidhje me procesin e klerimit dhe të shlyerjes, strukturën e operimit, qëllimin e produkteve të kleruara dhe të shlyera, si dhe teknologjia dhe procedurat e përdorura reflektojnë kërkesat legjitime të pjesëmarrësve, nënpjesëmarrësve dhe palëve të interesuara. Pjesëmarrësit, nënpjesëmarrësit dhe kur është e nevojshme publiku i gjerë, përfshihen në procese konsultimi për të tilla vendime.

Neni 24
Kuadri për administrimin e plotë të rreziqeve

1. Operatori i sistemit ka një kuadër të përshtatshëm për administrimin e rrezikut ligjor, të kreditit, likuiditetit, rrezikun operacional dhe të përgjithshëm të biznesit, si dhe rreziqeve të tjera të cilat mbart operimi i sistemit. Për këtë qëllim, operatori i sistemit ka politika të administrimit të rrezikut, procedura dhe sisteme që identifikojnë, matin, monitorojnë dhe administrojnë gamën e rreziqeve në sistem dhe të cilat rishikohen periodikisht.

2. Operatori ofron stimujt dhe, aty ku është e përshtatshme, kapacitetin për pjesëmarrësit dhe klientët e tyre për të administruar dhe zvogëluar rreziqet e tyre.

3. Operatori rishikon rregullisht rrezikun material që ai mbart dhe ia paraqet subjekteve të tjera, të tilla si sistemet e ndërlidhura, bankat e shlyerjes, ofruesit e likuiditetit ose ofruesit e shërbimeve teknike, si rezultat i ndërvarësisë dhe zhvillon mjete të përshtatshme administrimi për adresimin e këtyre rreziqeve.

4. Me qëllim administrimin e rreziqeve, operatori përcakton shërbimet dhe operacionet e tij me karakter kritik. Operatori ndërton skenarë specifikë, të cilët parashikojnë situata që pengojnë ofrimin e shërbimeve dhe operacioneve kritike, dhe në bazë të këtyre skenarëve vlerëson efektivitetin e opsioneve të zgjedhuara për rikuperimin e sistemit.

Neni 25
Rreziku i kreditit

1. Operatori krijon një kuadër për matjen, monitorimin dhe administrimin e ekspozimit të kredisë ndaj pjesëmarrësve, si dhe rrezikun e kreditit të krijuar nga procesi i klerimit dhe shlyerjes në sistem.

2. Operatori identifikon të gjitha burimet e rrezikut të kreditit, në vazhdimësi mat dhe monitoron ekspozimin e kredisë dhe përdor mjete të përshtatshme për administrimin e këtij rreziku.

3. Një operator, duke përfshirë këtu dhe një sistem shlyerjeje neto me garanci shlyerjeje, i cili gjatë operimit të sistemit shkakton ekspozim në kredi ndaj pjesëmarrësve, mbulon ekspozimin ndaj secilit pjesëmarrës me kolateral, fonde garanci ose burime të tjera financiare.

4. Operatori, duke përfshirë këtu dhe një sistem shlyerjeje neto pa garanci shlyerjeje, në rastin kur pjesëmarrësit përballen me ekspozim në kredi të krijuar nga proceset e klerimit dhe shlyerjes në sistem, duhet të ketë rregulla dhe marrëveshje kontraktuale me pjesëmarrësit, të cilat parashikojnë zgjidhjen e situatave të tilla. Këto rregulla dhe marrëveshje kontraktuale garantojnë që operatori të disponojë burime financiare të mjaftueshme për mbulimin e këtij ekspozimi kundrejt dy pjesëmarrësve, të cilët së bashku me filialet e tyre, në terma të agreguara krijojnë ekspozimin më të lartë në sistem.

5. Operatori krijon rregulla dhe procedura për të adresuar humbjet nga dështimi (*default*) i një ose disa pjesëmarrësve për të mbuluar detyrimet e tyre ndaj sistemit. Rregullat dhe procedurat adresojnë alokimin e humbjeve të pambuluara që mund të ndodhin potencialisht duke përfshirë këtu ripagimin e fondeve që operatori ka marrë hua nga ofruesit e likuiditetit. Këto rregulla duhet të përfshijnë rregulla dhe procedura për të plotësuar çdo burim financiar të përdorur nga operatori në situata stresi.

Neni 26
Kolaterali

1. Operatori pranon përgjithësisht si kolateral ato aktive që mbartin rrezik të ulët krediti, likuiditeti dhe tregu.

2. Operatori krijon praktika të kujdesshme të vlerësimit dhe përcakton marzhe reduktuese (*haircuts*), të cilat testohen rregullisht dhe marrin në konsideratë dhe situata të stresuara të tregut.

3. Me qëllim reduktimin e nevojave për përshtatjet prociklike, operatori përcakton marzhe reduktuese (*haircuts*) të qëndrueshme dhe konservatore, të cilat kalibrohen duke përfshirë situata të stresuara të tregut, në një masë të praktikueshme dhe të kujdesshme.

4. Operatori shmang përqendrimin e mbajtjes së aktiveve të caktuara, të cilat ulin mundësinë për t'i kthyer në likuiditet në mënyrë të shpejtë dhe pa efekte të pafavorshme të çmimeve.

5. Operatori kur pranon kolateral ndërkufitar, duhet të zbusë rrezikun që lidhet me përdorimin e tij dhe të sigurohet që kolaterali të mund të përdoret në kohën e duhur.

6. Operatori përdor një sistem administrimi të kolateralit, që është i projektuar mirë dhe fleksibël në aspektin operacional.

Neni 27
Rreziku i likuiditetit

1. Operatori krijon një kuadër të plotë për administrimin e rrezikut të likuiditetit që rrjedh nga pjesëmarrësit e sistemit, bankat shlyerëse, agjentët *nostro*[2], bankat kujdestare, ofruesit e likuiditetit apo entitete të tjera.

[2] *Agjent nostro* është institucioni financiar ose banka, të cilët mundësojnë hapjen e një llogarie rrjedhëse për kryerjen e transaksioneve/veprimeve.

2. Operatori zotëron mjete efektive operacionale dhe analitike me qëllim identifikimin, matjen dhe monitorimin e shlyerjes dhe lëvizjes së fondeve në kohën e duhur dhe në mënyrë të vazhdueshme, përfshirë edhe përdorimin e likuiditetit brenda ditës.

3. Operatori mban burime të mjaftueshme likuiditeti në të gjitha monedhat e përdorura për të mundësuar shlyerjen e detyrimeve në kohën e duhur, me një shkallë të lartë besueshmërie dhe në një spektër të gjerë skenarësh të mundshëm të stresit, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në, dështimin e një pjesëmarrësi dhe filialeve të tij, çka do të gjeneronte detyrime më të larta për likuiditet, në terma të agreguar, për operatorin në kushte ekstreme, por të mundshme, të tregut.

4. Operatori shton burimet e likuiditetit me aktive të tjera për të plotësuar kërkesat për burime të mjaftueshme likuiditeti. Këto burime likuide janë të tregtueshme dhe të pranueshme si kolateral në çdo moment ose *ad hoc* pas një dështimi, pavarësisht nëse parapërgatitja dhe garantimi nuk mund të jetë i sigurt në raste ekstreme, por të mundshme të tregut.

5. Kur pjesëmarrësi i shton këto burime, operatori garanton se këto aktive përmbushin kushtet e sipërcituara. Këto aktive supozohet se janë të tregtueshme dhe të pranueshme nëse janë marrë parasysh rregullat dhe praktika e bankave qendrore për pranimin e kolateralit. Operatori në planet e likuiditetit nuk përfshin supozime mbi disponueshmërinë e kreditimit në situata emergjente nga banka qendrore.

6. Operatori siguron një shkallë të lartë besueshmërie, duke treguar në mënyrë rigoroze kujdesin e duhur (*due dilligence*), se çdo ofrues i burimeve të tij të likuiditetit, ka informacion të mjaftueshëm për të kuptuar dhe administruar rreziqet e tij të likuiditetit, si edhe ka aftësinë për të përmbushur detyrimet e tij sipas marrëveshjes. Për vlerësimin e besueshmërisë së performancës së ofruesit të likuiditetit në lidhje me një monedhë të caktuar, nëse konsiderohet e përshtatshme, mund të merret në konsideratë mundësia e tij për t'u kredituar nga banka qendrore emetuese e monedhës në qarkullim. Operatori teston rregullisht procedurat për aksesimin e burimeve të likuiditetit te një ofrues likuiditeti.

7. Operatori i cili ka akses në shërbime dhe llogaritë e bankës qendrore, i përdor këto shërbime kur është e mundur, me qëllim për të administruar rrezikun e likuiditetit.

8. Operatori përcakton sasinë dhe teston rregullisht mjaftueshmërinë e burimeve të tij të likuiditetit, nëpërmjet një prove rezistence (*stress test*) rigoroze. Operatori krijon procedura të qarta për raportimin e rezultateve të provave të rezistencës (*stress test*) pranë strukturave vendimmarrëse dhe i përdor këto rezultate për të vlerësuar përshtatshmërinë dhe për të bërë rregullime në kuadrin e administrimit të rrezikut të likuiditetit. Gjatë procedurës së provës së rezistencës, merret në konsideratë një gamë e gjerë skenarësh të përshtatshëm. Këta skenarë përfshijnë luhatjet historike të çmimeve të pikut, ndryshime të faktorëve të tjerë të tregut si, përcaktuesit e çmimeve dhe kurbat e *yield*-eve, dështime të shumëfishta gjatë hapësirave të ndryshme kohore, presione të njëkohshme në tregjet e aktiveve dhe fondeve, si dhe një spektër të gjerë të skenarëve të stres testeve të fokusuar në të ardhmen, në kushte ekstreme, por të mundshme të tregut. Skenarët gjithashtu marrin në konsideratë projektimin dhe operacionet e sistemit, duke përfshirë të gjitha njësitë, të cilat ekspozojnë rrezik material të likuiditetit ndaj operatorit (si p.sh., bankat e shlyerjes, agjentët *nostro*, bankat kujdestare, ofruesit e likuiditetit dhe infrastrukturat e ndërlidhura), dhe aty ku është e përshtatshme, të mbulojnë edhe periudha disaditore.

9. Operatori përcakton rregulla dhe procedura të qarta për të mundësuar që shlyerjet e detyrimeve të bëhen efektive në të njëjtën ditë (*same day*) ose ku është e përshtatshme *intraday* (në mes të ditës) dhe disaditorëshe, në rastin kur shfaqet një dështim i një ose më shumë pjesëmarrësve. Këto rregulla dhe procedura adresojnë mangësitë e paparashikuara dhe potenciale/të mundshme të likuiditetit të pambuluar, synojnë të eliminojnë procedurën *unwinding*, revokimin ose vonesën e shlyerjes së detyrimeve brenda ditës, si edhe demonstrojnë se si operatori mund të plotësojë burimet e tij të likuiditetit, në situata stresi, duke mundësuar vijueshmërinë e sistemit në mënyrë të sigurt dhe të plotë.

Neni 28
Finaliteti i shlyerjes

1. Rregullat dhe procedurat e operatorit përcaktojnë në mënyrë të qartë momentin kur një urdhër konsiderohet i hyrë në sistem, i parevokueshëm dhe shlyerja konsiderohet finale.

2. Operatori bën publike rregullat mbi finalitetin e transferimit të titujve dhe të *cash*-it në sistem.

3. Shlyerja finale ndodh jo më vonë se në fund të datë valutës dhe është e preferueshme të finalizohet brenda ditës ose në kohë reale. Operatori siguron shlyerje finale brenda ditës me mënyrën e shlyerjes në kohë reale ose procesimit të *batch*-eve të shumëfishta.

4. Operatori përcakton në mënyrë të qartë momentin pas të cilit urdhërtransfertat e pashlyera mund të revokohen nga sistemi.

5. Të gjitha transaksionet midis pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë të një sistemi për shlyerjen e titujve shlyhen bazuar në parimin e dorëzimit kundrejt pagesës (*DvP*).

6. Për qëllime të administrimit të rreziqeve të cilat lidhen me shlyerjen, regjistrari i cili ofron dhe shërbime të klerimit dhe të shlyerjes krijon një fond garanci sipas legjislacionit në fuqi për titujt.

Neni 29
Shlyerja e parave

1. Operatori kryen shlyerjen e parave në llogaritë e bankës qendrore, atëherë kur është praktike dhe e mundshme, me qëllim shmangien e rreziqeve të kreditit dhe likuiditetit.

2. Operatori, në qoftë se shlyerja nëpërmjet llogarive të bankës qendrore nuk është praktikisht e mundshme, minimizon dhe kontrollon në mënyrë rigoroze rrezikun e kreditit dhe likuiditetit, të cilat rrjedhin nga përdorimi i llogarive të bankave tregtare për shlyerje.

3. Në rastin kur shlyerja kryhet në llogaritë e bankës tregtare, operatori vendos dhe monitoron kritere rigoroze për kontrollin e agjentit shlyerës duke pasur parasysh, përveç të tjerave, rregullimin dhe mbikëqyrjen, aftësinë paguese, kapitalizimin, aksesin në likuiditet dhe besueshmërinë operacionale. Operatori monitoron dhe administron gjithashtu përqendrimin e kreditit dhe ekspozimin e likuiditetit të agjentit shlyerës.

4. Në rastin kur operatori kryen shlyerjen në llogaritë e tij, monitoron dhe administron në mënyrë rigoroze rreziqet e tij të likuiditetit dhe të kreditit.

5. Në rastin kur shlyerja ndodh në llogaritë e bankës tregtare, marrëveshja midis palëve përcakton qartë momentin kur urdhërtransferta konsiderohet e shlyer në librat e agjentit shlyerës, momentin kur urdhërtransferta konsiderohet finale dhe e parevokueshme, si dhe disponueshmërinë e fondeve për t'u përdorur sa më shpejt të jetë e mundur ose të paktën deri në fund të ditës.

6. Në lidhje me datën e shlyerjes, është e rëndësishme, që:

a) çdo pjesëmarrës në një sistem për shlyerjen e titujve i cili shlyen në këtë sistem, në llogaritë e tij ose për llogari të të tretëve, transaksione me tituj të transferueshëm, instrumente të tregut të parasë, njësi të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, i shlyen këto transaksione në datën e përcaktuar për shlyerje;

b) në lidhje me transaksionet e titujve të transferueshëm në shkronjën "a", të kësaj pike, të cilat tregtohen në tregje të rregulluara/bursë, data e shlyerjes është e preferueshme të jetë jo më vonë se dy ditë pune pas datës së tregtimit, por në asnjë rast më vonë se tri ditë pune nga tregtimi. Këto kërkesa nuk duhet të zbatohen për transaksione të cilat negociohen privatisht, por ekzekutohen në tregje të rregulluara/bursë, si dhe transaksionet që ekzekutohen në mënyrë dypalëshe, por raportohen në tregjet e rregulluara/bursë.

Neni 30
Dërgesat fizike

1. Rregullat e operatorit përcaktojnë në mënyrë të qartë detyrimet e tij për dorëzimin/shpërndarjen e instrumenteve fizike[3] ose titujve.

2. Operatori identifikon, monitoron dhe administron rreziqet dhe kostot e lidhura me ruajtjen dhe dorëzimin e instrumenteve fizike ose titujve.

[3] Në formë letër/ jo të dematerializuara në formë elektronike.

Neni 31
Sistemet e shlyerjes për vlera të këmbyera

Operatori i sistemit eliminon rrezikun principal duke siguruar që shlyerja e plotë e një detyrimi ndodh vetëm nëse ndodh edhe shlyerja finale e detyrimit të lidhur me të. Ky rregull ndiqet pavarësisht nëse shlyerja ndodh në bazë bruto ose neto dhe pavarësisht momentit kur ndodh finaliteti.

Neni 32
Rregullat dhe procedurat për mospërmbushjen e detyrimeve

1. Operatori ka rregulla dhe procedura për rastin e mospërmbushjes së detyrimeve si rrjedhojë e paaftësisë paguese (*default*) që e mundësojnë të vazhdojë të përmbushë detyrimet e tij edhe në rastin kur një pjesëmarrës i sistemit dështon, dhe të cilat adresojnë rikuperimin e burimeve mbas dështimit.

2. Operatori është i mirëpërgatitur të zbatojë rregullat dhe procedurat e tij të mospërmbushjes së detyrimeve (*default*), duke përfshirë edhe procedura përkatëse të rezervuara të parashikuara në rregullat e tij.

3. Operatori bën publike aspektet kyçe të këtyre rregullave dhe procedurave.

4. Operatori teston dhe rishikon rregullat dhe procedurat në lidhje me mospërmbushjen e detyrimeve, të paktën një herë në vit, ose pas çdo ndryshimi material të sistemit që ndikon te këto rregulla dhe procedura. Operatori përfshin në këtë testim dhe rishikim edhe pjesëmarrësit e sistemit dhe palë të tjera të interesuara.

Neni 33
Rreziku i përgjithshëm i biznesit

1. Operatori ka sisteme administrimi dhe kontrolli të mirëstrukturuara, që mundësojnë identifikimin, monitorimin dhe administrimin e rreziqeve të përgjithshme të biznesit, përfshirë këtu edhe humbjet e mundshme që mund të lindin nga një zbatim i dobët i strategjive të biznesit, flukset negative monetare (*negative cash flow*) ose shpenzime operative të paparashikuara dhe në shuma të mëdha.

2. Operatori mban aktive likuide neto të financuara nga kapitali aksioner (si për shembull aksione të zakonshme, rezerva të krijuara ose fitime të tjera të mbajtura) duke garantuar kështu vijueshmërinë e operimit të sistemit dhe të ofrimit të shërbimeve nëse ndodhin humbje të përgjithshme të biznesit. Shuma e aktiveve likuide neto përcaktohet nga profili i rrezikut të biznesit të operatorit dhe nga periudha e kërkuar për rimëkëmbjen e operacioneve dhe shërbimeve kritike të sistemit, në mënyrën më të përshtatshme.

3. Operatori ka një plan rimëkëmbjeje të zbatueshëm, si dhe mban aktive likuide neto të mjaftueshme për ta zbatuar këtë plan. Shuma e tyre duhet të jetë e barabartë me të paktën vlerën totale të shpenzimeve operative rrjedhëse të 6 muajve të fundit. Këto aktive janë përtej burimeve të mbajtura për të mbuluar mospërmbushjen e detyrimeve prej pjesëmarrësve ose të tjera rreziqe. Megjithatë, kapitali i mbajtur sipas standardeve ndërkombëtare të kapitalit të bazuar në rrezik mund të përfshihet nëse konsiderohet e përshtatshme për të shmangur kërkesa të dublikuara për kapitalin.

4. Aktivet e mbajtura për të mbuluar rrezikun e përgjithshëm të biznesit duhet të jenë të cilësisë së lartë dhe mjaftueshëm likuide për t'i mundësuar operatorit që të përballojë shpenzimet rrjedhëse dhe ato të parashikuara duke pasur parasysh disa skenarë, përfshirë edhe situatat negative të tregut.

5. Operatori ka një plan të zbatueshëm për rritjen e mëtejshme të kapitalit, nëse ky i fundit i afrohet ose bie poshtë shumës së kërkuar. Plani miratohet nga bordi drejtues dhe rishikohet rregullisht.

Neni 34
Rreziku i kujdestarisë dhe investimit

1. Operatori mban aktivet e tij dhe ato të pjesëmarrësve të tij në entitete të mbikëqyrura dhe të rregulluara (kujdestarë), të cilat kanë praktika të mira kontabiliteti, procedura mbrojtjeje dhe kontrolle të brendshme që mbrojnë plotësisht këto aktive.

2. Operatori ka akses tek aktivet e tij dhe ato të pjesëmarrësve të tij në çdo rast kur kjo është e nevojshme.

3. Operatori vlerëson dhe njeh ekspozimet e tij ndaj kujdestarëve në tërësinë e marrëdhënieve me secilin.

4. Operatori harton strategjinë e tij të investimit, e cila është në përputhje me strategjinë e përgjithshme të administrimit të rrezikut, strategji e cila i bëhet publike të gjithë pjesëmarrësve. Investimet janë të cilësisë së lartë dhe janë mjaftueshëm likuide, pa efekte negative të çmimeve.

Neni 35
Rreziku operacional

1. Operatori krijon një kuadër të shëndetshëm për administrimin e rrezikut operacional i përbërë nga sisteme, politika, procedura dhe kontrolle, të cilat mundësojnë identifikimin, monitorimin dhe administrimin e rreziqeve operacionale.

2. Strukturat vendimmarrëse të operatorit përcaktojnë qartësisht rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me adresimin e rrezikut operacional dhe miratojnë kuadrin e administrimit të këtij rreziku. Sistemet, politikat operacionale, procedurat dhe kontrollet rishikohen, auditohen dhe testohen periodikisht, si dhe pas çdo ndryshimi të rëndësishëm.

3. Operatori ka përcaktuar qartësisht objektiva për besueshmërinë operacionale dhe ka hartuar politika për arritjen e këtyre objektivave.

4. Operatori siguron se sistemi ka kapacitet përshkallëzues për të përballuar volume stresi në rritje dhe mund të arrijë objektivat në nivelet e shërbimit.

5. Operatori përcakton politika gjithëpërfshirëse të sigurisë fizike dhe të informacionit që të adresojnë të gjitha kërcënimet dhe dobësitë e mundshme.

6. Operatori përcakton një plan vijueshmërie të biznesit që adreson ngjarjet që përbëjnë një rrezik domethënës për ndërprerje të operacioneve të sistemit, duke përfshirë edhe rastet e një shkëputjeje madhore ose në shkallë të gjerë. Operatori teston planin dhe e rishikon atë të paktën një herë në vit.

7. Operatori identifikon, monitoron dhe administron rreziqet që pjesëmarrësit kritikë, infrastruktura të tjera financiare, ofruesit e shërbimeve dhe utiliteteve mund të shkaktojnë në operacionet e sistemit. Për më tepër, operatori identifikon, monitoron dhe administron rreziqet që operacionet e sistemit të tij mund të shkaktojnë tek infrastruktura të tjera financiare.

Neni 36
Pranimi dhe kushtet për pjesëmarrje

1. Operatori lejon akses të hapur dhe të drejtë në shërbimet e ofruara, të bazuara në përqasjen e administrimit të rrezikut për pjesëmarrje në të, dhe kur është e përshtatshme edhe për nënpjesëmarrësit.

2. Vendosja e kushteve për pjesëmarrje bazohet në garantimin e sigurisë dhe efikasitetit të operatorit, si dhe tregjeve që iu shërben. Këto rregulla duhet të përshtaten dhe të jenë në përputhje me rreziqet specifike të operatorit, si dhe të bëhen publike. Me qëllim mbajtjen e standardeve të pranueshme të kontrollit të rrezikut, një operator vendos kushte të cilat kanë ndikim më të ulët, sipas rrethanave, në akses.

3. Operatori monitoron zbatimin e rregullave të pjesëmarrjes në mënyrë të vazhdueshme dhe ka procedura të mirëpërcaktuara dhe publike për pezullimin dhe përjashtimin e pjesëmarrësve, të cilët shkelin rregullat, ose nuk i përmbushin më ato.

Neni 37
Marrëveshjet për pjesëmarrje në disa nivele

1. Operatori identifikon, vlerëson dhe administron rreziqet e krijuara nga marrëveshjet për pjesëmarrje me disa nivele (si për shembull: midis pjesëmarrësit dhe nënpjesëmarrësit).

2. Për qëllime të administrimit të rrezikut, një operator duhet të sigurohet që rregullat, procedurat dhe marrëveshjet kontraktuale lejojnë mbledhjen e informacionit për nënpjesëmarrësit, në mënyrë që të identifikohet, monitorohet dhe administrohet çdo rrezik material që mund të ngrihet në sistem nga kjo pjesëmarrje. Ky informacion mbulon të gjitha aspektet e mëposhtme:

a) proporcionalitetin e aktivitetit që pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë zhvillojnë në emër të nënpjesëmarrësve;

b) numrin e nënpjesëmarrësve që shlyejnë nëpërmjet pjesëmarrësve individualë të drejtpërdrejtë;

c) vëllimet ose vlerat e urdhërtransfertave në sistem që e kanë origjinën nga çdo nënpjesëmarrës;

d) vëllimet ose vlerat e urdhërtransfertave nën shkronjën "c" të kësaj pike në proporcion me ato të pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë, nëpërmjet të cilëve nënpjesëmarrësit aksesojnë sistemin.

3. Operatori identifikon varësitë materiale ndërmjet pjesëmarrësve dhe nënpjesëmarrësve që mund të ndikojnë në sistem.

4. Operatori identifikon nënpjesëmarrësit që paraqesin rrezik material në sistem dhe pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë nëpërmjet të cilëve ata aksesojnë sistemin me synim për t'i administruar këto rreziqe.

5. Operatori rishikon rregullisht rreziqet që krijohen nga marrëveshjet e pjesëmarrësve në nivele. Operatori merr masa për zbutjen e rrezikut kur është e nevojshme të sigurohet që rreziqet janë administruar në mënyrën e duhur.

Neni 38
Ndërlidhjet

1. Operatori garanton se funksionimi i ndërlidhjeve të sistemit është në përputhje me rregullat e funksionimit dhe nuk ndikon funksionimin e rregullt të tij.

2. Përpara se të lidhë një marrëveshje me një operator tjetër për ndërlidhje, dhe në mënyrë të vazhdueshme sapo kjo ndërlidhje të jetë krijuar, operatori i sistemit identifikon, monitoron dhe administron të gjitha burimet të mundshme të rrezikut që rrjedhin nga kjo marrëveshje. Marrëveshjet për ndërlidhje projektohen në mënyrë që secili operator sistemi të jetë në gjendje të respektojë parimet e tjera mbikëqyrëse në këtë rregullore.

3. Një ndërlidhje midis dy operatorëve duhet të ketë një bazë ligjore të shëndoshë bazuar në juridiksionin përkatës, që mbështet projektimin e saj dhe siguron mbrojtje të përshtatshme për operatorët e sistemeve të përfshirë në lidhje.

4. Regjistrarët e ndërlidhur duhet të matin, monitorojnë dhe administrojnë rreziqet e tyre të kreditit dhe likuiditetit që lindin nga këto ndërlidhje. Çdo dhënie kredie ndërmjet regjistrarëve do të mbulohet plotësisht me kolateral të cilësisë së lartë dhe do të jetë subjekt i kufizimeve.

5. Ndalohet transferimi i përkohshëm i titujve ndërmjet regjistrarëve të ndërlidhur, ose të paktën duhet të ndalohet ritransferimi përpara se transferimi i parë të bëhet final.

6. Regjistrari i cili është në rolin e investuesit krijon një lidhje me një regjistrar emetues vetëm nëse marrëveshja siguron një nivel të lartë të mbrojtjes për të drejtat e pjesëmarrësve të regjistrarit investues.

7. Regjistrari investues që përdor një ndërmjetës për të operuar një ndërlidhje me një regjistrar emetues mat, monitoron dhe administron rreziqet shtesë (duke përfshirë rreziqet e kujdestarisë, të kreditit, ligjor dhe operacional) që rrjedhin nga përdorimi i ndërmjetësit.

8. Regjistrarët e ndërlidhur kanë procedura të shëndosha rikonsilimi për të siguruar që regjistrimet e tyre përkatëse janë të sakta dhe aktuale.

9. Ndërlidhjet midis regjistrarëve garantojnë respektimin e parimit të dërgimit kundrejt pagesës (*DvP*) ndërmjet pjesëmarrësve në regjistrat e ndërlidhur kur kjo është e mundur. Në rastin kur respektimi i këtij parimi nuk garantohet nga regjstrarët, njoftohet Banka dhe Autoriteti.

Neni 39
Kontraktimi te të tretët

1. Operatori kërkon miratimin paraprak sipas nenit 17 dhe nenit 18 pika 1, shkronja "c" nga Banka për kontraktimin e aktiviteteve te palët e treta të parashikuara në pikën 4 të këtij neni. Banka informon operatorin nëse autorizimi është dhënë/aprovuar ose refuzuar brenda tre muajve nga dorëzimi i aplikimit të plotë.

2. Banka zbaton mbikëqyrje të drejtpërdrejtë dhe tek ofruesit e shërbimeve të kontraktuar në rastet kur e gjykon të nevojshme dhe me rëndësi sistemike për sistemin.

3. Operatorët e sistemit janë përgjegjës për raportimin pranë Bankës për aktivitetet e ofruesve të shërbimeve të kontraktuara te të tretët në rastet kur Banka nuk kryen mbikëqyrje të drejtpërdrejtë te këta ofrues.

4. Operatori i sistemit siguron që, kur mbështetet te një palë e tretë për kryerjen e funksioneve operacionale të cilat janë kritike për ofrimin e shërbimit të vazhdueshëm dhe të kënaqshëm për klientët dhe kryerjen e veprimtarive të tij në mënyrë të vazhdueshme dhe në nivele të kënaqshme, ndërmerr hapa të arsyeshëm për të shmangur rrezikun shtesë operacional. Transferimi te të tretët i funksioneve të rëndësishme operacionale nuk mund të ndërmerret në mënyrë të tillë që të dëmtojë materialisht cilësinë e kontrollit të saj të brendshëm dhe aftësinë e mbikëqyrësit për të monitoruar pajtueshmërinë e shoqërisë me të gjitha detyrimet.

5. Ofruesi i shërbimeve të kontraktuara duhet të ketë procedura të shëndosha administrative dhe të kontabilitetit, mekanizma të kontrollit të brendshëm, procedura efektive për vlerësimin e rrezikut, kontrolle efektive dhe masa mbrojtëse për sistemet e përpunimit të informacionit.

Neni 40
Efikasiteti dhe dobishmëria

1. Shërbimet e ofruara nga operatori janë efikase dhe të dobishme, në përmbushjen e kërkesave të pjesëmarrësve të tij dhe të tregut ku ai operon.

2. Një operator ka një proces për të identifikuar dhe për të përmbushur nevojat e tregut të cilit i shërben, veçanërisht në lidhje me:

a) përzgjedhjen e marrëveshjeve të klerimit dhe të shlyerjes;

b) strukturën operative;

c) fushën e produkteve të klerimit ose të shlyerjes.

3. Një operator përcakton qartë objektivat dhe qëllimet, të cilat duhet të jenë të matshme dhe të arritshme si për shembull, në fushat e nivelit minimal të shërbimit, pritshmërisë së administrimit të rrezikut dhe prioriteteve të biznesit.

4. Operatori përcakton mekanizma për rishikimin e rregullt të kërkesave të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, të paktën njëherë në vit.

Neni 41
Procedurat dhe standardet e komunikimit

Operatori përdor ose minimalisht përshtat, procedura dhe standarde të përshtatshme komunikimi, të pranuara në nivel ndërkombëtar, në mënyrë që të mbështesë efikasitetin e procesit të klerimit, shlyerjes dhe regjistrimit.

Neni 42
Publikimi i rregullave dhe procedurave të rëndësishme

Me qëllim publikimin e rregullave dhe procedurave të rëndësishme, operatori:

a) adopton rregulla dhe procedura të qarta dhe të kuptueshme, të cilat i bëhen publike pjesëmarrësve dhe palëve të interesuara;

b) bën publike përshkrime të qarta të dizenjimit të sistemit dhe operacioneve që kryen, si dhe të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve dhe operatorit, me qëllim që pjesëmarrësit të njihen me rreziqet e mbartura nga pjesëmarrja në sistem;

c) ofron gjithë dokumentacionin dhe trajnimin e nevojshëm dhe të përshtatshëm me qëllim njohjen e pjesëmarrësve me rregullat dhe procedurat e operatorit, si dhe rreziqet që mbart pjesëmarrja në sistem;

d) publikon tarifat për shërbimet individuale që ofron, si dhe politikat e uljes së tarifave dhe komisioneve. Gjithashtu, operatori jep përshkrime të qarta mbi tarifat dhe komisionet për qëllime krahasuese;

e) plotëson dhe bën publike zbatimin e standardeve të përcaktuara në këtë rregullore. Operatori përditëson zbatimin e tyre duke pasur parasysh ndryshime materiale të sistemit ose të ambientit, të paktën çdo dy vjet. Operatori publikon minimalisht të dhëna bazë mbi volumet dhe vlerat e transaksioneve të kryera në sistem.

Neni 43
Komiteti i përdoruesve

1. Regjistrari i Titujve krijon komitetet e përdoruesve për çdo sistem shlyerjeje të titujve që operon, të cilët përbëhen nga përfaqësues të emetuesve dhe të pjesëmarrësve të këtyre sistemeve. Këshillat/sugjerimet e komitetit të përdoruesve janë të pavarura nga çdo ndikim i

drejtpërdrejtë i organeve drejtuese të Regjistrarit.

2. Regjistrari përcakton në mënyrë jodiskriminuese mandatin e secilit komitet të krijuar të përdoruesve, rregullat e nevojshme të qeverisjes për të siguruar pavarësinë dhe procedurat e tij operacionale, si edhe kriteret e pranimit dhe mekanizmat e zgjedhjes së anëtarëve të komitetit të përdoruesve. Rregullat e qeverisjes bëhen publike dhe sigurojnë që komiteti i përdoruesve i raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë organeve drejtuese, si dhe mban takime të rregullta.

3. Komitetet e përdoruesve këshillojnë organet drejtuese për rregullat kryesore që ndikojnë tek anëtarët e tyre, duke përfshirë kriteret për pranimin e emetuesve ose pjesëmarrësve në sistemet e tyre respektive të shlyerjes së titujve dhe në nivelin e shërbimit.

4. Komitetet e përdoruesve mund të japin një opinion jo detyrues tek organet drejtuese, i cili përmban arsyetime të detajuara në lidhje me strukturën e çmimeve të Regjistrarit.

5. Pa paragjykuar të drejtën e autoriteteve kompetente për t'u informuar në mënyrën e duhur, anëtarët e komitetit të përdoruesve duhet t'i nënshtrohen konfidencialitetit. Nëse kryetari i komitetit të përdoruesve përcakton se një anëtar ka një konflikt interesi aktual ose të mundshëm në lidhje me një çështje të veçantë, atëherë ai anëtar nuk do të lejohet të votojë për atë çështje.

6. Regjistrari i njofton menjëherë autoritetit kompetent dhe komitetit të përdoruesve, çdo vendim në të cilin organi drejtues vendos të mos ndjekë këshillat e komitetit të përdoruesve. Komiteti i përdoruesve mund të informojë autoritetin kompetent mbi çdo fushë në të cilën konsideron se këshillat e tij nuk janë ndjekur.

KREU V
MBIKËQYRJA

Neni 44
Mënyrat e mbikëqyrjes

1. Banka dhe Autoriteti mbikëqyrin subjektet e licencuara bazuar në parimet ndërkombëtare për këta operatorë sipas ndarjes së fushave të veprimit të përcaktuara në Marrëveshjen "Për bashkëpunimin për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të shlyerjes së titujve dhe shtëpive të klerimit të titujve".

2. Banka realizon mbikëqyrjen e operatorit duke u orientuar drejt parimit të administrimit të rreziqeve. Mënyrat e mbikëqyrjes janë:

a) inspektimi në vend;

b) mbikëqyrje në distancë.

3. Banka, në rast se e gjykon të arsyeshme, mund të vendosë standarde dhe kërkesa të tjera shtesë mbi operatorin, pjesëmarrësit dhe nënpjesëmarrësit e sistemit.

4. Për qëllime të mbikëqyrjes së veprimtarisë së sistemit, Banka mbikëqyr edhe aktivitetet për të cilat sistemi ka lidhur marrëveshje me të tretët (*outsourcing*) sipas nenit 17, pika 1, shkronja "c" dhe nenit 39.

Neni 45
Inspektimi në vend

1. Me qëllim që të sigurohet dhe të kontrollohet zbatimi i ligjit për sistemin dhe i akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, punonjës të Bankës, si dhe persona të tjerë të kualifikuar, të autorizuar prej saj, mund të inspektojnë ambientet e punës së sistemit, operatorin, pjesëmarrësit dhe nënpjesëmarrësit, për të kontrolluar llogaritë, regjistrat, dokumentet dhe shkresa të tjera, për të marrë informacion dhe të dhëna prej tyre, si dhe të ndërmarrin veprime të tjera që Banka mund të vlerësojë si të nevojshme.

2. Operatori, pjesëmarrësit dhe nënpjesëmarrësit, vënë në dispozicion të Bankës llogaritë, regjistrat, dokumente dhe shkresa të tjera të kërkuara nga ligji për sistemin dhe nga aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Operatori, pjesëmarrësit dhe nënpjesëmarrësit vënë në dispozicion të Bankës çdo lloj informacioni dhe të dhënë shtesë, të cilat Banka i vlerëson si të nevojshme.

3. Si rregull, Banka njofton me shkresë zyrtare operatorin të paktën 10 (dhjetë) ditë pune përpara datës së inspektimit në vend, mbi programin e inspektimit dhe personat e përfshirë në procesin e inspektimit. Përjashtim bëjnë rastet kur Banka e gjykon të nevojshme të kryejë një inspektim të papritur pranë operatorit.

Neni 46
Mbikëqyrje në distancë

1. Banka kryen mbikëqyrjen në distancë nëpërmjet njoftimeve të detyrueshme që operatori i jep në bazë të nenit 19 të rregullores, si dhe marrjes së raportimeve periodike nga operatori të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.

2. Operatori 1 (një) herë në vit, brenda tremujorit të parë, dorëzon pranë Bankës raportin e audituesit të jashtëm bashkë me pasqyrat financiare, dhe një shtojcë të posaçme, sipas nenit 46 të rregullores.

3. Raporti i mësipërm dërgohet në Bankë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dorëzimi tek operatori dhe pas njohjes me të të strukturave vendimmarrëse të operatorit.

4. Operatori çdo 1 (një) muaj dorëzon pranë Bankës informacion mbi aktivitetin e sistemit në lidhje me:

a) numrin dhe vlerën e transaksioneve të procesuara;

b) informacione të tjera të parashikuara në akte nënligjore të Bankës.

Operatori duhet të garantojë në çdo moment, mundësinë e identifikimit të çdo urdhërtransferte dhe të informacionit që ajo mbart.

5. Operatori çdo vit, brenda tremujorit të dytë, dorëzon pranë Bankës informacion në lidhje me:

a) metodat e përdorura për të siguruar përputhshmërinë me rregullat dhe funksionimin e duhur të shërbimeve dhe sistemeve, në veçanti, në lidhje me mbështetjen teknologjike;

b) masat mbrojtëse të vendosura për sigurimin e besueshmërisë dhe integritetit të të dhënave operacionale dhe kontabël;

c) masat e marra për administrimin e rreziqeve dhe në veçanti ato në përgjigje të mangësive/problemeve të hasura gjatë operimit të sistemit;

d) masat organizative të ndërmarra në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave;

e) rezultatet kryesore të aktivitetit të kontrollit të kryer brenda kompanisë në nivele të ndryshme të strukturës organizative;

f) raportet e testimeve dhe kontrolleve të kryera mbi sigurinë e informacionit në infrastrukturën teknologjike IT që mbështet sistemin (të kryera nga palë të treta ose njësi të brendshme që janë të ndryshme dhe të pavarura nga njësitë operuese të sistemit).

6. Banka mund t'i kërkojë operatorit raportime *ad hoc* për çështje të veçanta dhe operatori vë në dispozicion informacionin sa herë që i kërkohet.

Neni 47
Shtojca e raportit të auditorit të jashtëm

Shtojca e posaçme përmban:

1. Vlerësimin e përputhshmërisë me rregullat e administrimit të rrezikut:

a) auditori i jashtëm kontrollon dhe vlerëson përputhshmërinë e rregullave të administrimit të rrezikut të sistemit në përputhje me përcaktimet e rregullores;

b) auditori i jashtëm vlerëson mjaftueshmërinë e sistemeve të administrimit të rreziqeve të sistemit duke u bazuar në vlerësimin e:

i. përputhshmërisë me kërkesat për strukturat organizative në lidhje me administrimin e çdo rreziku të veçantë;

ii. politikave dhe procedurave për administrimin e çdo rreziku të veçantë, si dhe të zbatimit të tyre;

iii. mjaftueshmërisë së identifikimit, matjes dhe monitorimit të çdo rreziku të veçantë;

iv. mjaftueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të auditit të brendshëm në lidhje me administrimin e çdo rreziku të veçantë.

2. Vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Auditori i jashtëm kryen një vlerësim të veçantë të sistemit të auditit të brendshëm të sistemit, duke vlerësuar nëse:

a) operatori ka ngritur një sistem kontrolli të brendshëm të sigurt dhe efikas, në përputhje me përcaktimet e rregullores;

b) operatori ka krijuar njësinë e auditit të brendshëm, si njësi të pavarur nga pikëpamja funksionale dhe organizative nga njësitë e tjera organizative të sistemit të cilat kontrollon dhe nëse ajo funksionon në përputhje me përcaktimet e rregullores;

c) operatori ka krijuar sistem kontrolli të brendshëm të përshtatshëm për të shmangur konfliktin e interesave;

d) operatori ka siguruar një numër të mjaftueshëm personeli, me kualifikime të duhura profesionale dhe përvojë, për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në mënyrë proporcionale me madhësinë, llojin, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarive.

3. Vlerësimin e sistemit të informacionit:

a) auditori i jashtëm kryen një vlerësim të veçantë të gjendjes dhe të mjaftueshmërisë së sistemit për administrimin e informacionit të sistemit. Për këtë qëllim, ai:

i. përcakton paraprakisht qëllimin dhe thellësinë e vlerësimit bazuar në vlerësimin e rrezikut (*risk-based*);

ii. zbaton metodat dhe procedurat e këtij vlerësimi bazuar në vlerësimin e rrezikut (*risk-based*);

iii. verifikon përputhshmërinë e sistemit të administrimit të informacionit me kërkesat/përcaktimet e rregullores.

b) auditori i jashtëm, bazuar në vlerësimin e sistemit të informacionit sipas shkronjës "a", përcakton rreziqet kryesore ndaj të cilave sistemi është i ekspozuar.

4. Shtojca duhet të përmbajë shënime shpjeguese në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të auditorit për periudhat e mëparshme për të gjitha funksionet e audituara, dhe në veçanti në lidhje me funksionin e auditit të brendshëm.

5. Shtojca duhet të përfshijë edhe opinionin e auditorit të jashtëm mbi saktësinë e raportimeve pranë Bankës sipas rregullores.

Neni 48
Kompetenca vendimmarrëse të Bankës

Banka mund të nxjerrë urdhra, udhëzime dhe vendime, nëpërmjet të cilave t'u kërkojë sistemit, operatorit, pjesëmarrësve dhe nënpjesëmarrësve për të vepruar ose për të mos vepruar, në çfarëdolloj mënyre që Banka e vlerëson të nevojshme ose të këshillueshme.

Neni 49
Masa ndëshkimore

1. Në rast të shkeljes së dispozitave të ligjit për sistemin dhe të rregullores, Banka mund të vendosë të ndërmarrë masat e mëposhtme:

a) Masa parandaluese. Banka ndërmerr ndaj operatorit një ose disa nga masat e mëposhtme:

i. Banka paralajmëron operatorin për mosrespektimin e standardeve për një veprimtari të sigurt dhe të qëndrueshme dhe për këtë qëllim kërkon prej tij paraqitjen e një plani ose marrëveshjeje për ndërprerjen e veprimeve në kundërvajtje dhe ndreqjen e shkeljeve të dispozitave të ligjit për sistemin dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe respektimin e standardeve për një veprimtari të sigurt dhe të qëndrueshme;

ii. Në zbatim të pikës 1, shkronjës "b", nënshkronja "i", të këtij neni, operatori paraqet në Bankë planin apo marrëveshjen e mësipërme brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës, sipas pikës 1 ose sipas afatit të caktuar nga Banka;

iii. Banka, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së planit ose marrëveshjes së propozuar nga operatori, njofton me shkrim këtë të fundit për miratimin ose jo të tyre, si dhe kërkon informacion shtesë, nëse gjykohet e arsyeshme. Banka mund të zgjasë afatin, brenda të cilit jepet njoftimi për miratimin e planit ose marrëveshjes.

b) Masa mbikëqyrëse. Banka ndërmerr ndaj operatorit një ose disa nga masat e mëposhtme:

i. i kërkon rritje të kapitalit dhe të burimeve financiare, me qëllim që të sigurojë funksionimin e sigurt, të rregullt dhe të vazhdueshëm të veprimtarisë së sistemit në kuadër të adresimit të ekspozimeve të mundshme;

ii. urdhëron ndërprerjen e veprimeve në kundërvajtje, si dhe ndreqjen e shkeljeve të dispozitave ligjore ose nënligjore.

2. Banka ndërmerr veprime të mëtejshme në rast të mosrespektimit të detyrimeve që rrjedhin nga ligji për sistemin dhe aktet nënligjore.

3. Banka vendos sanksione administrative sipas nenit 12 të ligjit për sistemin.

4. Sanksionet administrative dhe masat e tjera, të ndryshme nga revokimi ose pezullimi i licencës, miratohen dhe nënshkruhen nga zëvendësguvernatori i parë i Bankës.

Neni 50
Ankimi

1. Operatori i cenuar nga një akt administrativ i Bankës ka të drejtë të kërkojë shfuqizimin ose ndryshimin e këtij akti nga Guvernatori brenda

15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose nga data e publikimit të tij.

2. Banka, para nxjerrjes së aktit administrativ, i jep operatorit, ndaj të cilit propozohet marrja e masës, të drejtën për t'u shprehur me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve, në lidhje me marrjen e masës së propozuar.

3. Realizimi i ankimit administrativ te Guvernatori është kusht i domosdoshëm për ezaurimin e rekursit administrativ dhe për t'i dhënë mundësi operatorit të cenuar t'i drejtohet gjykatës.

4. Ankimi administrativ sipas pikës 1, nuk e pezullon zbatimin e aktit administrativ të nxjerrë nga Banka, në rastet kur kjo e fundit çmon se stabiliteti i sistemit financiar në tërësi, mund të cenohet apo të rrezikohet nga efekti pezullues i ankimit.

5. Ankimi administrativ paraqitet në formë shkresore dhe duhet të shprehë shkaqet për të cilat ankimohet akti administrativ, si dhe duhet të ketë të bashkëlidhur një kopje të aktit.

6. Në të gjitha ato raste kur Banka çmon se zbatimi i menjëhershëm i aktit administrativ i shërben interesave të sigurisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit financiar në tërësi, ajo mund ta kushtëzojë fillimin e procedurës së ankimit administrativ me ofrimin nga ana e shtetasve ose subjekteve juridike të cenuara, të garancive juridike të përshtatshme për ekzekutimin paraprak dhe të menjëhershëm të aktit administrativ.

KRYETARI
Gent Sejko

Formular nr. 1

KËRKESË
DREJTUAR
BANKËS SË SHQIPËRISË
PËR T'U LICENCUAR
SI OPERATOR SISTEMI PËR SHLYERJEN E TITUJVE

Emri i subjektit: _____
Vendndodhja e propozuar: Adresa _____, Shqipëri
(Qyteti) (Rrethi)

Me anë të kësaj kërkese i drejtohemi Bankës së Shqipërisë, duke i vënë në dispozicion çdo informacion të kërkuar prej saj, për të na pajisur me licencë për të kryer veprimtari si "Sistem për shlyerjen e titujve".

Në aktivitetin që ne propozojmë të kryejmë, angazhohemi për zbatimin e ligjit nr. 133/2013, datë 29.4.2013 "Për sistemin e pagesave" dhe të akteve nënligjore përkatëse.

Kërkuesit
_____
_____
_____

Shënim: Kërkesa e shoqëruar me dokumentet dhe me formularët e kërkuar në mbështetje të rregullores dërgohen në adresën e mëposhtme:

Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës
Banka e Shqipërisë

Tiranë, Shqipëri

Formular nr. 2

VENDIMI
I ----------
(ORGANIT VENDIMMARRËS)
PËR CAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE

---------- (Organi vendimmarrës) vërteton që, me sa dimë e besojmë, informacioni i paraqitur në këtë kërkesë është i vërtetë dhe i plotë. Për më tepër, ---------- (organi vendimmarrës) emëron dhe përcakton si përfaqësues:

_____

(Emri) (Atësia) (Mbiemri)

Adresa: _____

(Rruga, Numri) (Qyteti) (Shteti)

_____ _____

(Numri i telefonit) (Numri i faksit/teleksit)

Përfaqësuesi i mësipërm është i autorizuar të përfaqësojë subjektin dhe të paraqitet të nënshkruajë para Bankës së Shqipërisë, përveç rasteve kur Banka e Shqipërisë, do të kërkojë veprime personale nga anëtarët e ---------- (organit vendimmarrës).

Përfaqësuesi është i autorizuar të bëjë gjithçka të nevojshme, në mënyrë sa më të plotë dhe të përmbushë të gjitha synimet dhe qëllimet siç do të mund t'i bënte vetë i nënshkruari, nëse do të paraqiste dhe do të merrte personalisht gjithë korrespondencën dhe dokumentet nga Banka e Shqipërisë.

Datë _____,

(Emri mbiemri) (Nënshkrimi)

_____ _____

Shënim: Ky formular duhet të vërtetohet nga noteri.

Formular nr. 3

PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
PËR 3 VITET E PARA TË AKTIVITETIT

TË ARDHURAT

_____
_____
_____
_____

TOTALI I TË ARDHURAVE _____ Lekë

SHPENZIMET

_____
_____
_____
_____

TOTALI I SHPENZIMEVE _____ Lekë

TË ARDHURAT NETO PARA TAKSAVE _____ Lekë

Formular nr. 4

DEKLARATË

Nëpërmjet së cilës unë deklaroj se informacioni i paraqitur këtu, me sa di dhe besoj, është i vërtetë dhe i saktë. Ai pasqyron të gjitha pasuritë dhe detyrimet dhe nuk përmban fshehje të fakteve. Deklaroj se informacioni i dhënë, i paraqitet vullnetarisht nga unë Bankës së Shqipërisë.

Çdo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve në këtë raport, mund të jetë shkak që Banka e Shqipërisë të refuzojë pjesëmarrjen time në kërkesë dhe në atë shkallë që kjo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve, pasqyron ndershmërinë dhe personalitetin tim, kjo mund të shërbejë si shkak për refuzimin e krejt kërkesës.

Në qoftë se kërkohet informacion financiar shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

_____ _____

(Data) (nënshkrimi i plotë)

Në qoftë se është i zbatueshëm:

_____

(nënshkrimi i përgatitësit)

Nënshkruar në datë: _____

_____

(Nënshkrimi i noterit)

Shënim: Do të plotësohet nga çdo aksionar.

Formular nr. 5

AUTORIZIM PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

(Të plotësohet secili prej dy formularëve të autorizimit në origjinal)

ATIJ QË MUND T'I INTERESOJË:

Unë,_____, me këtë shkresë autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, firme, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate ose institucioni, të cilët kanë kontroll mbi çdo lloj dokumenti, regjistri ose informacioni tjetër që ka të bëjë me mua, t'i paraqesë origjinalin ose kopjet e çdo lloj dokumenti, regjistri apo informacioni tjetër Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës apo ndonjë personi të autorizuar prej saj, për qëllime të inspektimit ose të kopjimit të tyre në zbatim të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

_____

Emri Mbiemri

_____

Adresa e plotë

_____

Data (data /muaji/viti)

Nënshkrimi

Nënshkruar në praninë time

Data_____,

(NËNSHKRIMI I NOTERIT)

_ _

ATIJ QË MUND T'I INTERESOJË:

Unë,_____, me këtë shkresë autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, firme, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate ose institucioni, të cilët kanë kontroll mbi çdo lloj dokumenti, regjistri ose informacioni tjetër që ka të bëjë me mua, t'i paraqesë origjinalin ose kopjet e çdo lloj dokumenti, regjistri apo informacioni tjetër Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës apo ndonjë personi të autorizuar prej saj, për qëllime të inspektimit ose të kopjimit të tyre në zbatim të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

_____

Emri Mbiemri_____

Adresa e plotë

_____ _____

Data Nënshkrimi

Nënshkruar në datë _____
(NËNSHKRIMI I NOTERIT)

Shënim: Do të plotësohet nga çdo aksionar.

VENDIM
Nr. 27, datë 28.3.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR RAPORTIN E MBULIMIT ME LIKUIDITET"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 3, nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë', i ndryshuar, të nenit 26, pika 1, shkronja "a" dhe nenit 66, të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për raportin e mbulimit me likuiditet", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Rregullorja "Për raportin e mbulimit me likuiditet" hyn në fuqi në datën 1 mars 2020, me përjashtimet e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4, të nenit 30.
3. Bankat, deri në hyrjen në fuqi të rregullores "Për raportin e mbulimit me likuiditet", marrin masat dhe krijojnë kushtet e nevojshme për zbatimin e kërkesave të rregullores. Bankat raportojnë në Bankën e Shqipërisë në lidhje me ecurinë e marrjes së masave.
4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare të Bankës së Shqipërisë, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
5. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i:

a) kritereve dhe rregullave për llogaritjen e raportit të mbulimit me likuiditet; dhe

b) nivelit minimal të raportit të mbulimit me likuiditet.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë, të cilat, për thjeshtësi, këtu e më poshtë në këtë rregullore, do të quhen "banka".

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 3, pika 3, nenit 12, shkronja "a", dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe

b) nenit 26, pika 1, shkronja "a" dhe nenit 66, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhet ligji "Për bankat".

Neni 4
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin "Për bankat" dhe në rregulloren nr. 48, datë 31.7.2013 "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit" (e cila, për thjeshtësi, në këtë rregullore do të quhet "rregullorja e mjaftueshmërisë së kapitalit").

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Aktive të nivelit 1" janë aktivet me likuiditet dhe cilësi kredie tepër të lartë, siç përcaktohen në nenin 11 të kësaj rregulloreje;

b) "Aktive të nivelit 2" janë aktivet me likuiditet dhe cilësi kredie të lartë, që përbëhen nga aktivet e nivelit 2A dhe të nivelit 2B, siç përcaktohen në kreun III të kësaj rregulloreje;

c) "Aktive likuide" është shuma e aktiveve të nivelit 1 dhe aktiveve të nivelit 2;

d) "Rezervë likuiditeti (*liquidity buffer*)" - është shuma e aktiveve likuide që banka përfshin në përllogaritjen e raportit të mbulimit me likuiditet, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;

e) "Flukse dalëse neto të likuiditetit" është diferenca midis flukseve dalëse dhe flukseve hyrëse të likuiditetit të bankës, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;

f) "Monedhë e rëndësishme" është çdo monedhë, në të cilën detyrimet e denominuara dhe të pagueshme në këtë monedhë (brenda dhe jashtë bilancit) përbëjnë të paktën 5% të detyrimeve totale të bankës (brenda dhe jashtë bilancit);

g) "Kërkesë e mbulimit me aktive" është raporti i aktiveve me detyrimet, siç përcaktohet nga legjislacioni përkatës i vendit ku emetuesi është i regjistruar, për qëllime të përmirësimit të cilësisë së kredisë, në lidhje me obligacionet e garantuara;

h) "Ndërmarrje të vogla dhe të mesme (SME)" janë ndërmarrjet, siç përkufizohen në nenin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit;

i) "Depozitë" ka të njëjtin kuptim siç përcaktohet në nenin 4, pika 5, të ligjit për bankat;

j) "Depozitë me pakicë (*retail*)" është depozita e një individi (personi fizik) ose një ndërmarrjeje të vogël apo të mesme, ku individi ose ndërmarrja e vogël apo e mesme kualifikohet në klasën e ekspozimit me pakicë, sipas përcaktimeve në rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe depozitat agregate të individit ose të ndërmarrjes dhe palëve të lidhura, nuk tejkalojnë 50 milionë lekë;

k) "Depozitë me shumicë (*wholesale*)" është çdo depozitë që nuk përfshihet në kategorinë e depozitave me pakicë (*retail*);

l) "Financim" është detyrimi në formë borxhi/huaje, i cili nuk përfshihet në kategorinë e depozitave;

m) "Financim i garantuar" (*secured funding*) janë detyrimet e bankës të garantuara me të drejta ligjore mbi pasuri të përcaktuara posaçërisht, në pronësi të bankës huamarrëse, në rast falimentimi, paaftësie paguese, likuidimi ose ndërhyrjeje të jashtëzakonshme;

n) "Financim tregtar" (*trade finance*) është financimi, duke përfshirë edhe garancitë, i lidhur me këmbimin e mallrave dhe shërbimeve, nëpërmjet produkteve financiare me maturitet afatshkurtër të përcaktuar, përgjithësisht më pak se një vit, pa rinovim automatik. Financimi tregtar përfshin kreditë dokumentare, garancitë dhe angazhimet, letër kreditë e parevokueshme, etj., siç parashikohen në aneksin 2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit;

o) "Klient financiar" është një subjekt, i cili si veprimtari të veta kryesore kryen një ose disa nga veprimtaritë e renditura në nenin 54 të ligjit për bankat, ose është një nga subjektet e mëposhtme:

i. bankë;

ii. shoqëri kursim-krediti dhe union i shoqërive të kursim-kreditit;

iii. shoqëri investimi;

iv. entitet me qëllim të posaçëm titullzimi (SSPE);

v. sipërmarrje investimesh kolektive (SIK);

vi. shoqëri sigurimi;

vii. shoqëri risigurimi;

viii. shoqëri financiare zotëruese; ose

ix. çdo person juridik që kryen veprimtari financiare, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë;

p) "Stres" është situata e përkeqësimit të menjëhershëm ose të konsiderueshëm në aftësinë paguese ose në pozicionin e likuiditetit të bankës, për shkak të ndryshimeve në kushtet e tregut ose në faktorët specifikë të bankës, të cilët mund të çojnë në paaftësinë e bankës për të përmbushur detyrimet që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike;

q) "*collateral swap"* – është huadhënia e aktiveve likuide (për shembull, tituj të emetuar nga qeveria), në këmbim të huamarrjes së garancive (kolateraleve) më pak likuide, për të cilat huamarrësi i aktiveve likuide i paguan një komision huadhënësit, për të kompensuar rrezikun që rrjedh nga mbajtja e aktiveve më pak likuide.

KREU II
KËRKESA PËR MBULIMIN ME LIKUIDITET

Neni 5
Raporti i mbulimit me likuiditet

1. Bankat llogarisin raportin e mbulimit me likuiditet (RML) si raport të rezervës së likuiditetit të bankës, me flukset dalëse neto të likuiditetit, gjatë një periudhe stresi prej 30 ditësh kalendarike, të shprehur në përqindje, në baza individuale dhe të konsoliduara, sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{Raporti i mbulimit me likuiditet (\%)} = \frac{\text{Rezerva e likuiditetit}}{\text{Flukset dalëse neto të likuiditetit përgjatë një periudhe stresi prej 30 ditësh kalendarike}}$$

2. Bankat sigurojnë në çdo kohë një raport të mbulimit me likuiditet prej të paktën 100% në total dhe të paktën 80% për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme.

3. Bankat, në përputhje me oreksin/tolerancën ndaj rrezikut, përcaktojnë në politikat e tyre të brendshme, kufij për raportin e mbulimit me likuiditet, për monedhën vendase (lek) dhe çdo monedhë të huaj të rëndësishme dhe monitorojnë në vazhdimësi respektimin e këtyre kufijve.

4. Bankat, pa rënë ndesh me pikën 2 të këtij neni, mund të kthejnë në para (cash) aktivet e tyre likuide, për të mbuluar flukset dalëse neto gjatë periudhave të stresit, edhe nëse ky kthim në para (cash) i aktiveve likuide mund të rezultojë në rënien e raportit të mbulimit me likuiditet nën nivelin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, gjatë këtyre periudhave të stresit.

5. Banka njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë dhe i paraqet asaj një plan për rikthimin e raportit të mbulimit me likuiditet në nivelet e kërkuara në këtë rregullore, nëse ky raport ka rënë ose pritet të bjerë nën nivelin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni. Banka raporton në Bankën e Shqipërisë mbi baza ditore, derisa raporti i mbulimit me likuiditet të rikthehet në nivelin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe nga Banka e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë mund të lejojë një frekuencë më të ulët raportimi nga sa përcaktohet më sipër, duke marrë në konsideratë madhësinë dhe kompleksitetin e bankës.

6. Banka e Shqipërisë monitoron planin e rikthimit të raportit të mbulimit me likuiditet në nivelin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni dhe mund t'i kërkojë bankës rikthimin e këtij raporti në nivelet e kërkuara, brenda një afati më të shkurtër kohor nga sa banka e kishte parashikuar në plan.

7. Bankat përllogarisin dhe monitorojnë raportin e tyre të mbulimit me likuiditet, sipas përcaktimeve në anekset e kësaj rregulloreje.

8. Banka, për qëllime të raportimit mbi baza të konsoliduara, siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni, merr parasysh edhe kërkesat e mëposhtme:

a) aktivet e filialit/degës së bankës në një vend

të huaj, që plotësojnë kërkesat e parashikuara në kreun III të kësaj rregulloreje, nuk do të njihen si aktive likuide për qëllime të konsolidimit, nëse ato nuk kualifikohen si aktive likuide sipas kërkesave ligjore/rregullative të atij vendi, që përcaktojnë kërkesën për mbulimin me likuiditet;

b) flukset dalëse të likuiditetit të filialit/degës së bankës në një vend të huaj, të cilat sipas kërkesave ligjore/rregullative të atij vendi, që përcaktojnë kërkesën për mbulimin me likuiditet, janë subjekt i normave më të larta të flukseve dalëse nga sa parashikohet në kreun IV të kësaj rregulloreje, për qëllime të konsolidimit, do të jenë subjekt i këtyre normave më të larta të flukseve dalëse;

c) flukset hyrëse të likuiditetit të filialit/degës së bankës në një vend të huaj, të cilat sipas kërkesave ligjore/rregullative të atij vendi, që përcaktojnë kërkesën për mbulimin me likuiditet, janë subjekt i normave më të ulëta të flukseve hyrëse, nga sa parashikohet në kreun IV të kësaj rregulloreje, për qëllime të konsolidimit do të jenë subjekt i këtyre normave më të ulëta të flukseve hyrëse;

d) për filialin/degën e bankës në një vend të huaj, ku zbatohen kërkesa ligjore/rregullative të ndryshme nga kërkesat për raportin e mbulimit me likuiditet të parashikuara në këtë rregullore, përllogaritjet për qëllime të konsolidimit do të kryhen sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

Neni 6
Skenarët e stresit për qëllime të llogaritjes së raportit të mbulimit me likuiditet

1. Banka, për përllogaritjen e raportit të mbulimit me likuiditet, konsideron si tregues/sinjalizues të rrethanave në të cilat ajo ndodhet në një situatë stresi, skenarë të tillë si:

a) tërheqja e një pjese të rëndësishme/të konsiderueshme të depozitave me pakicë (*retail*);

b) një humbje e plotë ose e pjesshme e kapacitetit të bankës për të siguruar financime të pagarantuara me shumicë, duke përfshirë edhe depozitat me shumicë dhe burimet e tjera të financimit në situata emergjence, të tilla si linjat e marra të kredisë apo të likuiditetit;

c) një humbje e plotë ose e pjesshme e financimit afatshkurtër të garantuar;

d) flukse dalëse shtesë të likuiditetit, si rezultat i një përkeqësimi në vlerësimin e cilësisë së kredisë së bankës, deri në tri shkallë (*notches*);

e) rritja e luhatshmërisë (volatilitetit) së tregut, e cila ndikon mbi vlerën ose cilësinë e garancisë (kolateralit), apo mbi kërkesat për garanci (kolateral) shtesë;

f) tërheqje të paplanifikuara nga lehtësirat e likuiditetit dhe të kredisë, që banka u ka dhënë klientëve të saj;

g) detyrimi i mundshëm për të riblerë borxhin, apo për të përmbushur detyrime jokontraktuale, me qëllim reduktimin e rrezikut reputacional;

h) etj.

KREU III
REZERVA E LIKUIDITETIT

NËNKREU I
KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Neni 7
Përbërja e rezervës së likuiditetit

1. Banka, për qëllime të përllogaritjes së raportit të mbulimit me likuiditet, përfshin në rezervën e likuiditetit, aktivet likuide që plotësojnë secilën nga kërkesat e mëposhtme:

a) kërkesat e përgjithshme, të përcaktuara në nenin 8 të kësaj rregulloreje;

b) kërkesat operacionale, të përcaktuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje;

c) kriteret përkatëse të pranueshmërisë, për klasifikimin e tyre si aktive të nivelit 1 ose aktive të nivelit 2, në përputhje me nënkreun II të këtij kreu.

Neni 8
Kërkesa të përgjithshme për aktivet likuide

1. Banka përfshin në aktivet likuide, aktivet të cilat plotësojnë kërkesat e përcaktuara në pikat 2 deri në 6 të këtij neni.

2. Aktivet likuide janë në formën e një të drejte, pretendimi ose interesi të mbajtur nga banka, dhe duhet të jenë të lira nga çdo barrë apo detyrim. Banka konsideron një aktiv të lirë nga çdo barrë apo detyrim, nëse nuk ekziston ndonjë pengesë ligjore/nënligjore, kontraktuale ose ndonjë kufizim tjetër që pengon shitjen,

transferimin ose cedimin e të drejtave që rrjedhin nga e drejta e pronësisë, ose në përgjithësi, largimin e një aktivi të tillë nga portofoli i bankës, nëpërmjet shitjes me të drejta të plota ose nëpërmjet marrëveshjes së riblerjes, brenda 30 ditëve të ardhshme kalendarike (për shembull, aktivet, të cilat janë të disponueshme për përdorim të menjëhershëm si garanci (kolateral), me qëllim sigurimin e fondeve shtesë për bankën, nëpërmjet linjave të miratuara të kredisë, por ende të patërhequra/papërdorura; aktivet, që banka ka marrë si garanci për qëllime të zbutjes së rrezikut të kredisë, në transaksionet e marrëveshjeve të anasjella të riblerjes ose në transaksionet e financimit nëpërmjet titujve dhe të cilat banka mund t'i shesë etj.).

3. Aktivet likuide nuk janë emetuar nga vetë banka, nga aksioneri i saj (përveç rastit kur aksioneri është subjekt i sektorit publik, por nuk është një bankë), nga një filial i saj apo një filial tjetër i aksionerit të saj, ose nga një entitet me qëllim të posaçëm titullzimi (SSPE), me të cilin banka është palë e lidhur.

4. Aktivet likuide nuk janë emetuar nga:

a) një bankë tjetër, me përjashtim të rastit kur aktivi është një obligacion i garantuar, siç përcaktohet në nenin 12, pika 1, shkronja "b", të kësaj rregulloreje;

b) një shoqëri investimi;

c) një shoqëri sigurimi;

d) një shoqëri risigurimi;

e) një shoqëri financiare zotëruese;

f) çdo subjekt tjetër që ushtron veprimtari financiare.

Për qëllime të këtij neni, SSPE-të nuk do të përfshihen në subjektet e përmendura më lart.

5. Vlera e aktiveve likuide përcaktohet në bazë të çmimeve të tregut, të publikuara gjerësisht dhe të disponueshme lehtësisht, ose në rast të mungesës së këtyre çmimeve të tregut, vlera përcaktohet në bazë të një formule të thjeshtë që përdor të dhëna të publikuara dhe që bazohet në supozime të vërteta (realiste).

6. Aktivet likuide janë të listuara në një bursë të njohur ose janë të tregtueshme në tregje përgjithësisht të pranuara të riblerjes, nëpërmjet shitjes me të drejta të plota ose nëpërmjet transaksioneve të thjeshta të riblerjes. Banka i vlerëson këto kritere për secilin treg në mënyrë të veçantë. Një aktiv i pranuar për tregtim në një treg të organizuar, i cili nuk është një bursë e njohur, do të konsiderohet likuid vetëm nëse ky treg është aktiv dhe me madhësi të konsiderueshme për shitjet me të drejta të plota të aktiveve. Banka, për qëllime të kësaj pike, do të konsiderojë një treg aktiv dhe me madhësi të konsiderueshme, bazuar të paktën në kriteret e mëposhtme:

a) të dhënat historike mbi likuiditetin e tregut (gjerësinë dhe thellësinë e tregut), të provuara nga marzhet e ulëta midis çmimit të ofruar dhe atij të kërkuar (*bid-ask spread*), vëllimi i lartë i transaksioneve dhe numri i lartë dhe i diversifikuar i pjesëmarrësve të tregut;

b) praninë e një infrastrukture të qëndrueshme (të shëndetshme) të tregut.

7. Kërkesat e përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni, nuk do të zbatohen për:

a) monedhat dhe kartëmonedhat, siç përcaktohen në nenin 11, pika 1, shkronja "a", të kësaj rregulloreje; dhe

b) ekspozimet ndaj bankave qendrore, të përcaktuara në nenin 11, pika 1, shkronjat "b" dhe "d" dhe në nenin 12, pika 1, shkronja "a", të kësaj rregulloreje.

8. Banka përjashton nga përllogaritjet, flukset hyrëse të likuiditetit të lidhura me një aktiv likuid, në rast se aktivi është përfshirë në rezervën e likuiditetit.

Neni 9
Kërkesa operacionale

1. Bankat hartojnë politika të brendshme dhe përcaktojnë kufij, për të siguruar në çdo kohë një rezervë likuiditeti të diversifikuar në mënyrë të përshtatshme, e cila konsideron nivelin e diversifikimit midis kategorive të ndryshme të aktiveve likuide si dhe brenda të njëjtës kategori të tyre (aktiveve likuide), të përcaktuara në nënkreun II të këtij kreu, sipas llojeve të ndryshme të emetuesve, kundërpartive, ose sipas vendndodhjes gjeografike të këtyre emetuesve dhe kundërpartive.

Banka e Shqipërisë mund të caktojë kufizime ose kërkesa specifike për bankat, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat e kësaj pike.

2. Kërkesat e pikës 1 të këtij neni, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore, nuk zbatohen për kategoritë e mëposhtme të aktiveve të nivelit 1:

a) monedhat dhe kartëmonedhat, siç përcaktohen në nenin 11, pika 1, shkronja "a", të kësaj rregulloreje;

b) ekspozimet ndaj bankave qendrore, të përcaktuara në nenin 11, pika 1, shkronjat "b" dhe "d", të kësaj rregulloreje;

c) aktivet që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveritë qendrore të referuara në nenin 11, pika 1, shkronjat "c" dhe "d", të kësaj rregulloreje;

d) aktivet që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe organizatat ndërkombëtare të përcaktuara në nenin 11, pika 1, shkronja "e", të kësaj rregulloreje.

3. Bankat kanë akses të menjëhershëm në aktivet likuide që zotërojnë dhe mund t'i kthejnë në para këto aktive në çdo kohë, gjatë periudhës së stresit prej 30 ditësh kalendarike, nëpërmjet shitjes me të drejta të plota ose marrëveshjes së riblerjes, në tregjet përgjithësisht të pranuara të riblerjes.

4. Për qëllime të pikës 3 të këtij neni, bankat konsiderojnë një aktiv likuid, me akses të menjëhershëm, përkatësisht në rastet e mëposhtme:

a) kur nuk ka pengesa ligjore ose praktike në aftësinë e bankës për ta kthyer këtë aktiv në para në kohën e duhur (aktivet që përdoren për të siguruar përmirësimin e cilësisë së kredisë në transaksionet e strukturuara ose për të mbuluar kostot operacionale të bankës, nuk do të konsiderohen si të aksesueshme në mënyrë të menjëhershme për bankën);

b) kur aktivet e vendosura në një vend të huaj, ku ka kufizime për transferimin e lirë të tyre, përdoren nga banka për të mbuluar flukset dalëse të likuiditetit në atë vend;

c) kur aktivet e mbajtura në një monedhë të pakonvertueshme, përdoren nga banka për të mbuluar flukset dalëse të likuiditetit në atë monedhë.

5. Banka i vendos aktivet likuide nën kontrollin e funksionit përgjegjës për administrimin e likuiditetit, i cili ka autoritet dhe aftësi ligjore dhe operacionale për të kthyer në para çdo aktiv likuid që bën pjesë në rezervën e likuiditetit. Ushtrimi i kontrollit provohet nëpërmjet:

a) vendosjes së aktiveve likuide nën administrimin e drejtpërdrejtë të këtij funksioni, me qëllimin e vetëm për përdorimin e tyre si burim të fondeve të emergjencës (*contingent)*, duke përfshirë edhe përgjatë periudhave të stresit;

b) krijimit të sistemeve të brendshme dhe të kontrollit, si dhe hartimit të politikave dhe procedurave që i lejojnë këtij funksioni, një kontroll efektiv operacional të likuiditetit, për të kthyer në para vendosjet në aktive likuide, në çdo moment gjatë periudhës së stresit prej 30 ditësh kalendarike dhe për të aksesuar fondet e emergjencës, pa rënë ndesh drejtpërdrejt me ndonjë strategji ekzistuese të biznesit apo të administrimit të rrezikut. Në veçanti, një aktiv nuk do të përfshihet në rezervën e likuiditetit, nëse shitja e tij pa u zëvendësuar gjatë gjithë periudhës së stresit prej 30 ditësh kalendarike, do të përfundonte mbrojtjen *(hedge*), e cila do të krijonte një pozicion të hapur rreziku që tejkalon kufijtë e brendshëm të bankës; ose

c) kombinimit të përcaktimeve në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike.

6. Banka, për qëllime testimi, në mënyrë periodike dhe të paktën një herë në vit, kthen (shndërron) në para një kampion (përqindje) përfaqësues të mjaftueshëm të aktiveve likuide të mbajtura prej saj, nëpërmjet shitjes me të drejta të plota ose nëpërmjet marrëveshjes së thjeshtë të riblerjes në një treg përgjithësisht të pranuar të riblerjes. Banka përcakton në politikat e brendshme, madhësinë e kampionit përfaqësues, si dhe harton strategji për shitjen e kampionëve të aktiveve likuide, të cilët janë të mjaftueshëm për të:

a) testuar aksesin në treg dhe përdorimin e këtyre aktiveve;

b) kontrolluar efektivitetin e proceseve të bankës për kthimin në para të këtyre aktiveve, në kohën e duhur;

c) minimizuar rrezikun e dhënies së sinjaleve negative në treg, si pasojë e kthimit në para të aktiveve të bankës, gjatë periudhave të stresit të likuiditetit.

7. Kërkesa e parashikuar në pikën 6 të këtij neni, nuk zbatohet për aktivet e nivelit 1 të përcaktuara në nenin 11 të kësaj rregulloreje.

8 Kërkesat e përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, nuk i pengojnë bankat që të realizojnë mbrojtjen ndaj rrezikut të tregut, të lidhur me aktivet e tyre likuide, në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) banka harton procedura të brendshme në përputhje me pikat 3 deri në 5 të këtij neni, duke siguruar që këto aktive vazhdojnë të jenë lehtësisht të disponueshme dhe nën kontrollin e funksionit të administrimit të likuiditetit;

b) banka, gjatë vlerësimit të aktivit përkatës në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje, merr në konsideratë flukset dalëse dhe flukset hyrëse neto të likuiditetit, që do të rezultonin në rast të përfundimit të parakohshëm të mbrojtjes (*hedge*) (në rastin e shitjes së aktivit likuid).

Neni 10
Vlerësimi i aktiveve likuide

Banka, për qëllime të llogaritjes së raportit të mbulimit me likuiditet, përdor vlerën e tregut të aktiveve të saj likuide. Vlera e tregut e aktiveve likuide reduktohet në përputhje me haircut-et e përcaktuara në nënkreun II të këtij kreu dhe siç parashikohet në nenin 9, pika 8, shkronja "b", në rastet kur është e zbatueshme.

NËNKREU II
AKTIVET LIKUIDE

Neni 11
Aktivet e nivelit 1

1. Banka, në aktivet e nivelit 1, përfshin aktivet që klasifikohen në një ose disa nga kategoritë e mëposhtme dhe që plotësojnë në çdo rast, kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në vijim:

a) arka (monedhat dhe kartëmonedhat);

b) ekspozime ndaj bankave qendrore si më poshtë:

i. aktive, të cilat përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga Banka e Shqipërisë, të ndryshme nga aktivet e parashikuara në nënpikën "iii" të kësaj shkronje,

ii. aktive, të cilat përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga banka qendrore të vendeve të huaja, me kusht që ekspozimeve ndaj bankës qendrore ose qeverisë qendrore të këtyre vendeve, u është caktuar cilësia e kredisë e shkallës 1, nga një ECAI e emëruar, në përputhje me nenin 12, pika 2, të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit,

iii. rezerva e detyrueshme e mbajtur në Bankën e Shqipërisë, deri në masën e lejuar të përdorimit të saj, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, si dhe për filialet ose degët e bankës në vendet e huaja, rezerva e detyrueshme e mbajtur në bankat qendrore të parashikuara në nënpikën "ii" të kësaj shkronje, deri në masën e lejuar të përdorimit të saj, sipas përcaktimeve të bankës qendrore përkatëse;

c) aktive, të cilat përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveritë qendrore ose rajonale, ose autoritetet lokale të mëposhtme:

i. qeveria shqiptare, të emetuara dhe të financuara në monedhë kombëtare,

ii. qeveria shqiptare, të emetuara dhe të financuara në monedhë të huaj, deri në shumën e flukseve dalëse neto të likuiditetit në atë monedhë të huaj, që i korrespondon veprimtarive të bankës në Shqipëri,

iii. qeveria qendrore e një vendi të huaj, me kusht që t'i jetë caktuar cilësia e kredisë e shkallës 1, nga një ECAI e emëruar, në përputhje me nenin 12, pika 2, të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit,

iv. qeveritë rajonale ose autoritetet lokale në vende të huaja, me kusht që ato të trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore, në përputhje me nenin 13 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të cilave u është caktuar cilësia e kredisë e shkallës 1, nga një ECAI e emëruar;

d) aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria qendrore ose banka qendrore e një vendi të huaj, të denominuara në monedhën vendase të atij vendi, ku banka e ushtron veprimtarinë nëpërmjet një dege ose filiali, së cilës nuk i është caktuar një vlerësim i cilësisë së kredisë i shkallës 1, në përputhje me nenin 12, pika 2, të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, me kusht që në këtë rast banka mund ta përfshijë aktivin në aktivet e nivelit 1, me qëllim mbulimin e flukseve dalëse neto të likuiditetit, në atë juridiksion.

Në rastet kur aktivi nuk është i denominuar në monedhën vendase të vendit të huaj, ku banka e ushtron veprimtarinë nëpërmjet një dege ose

filiali, banka e përfshin aktivin në aktivet e nivelit 1, deri në shumën e flukseve dalëse neto të likuiditetit në atë monedhë të huaj, që i korrespondon veprimtarive të saj në atë juridiksion;

e) aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe organizatat ndërkombëtare, siç përcaktohen në nenin 15, pika 3 dhe në nenin 16 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

2. Banka, mbi vlerën e tregut të aktiveve të parashikuara në pikën 1, shkronja "c", nënpika "i" të këtij neni, zbaton një *haircut* prej 10% dhe mbi vlerën e tregut të aktiveve të parashikuara në pikën 1, shkronja "c", nënpika "ii", të këtij neni, zbaton një *haircut* prej 15%.

Neni 12
Aktivet e nivelit 2A

1. Banka, në aktivet e nivelit 2A, përfshin aktivet që klasifikohen në një ose disa nga kategoritë e mëposhtme dhe, në çdo rast, plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në vijim:

a) aktive, të cilat përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria qendrore ose banka qendrore, nga qeveritë rajonale, ose autoritetet lokale të një vendi të huaj, në rastin kur këtyre ekspozimeve u është caktuar një peshë rreziku prej 20%, në përputhje me nenet 12 dhe 13 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit;

b) ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara, të emetuara nga bankat në vende të huaja, të cilat plotësojnë të gjitha kërkesat e mëposhtme:

i. janë obligacione të garantuara, në përputhje me legjislacionin përkatës të vendit të huaj, i cili duhet t'i përcaktojë këto obligacione si tituj borxhi, të emetuara nga bankat ose nga një filial i zotëruar plotësisht nga një bankë, e cila garanton emetimin dhe janë të siguruara nga një fond garantues (*cover pool*) aktivesh, për të cilat zotëruesi i obligacioneve do të ketë një rekurs të drejtpërdrejtë për shlyerjen e principalit dhe interesit, duke i dhënë prioritet në rast falimentimi të emetuesit;

ii. emetuesi dhe obligacionet e garantuara, bazuar në legjislacionin përkatës të vendit të huaj, janë subjekt i një mbikëqyrjeje të veçantë publike që synon mbrojtjen e mbajtësve të obligacioneve, si dhe i kuadrit mbikëqyrës dhe rregullator të zbatuar në vendin e huaj;

iii. garantohen nga një ose disa prej aktiveve të parashikuara në nenin 26, pika 1, shkronjat "b", "d" dhe "e", të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Kur fondi garantues përbëhet nga kredi të siguruara me pasuri të paluajtshme, duhet të plotësohen kërkesat minimale të parashikuara në aneksin 1 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit;

iv. ekspozimet ndaj institucioneve në fondin garantues (*cover pool*) plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 26, pika 1, shkronja "c", të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit,

v. banka që investon në obligacionet e garantuara dhe emetuesit përmbushin kërkesat e mëposhtme të transparencës, në lidhje me informacionin mbi portofolin e investimit, që emetuesi duhet t'i vendosë në dispozicion çdo tremujor bankës investuese, i cili (informacioni) përmban minimalisht:

- vlerën e fondit garantues (*cover pool*) dhe tepricën (*outstanding*) e obligacioneve të garantuara;
- shpërndarjen gjeografike dhe llojet e aktiveve që garantojnë obligacionet e garantuara, madhësinë e kredisë, normën e interesit dhe rrezikun e kursit të këmbimit;
- strukturën e maturitetit të obligacioneve të garantuara dhe të aktiveve që i garantojnë këto obligacione; dhe
- përqindjen e kredive të cilat janë më shumë se 90 ditë në vonesë;

vi. obligacioneve të garantuara u është caktuar cilësia e kredisë e shkallës 1 nga një ECAI e emëruar, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit, një vlerësim ekuivalent në rastin e vlerësimit afatshkurtër të kredisë, ose në mungesë të vlerësimit të cilësisë së kredisë, obligacioneve të garantuara u është caktuar një peshë rreziku prej 10%, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit;

vii. fondi garantues (*cover pool*) plotëson në çdo kohë një kërkesë të mbulimit me aktive prej të paktën 7% më të lartë se shuma e kërkuar për të përmbushur kërkesat që lidhen me obligacionet e garantuara. Megjithatë, kur vlera totale e emetimit të obligacioneve të garantuara është të paktën 500 milionë euro (ose shuma ekuivalente

në monedhën vendase), ato duhet të jenë subjekt i një kërkese minimale të mbulimit me aktive prej 2%;

c) tituj të borxhit të shoqërive tregtare, të cilat plotësojnë të gjitha kërkesat e mëposhtme:

i. është caktuar një vlerësim i cilësisë së kredisë i shkallës 1, nga një ECAI e emëruar, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit ose një vlerësim ekuivalent në rastin e një vlerësimi afatshkurtër të kredisë;

ii. vlera totale e emetimit të titujve është të paktën 250 milionë euro (ose shuma ekuivalente në monedhën vendase);

iii. afati maksimal deri në maturim i këtyre titujve në momentin e emetimit është 10 vjet.

2. Banka, mbi vlerën e tregut të aktiveve të nivelit 2A, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, zbaton një *haircut* prej të paktën 15%.

Neni 13
Aktivet e nivelit 2B

1. Banka, në aktivet e nivelit 2B, përfshin aktivet që klasifikohen në një ose disa nga kategoritë e mëposhtme dhe, në çdo rast, plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në vijim:

a) aktive, të cilat përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria qendrore ose banka qendrore e një vendi të huaj, në rastin kur këtyre ekspozimeve u është caktuar cilësia e kredisë të paktën e shkallës 3, nga një ECAI e emëruar, në përputhje me nenin 12 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit;

b) tituj të borxhit të shoqërive tregtare, të cilat plotësojnë të gjitha kërkesat e mëposhtme:

i. u është caktuar një vlerësim i cilësisë së kredisë të paktën i shkallës 3, nga një ECAI e emëruar, ose një vlerësim ekuivalent, në rastin e vlerësimit afatshkurtër të kredisë;

ii. vlera totale e emetimit të titujve është të paktën 250 milionë euro (ose shuma ekuivalente në monedhën vendase);

iii. afati maksimal deri në maturim i këtyre titujve në momentin e emetimit është 10 vjet.

2. Banka, mbi vlerën e tregut të aktiveve të nivelit 2B, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, zbaton një *haircut* prej të paktën 50%.

Neni 14
Përbërja e rezervës së likuiditetit sipas nivelit të aktiveve

1. Banka, në çdo rast, plotëson kërkesat e mëposhtme për përbërjen e rezervës të likuiditetit, për totalin, për monedhën vendase dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme:

a) të paktën 60% e rezervës së likuiditetit përbëhet nga aktivet e nivelit 1; dhe

b) deri në 15% e rezervës së likuiditetit mund të mbahet në aktive të nivelit 2B.

2. Kërkesat e pikës 1 të këtij neni do të zbatohen pas rregullimit të vlerës së aktiveve likuide, me vlerën e aktiveve likuide që do të shkëmbehen në transaksionet afatshkurtra të financimit të garantuar, transaksionet afatshkurtra të huadhënies së kolateralizuar dhe transaksionet afatshkurtra të *collateral swaps*, kur këto transaksione maturohen brenda 30 ditëve kalendarike, si dhe duke konsideruar çdo *haircut* të zbatueshëm dhe me kusht që banka të plotësojë kërkesat operacionale të përcaktuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje.

3. Banka përcakton përbërjen e rezervës së likuiditetit, në përputhje me formulat e paraqitura në aneksin 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 15
Mosplotësimi i kërkesave

1. Në rast se një aktiv likuid nuk plotëson më, ndonjë nga kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 8, kërkesat operacionale të përcaktuara në pikat 3 dhe 4, të nenit 9, ose ndonjë kriter përshtatshmërie të përcaktuar në këtë nënkre, banka ndalon njohjen e këtij aktivi si aktiv likuid, brenda 30 ditësh kalendarike që nga momenti që ndodh s

hkelja e kërkesave.

KREU IV
FLUKSET DALËSE DHE FLUKSET HYRËSE TË LIKUIDITETIT

NËNKREU I
FLUKSET DALËSE NETO TË LIKUIDITETIT

Neni 16
Përllogaritja e flukseve dalëse neto të likuiditetit

1. Banka përllogarit flukset dalëse neto të likuiditetit, si diferencë midis shumës së flukseve dalëse të likuiditetit, të përcaktuar në shkronjën "a" dhe shumës së flukseve hyrëse të likuiditetit, të përcaktuar në shkronjën "b", të cilat llogariten si më poshtë:

a) shuma e flukseve dalëse të likuiditetit, siç përcaktohen në nënkreun II të këtij kreu;

b) shuma e flukseve hyrëse të likuiditetit, siç përcaktohen në nënkreun III të këtij kreu, e përllogaritur si vlera më e ulët, midis flukseve hyrëse të likuiditetit dhe 75% të flukseve dalëse të likuiditetit.

2. Banka vlerëson flukset hyrëse të likuiditetit dhe flukset dalëse të likuiditetit, përgjatë një periudhe stresi prej 30 ditësh kalendarike, nën supozimin e një skenari stresi të kombinuar, duke përfshirë ngjarje specifike dhe sistemike, siç përcaktohet në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

3. Banka kryen përllogaritjen e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, në përputhje me formulën e paraqitur në aneksin 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 17
Kërkesat për vlerësimin e efektit të kolateralit të marrë në transaksionet e derivativëve

1. Banka përllogarit flukset dalëse dhe flukset hyrëse të likuiditetit, të pritshme përgjatë një periudhe prej 30 ditësh kalendarike për kontratat e listuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, mbi baza neto sipas kundërpartive që janë subjekt i marrëveshjeve dypalëshe të netimit (kompensimit), në përputhje me nenin 134 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

2. Për qëllime të këtij neni, përllogaritjet mbi baza neto marrin në konsideratë rregullimin e vlerës së ekspozimit me vlerën e garancisë (kolateralit), me kusht që garancia të kualifikohet si aktiv likuid sipas kreut III të kësaj rregulloreje. Flukset dalëse dhe flukset hyrëse që krijohen nga transaksionet derivative të monedhave të huaja, që përfshijnë shkëmbimin e plotë të shumave të kryegjësë në të njëjtën kohë (ose brenda së njëjtës ditë), do të llogariten mbi baza neto, edhe në rastin kur këto transaksione nuk mbulohen nga një marrëveshje dypalëshe netimi (kompensimi).

NËNKREU II
FLUKSET DALËSE TË LIKUIDITETIT

Neni 18
Përllogaritja e flukseve dalëse të likuiditetit

1. Banka përllogarit flukset dalëse të likuiditetit, duke shumëzuar tepricën e llogarisë (*outstanding balance*) të çdo detyrimi dhe angazhimi jashtë bilancit, me normat me të cilat këto detyrime/angazhime priten të tërhiqen ose të përdoren (*run off* ose *drawn-down*), siç përcaktohen në këtë nënkre.

2. Flukset dalëse të likuiditetit që përcaktohen në pikën 1 të këtij neni, përfshijnë elementet e mëposhtme, të cilat, në çdo rast, shumëzohen me normën përkatëse:

a) tepricën aktuale (*outstanding amount*) për depozitat e qëndrueshme me pakicë dhe për depozitat e tjera me pakicë, siç përcaktohen në nenet 20 dhe 21 të kësaj rregulloreje;

b) tepricën aktuale (*outstanding amount*) të detyrimeve të tjera që maturohen, që mund të kërkohen të paguhen nga emetuesi apo nga ofruesi i financimeve, ose që përmbajnë një pritshmëri nga ofruesi i financimeve që banka të shlyejë detyrimin përgjatë 30 ditëve të ardhshme kalendarike, siç përcaktohen në nenet 22 dhe 23 të kësaj rregulloreje;

c) flukset dalëse shtesë, siç përcaktohen në nenin 24 të kësaj rregulloreje;

d) shumën maksimale që mund të tërhiqet përgjatë 30 ditëve të ardhshme kalendarike, nga lehtësirat e parevokueshme të patërhequra/të papërdorura të kredisë dhe të likuiditetit që

banka ka dhënë, siç përcaktohen në nenin 25 të kësaj rregulloreje;

e) flukset dalëse shtesë të vlerësuara për produkte dhe shërbime të tjera, siç përcaktohen në nenin 19 të kësaj rregulloreje.

Neni 19
Flukset dalëse shtesë për produkte dhe shërbime të tjera

1. Banka vlerëson rregullisht mundësinë (probabilitetin) e ndodhjes dhe vëllimin e mundshëm të flukseve dalëse të likuiditetit, përgjatë 30 ditëve kalendarike, për produktet ose shërbimet, të cilat nuk parashikohen në nenet 22 deri 25 të kësaj rregulloreje, të cilat banka i ofron ose i garanton, ose të cilat, blerësit e mundshëm do t'i konsiderojnë të lidhura me to. Këto produkte ose shërbime mund të përfshijnë, por pa u kufizuar në, flukset dalëse të likuiditetit që rrjedhin prej detyrimeve të mëposhtme, për të cilat banka zbaton minimalisht normat e flukseve dalëse si vijon:

a) 10% për garancitë e dhëna nga banka;

b) 10% për shumat e patërhequra të linjave të kredisë, të cilat mund të anulohen pa kushte në çdo kohë dhe pa njoftuar;

c) 5% për shumat e patërhequra të kartave të kreditit, kur ato mund të konsiderohen si të anulueshme pa kushte;

d) 7% për shumat e patërhequra të kredive kufi, kur ato mund të konsiderohen si të anulueshme pa kushte;

e) 100% për shumën e kredive të siguruara me pasuri të paluajtshme, të miratuara, por ende të palëvruara/të patërhequra;

f) 100% për shumën e flukseve dalëse të planifikuara në lidhje me rinovimin apo zgjatjen e afatit për kreditë e reja me pakicë ose me shumicë, ku flukset dalëse të planifikuara do të vlerësohen përgjatë një periudhe stresi prej 30 ditësh kalendarike;

g) 100% për shumën e pagesave të planifikuara të lidhura me derivativët, ku flukset dalëse të planifikuara do të vlerësohen përgjatë një periudhe stresi prej 30 ditësh kalendarike;

h) 5% për produktet e lidhura me zërat jashtë bilancit të financimit tregtar (*trade finance*).

2. Banka vlerëson flukset dalëse të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, nën supozimin e një skenari të kombinuar të stresit specifik me atë sistemik, siç përcaktohet në nenin 6 të kësaj rregulloreje. Për këtë vlerësim, banka merr në konsideratë edhe dëmin e konsiderueshëm (material) reputacional që mund të rezultojë nga mosmbështetja me likuiditet për këto produkte apo shërbime.

3. Banka i raporton të paktën një herë në vit Bankës së Shqipërisë, sipas Formularit 6 të aneksit 4 të kësaj rregulloreje, produktet dhe shërbimet, për të cilat mundësia e ndodhjes dhe vëllimi i mundshëm i flukseve dalëse të likuiditetit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë të konsiderueshme (materiale), si dhe normat e zbatueshme nga banka, për këto produkte dhe shërbime.

Neni 20
Flukset dalëse nga depozitat e qëndrueshme me pakicë

1. Banka, me përjashtim të rasteve kur plotësohen kriteret për një normë më të lartë të flukseve dalëse në përputhje me pikat 2, 3 ose 9, të nenit 21, të kësaj rregulloreje, e kategorizon shumën e depozitave me pakicë të siguruar nga skema e sigurimit të depozitave siç përcaktohet në legjislacionin shqiptar në fuqi për sigurimin e depozitave dhe nga skemat ekuivalente të sigurimit të depozitave në vendet e huaja, si depozitë të qëndrueshme me pakicë dhe zbaton normën e flukseve dalëse prej 5%, në rast se depozita:

a) është pjesë e një marrëdhënieje të krijuar më parë (*established relationship*) me bankën, gjë që e bën pothuajse të pamundur tërheqjen e depozitës; ose

b) mbahet në formën e një llogarie rrjedhëse (transaksionesh).

2. Për qëllime të pikës 1, shkronja "a", të këtij neni, depozita me pakicë do të konsiderohet si pjesë e një marrëdhënieje të krijuar më parë, në rastet kur depozituesi plotëson të paktën një nga kriteret e mëposhtme:

a) ka një marrëdhënie kontraktuale aktive me bankën, për një kohëzgjatje të paktën 12 mujore;

b) ka një marrëdhënie kredie me bankën, në formën e kredisë së siguruar me kolateral pasuri të paluajtshme rezidenciale ose të kredive të tjera afatgjata;

c) ka të paktën edhe një produkt tjetër aktiv me bankën, përveç marrëdhënies së kredisë.

3. Për qëllime të pikës 1, shkronja "b", të këtij neni, depozita me pakicë do të konsiderohet si e mbajtur në një llogari rrjedhëse (transaksionesh), në rastet kur përkatësisht paga, të ardhurat ose transaksionet, kreditohen dhe debitohen rregullisht në atë llogari.

Neni 21

Flukset dalëse nga depozita të tjera me pakicë

1. Banka, pa rënë ndesh me përcaktimet e pikës 2 të këtij neni, zbaton normën e flukseve dalëse prej 10% për depozitat e tjera me pakicë, duke përfshirë edhe atë pjesë të depozitave me pakicë që nuk përfshihen në përcaktimet e nenit 20 të kësaj rregulloreje.

2. Banka zbaton norma më të larta të flukseve dalëse për depozitat e tjera me pakicë, siç përcaktohen në pikën 3 të këtij neni, në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) totali i depozitave, duke përfshirë të gjitha llogaritë e depozitave të klientit në këtë bankë ose në grupin bankar ku banka bën pjesë, tejkalon 12.5 milionë lekë;

b) depozita është një llogari e përdorshme/e aksesueshme vetëm nëpërmjet internetit;

c) depozita ofron një normë interesi që plotëson një nga kushtet e mëposhtme:

i. norma e interesit e tejkalon në mënyrë të konsiderueshme, normën mesatare për produkte të ngjashme me pakicë;

ii. norma e interesit përcaktohet nga norma e kthimit të një indeksi ose grupi indeksesh të tregut;

iii. norma e interesit përcaktohet nga faktorë të tjerë të tregut, të ndryshëm nga një normë interesi e ndryshueshme;

d) depozita ishte vendosur fillimisht si një depozitë me afat të përcaktuar, ku data e maturimit përfshihet brenda periudhës 30 ditë kalendarike ose depozita ka një periudhë njoftimi të përcaktuar për tërheqjen e fondeve nga depozituesi, më të shkurtër se 30 ditë kalendarike, në përputhje me marrëveshjet kontraktuale, me përjashtim të depozitave që kualifikohen për trajtimin e parashikuar në pikën 8 të këtij neni;

e) depozituesi është jorezident në Shqipëri ose depozita është denominuar në monedhë të huaj. Për filialet ose degët e bankës në vendet e huaja, depozituesi është jorezident në vendin e huaj ose depozita është denominuar në monedhë të ndryshme nga monedha e vendit të huaj.

3. Banka zbaton një normë më të lartë të flukseve dalëse të përcaktuara si më poshtë:

a) në rastet kur depozitat me pakicë përmbushin kushtin e përcaktuar në shkronjën "a" ose dy nga kushtet e përcaktuara në shkronjat "b" deri në "e" të pikës 2 të këtij neni, banka zbaton një normë të flukseve dalëse prej 15%;

b) në rastet kur depozitat me pakicë përmbushin kushtin e përcaktuar në shkronjën "a" dhe të paktën një kusht tjetër të përcaktuar në shkronjat "b" deri në "e" të pikës 2 të këtij neni, ose tri apo më shumë kushte të përcaktuara në shkronjat "b" deri në "e" të pikës 2 të këtij neni, banka zbaton një normë të flukseve dalëse prej 20%.

4. Banka e Shqipërisë mund të kërkojë zbatimin e një norme më të lartë të flukseve dalëse, sipas rrethanave specifike të bankës.

5. Banka mund të përjashtojë nga llogaritja e flukseve dalëse të pritshme, flukset dalëse që lidhen me depozitat me pakicë me afat, me maturitet të mbetur ose periudhë njoftimi për tërheqjen e fondeve, më të madhe se 30 ditë, nëse depozituesi nuk ka të drejtë ligjore/kontraktuale të tërheqë depozitat brenda 30 ditëve ose nëse tërheqja e parakohshme do të rezultonte në një penalitet të konsiderueshëm, i cili është materialisht më i lartë se humbja e interesit të përllogaritur deri në datën e tërheqjes.

6. Nëse banka e lejon depozituesin të tërheqë depozitat e parashikuara në pikën 5 të këtij neni, pa zbatuar penalitetet përkatëse, ose pavarësisht klauzolës që përcakton se depozituesi nuk ka të drejtë ligjore/kontraktuale të tërheqë depozitën, e gjithë kategoria e këtyre fondeve/depozitave do të konsiderohet si depozitë pa afat (pavarësisht maturitetit të mbetur, depozita do të jetë subjekt i normave të flukseve dalëse siç përcaktohet në nenet 20 dhe 21 të kësaj rregulloreje).

7. Nëse një pjesë e depozitës me afat, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, mund të tërhiqet pa shkaktuar penalitete, vetëm ajo pjesë

do të trajtohet si një depozitë pa afat dhe pjesa tjetër e mbetur do të trajtohet si një depozitë me afat, siç përcaktohet në pikën 5 të këtij neni.

8. Banka zbaton një normë të flukseve dalëse prej 100% për depozitat për të cilat ajo (banka) është njoftuar që do të tërhiqen brenda 30 ditëve kalendarike (pavarësisht datës së maturimit).

9. Banka, pa rënë ndesh me pikat 1 deri në 8 të këtij neni dhe me nenin 20 të kësaj rregulloreje, shumëzon depozitat me pakicë që ka marrë në vendet e huaja, me një normë më të lartë të flukseve dalëse, në qoftë se një përqindje e tillë parashikohet nga kuadri ligjor/rregullativ përkatës, që përcakton kërkesat për likuiditet në ato vende.

Neni 22

Flukset dalëse nga depozitat operacionale

1. Banka shumëzon me 25%, detyrimet që rrjedhin nga depozitat e mëposhtme, që mbahen pranë saj (bankës), për qëllime të veprimtarive operacionale të depozituesve:

a) depozita që mbahen nga depozituesi, në mënyrë që të mundësojë shërbimin e shlyerjes (*clearing*), marrjes në kujdestari, administrimit të parave *cash*, ose shërbime të tjera të krahasueshme, në kontekstin e një marrëdhënieje operacionale të krijuar më parë me bankën;

b) depozita që mbahen nga depozituesi, në kontekstin e një marrëdhënieje operacionale të krijuar më parë me bankën, të ndryshme nga ajo e përmendur në shkronjën "a" të kësaj pike.

2. Banka, pa rënë ndesh me pikën 1 të këtij neni, shumëzon me 5% pjesën e detyrimeve që rrjedhin nga depozitat e përmendura në pikën 1, shkronja "a", të siguruara nga skemat e sigurimit të depozitave, siç përcaktohen në nenin 20 të kësaj rregulloreje.

3. Shlyerja (*clearing*), marrja në kujdestari, administrimi i parave *cash,* ose shërbime të tjera të krahasueshme, të referuara në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, i përfshijnë këto shërbime deri në masën që ato janë ofruar, në kontekstin e një marrëdhënieje të krijuar më parë, me rëndësi për depozituesin. Depozitat e përmendura në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni, duhet të parashikojnë kufizime të rëndësishme ligjore/kontraktuale ose operacionale, të cilat do ta bënin të pamundur një tërheqje të konsiderueshme brenda 30 ditëve. Fondet, që tejkalojnë masën e kërkuar për shërbimet operacionale, do të trajtohen si depozita jooperacionale.

4. Banka, për depozitat që krijohen si rezultat i një marrëdhënieje me një bankë korrespondente ose nga ofrimi i shërbimeve të ndërmjetësimit (*prime brokerage*) për klientë të veçantë, nuk i trajton si depozita operacionale dhe zbaton një normë të flukseve dalëse prej 100%.

5. Depozitat e parashikuara në shkronjën "b" të pikës 1 të këtij neni, me qëllim që të kualifikohen për trajtimin e parashikuar në pikën 1, duhet të plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) depozita është vendosur nga një klient jofinanciar;

b) depozita nuk është depozitë me afat ose llogari kursimi;

c) norma e interesit është të paktën 5 pikë bazë, nën normën aktuale për depozitat me shumicë të bankës, me karakteristika të krahasueshme, e cila në asnjë rast nuk duhet të jetë negative;

d) depozita mbahet në llogari të dedikuara (të veçanta) dhe vlerësohet/çmohet pa krijuar stimuj ekonomikë për depozituesin, për të ruajtur një tepricë të fondeve të depozitës, më të madhe nga sa është e nevojshme për marrëdhënien operacionale;

e) depozita kreditohet dhe debitohet në baza të rregullta për transaksione të rëndësishme (materiale) të klientit; si dhe

f) një nga kushtet e mëposhtme:

i. marrëdhënia me depozituesin ka ekzistuar për të paktën 24 muaj,

ii. depozita është përdorur për të paktën dy shërbime aktive. Këto shërbime mund të përfshijnë aksesin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë në shërbimet e pagesave kombëtare ose ndërkombëtare, tregtimin e titujve ose shërbimet depozitare.

Banka trajton si depozitë operacionale, vetëm atë pjesë të depozitës, e cila është e nevojshme për të përdorur shërbimin për të cilin është krijuar kjo depozitë. Pjesa e mbetur e depozitës do të trajtohet si depozitë jooperacionale.

Neni 23
Flukset dalëse që rrjedhin nga detyrime të tjera

1. Banka shumëzon me 40%, detyrimet që rrjedhin nga depozitat e klientëve jofinanciarë, të qeverisë qendrore, bankave qendrore, bankave shumëpalëshe të zhvillimit ose të njësive të sektorit publik, në masën që nuk përfshihen në depozitat e përcaktuara në nenin 22 të kësaj rregulloreje.

2. Banka, pa rënë ndesh me përcaktimin e pikës 1 të këtij neni, shumëzon me 20% detyrimet e parashikuara në pikën 1, në rast se këto detyrime janë të siguruara nga skemat e sigurimit të depozitave, siç përcaktohen në nenin 20 të kësaj rregulloreje.

3. Banka shumëzon me 100%, detyrimet që rezultojnë nga shpenzimet e veprimtarisë, të cilat do të paguhen brenda 30 ditësh kalendarike dhe me normën që e gjykon të përshtatshme, shpenzimet e veprimtarisë për të cilat parashikon që mund të mos paguhen brenda 30 ditësh kalendarike.

4. Banka shumëzon detyrimet që rrjedhin nga transaksionet e huadhënies së kolateralizuar apo nga transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike, siç përcaktohen në rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit, përkatësisht me:

a) 0%, nëse janë të garantuara me aktive të nivelit 1, sipas përcaktimeve në nenin 11 të kësaj rregulloreje, ose nëse huadhënësi është bankë qendrore;

b) 15%, nëse janë të garantuara me aktive të nivelit 2A, sipas përcaktimeve në nenin 12 të kësaj rregulloreje;

c) 25%, nëse janë të garantuara me aktive që nuk klasifikohen si aktive likuide, sipas përcaktimit të neneve 11 dhe 12 të kësaj rregulloreje dhe huadhënësi është qeveria qendrore, një bankë shumëpalëshe zhvillimi ose një njësi e sektorit publik, së cilës i është caktuar një peshë rreziku prej 20% apo më e ulët, në përputhje me nenin 14 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit;

d) 50%, nëse janë të garantuara me aktive të nivelit 2B, sipas përcaktimeve në nenin 13 të kësaj rregulloreje;

e) 100%, nëse janë të garantuara me aktive që nuk klasifikohen si aktive likuide sipas kreut III të kësaj rregulloreje, me përjashtim të transaksioneve të përcaktuara në shkronjën "c" të kësaj pike ose nëse huadhënësi është bankë qendrore.

5. *Collateral swaps* që maturohen brenda 30 ditëve të ardhshme do të shkaktojnë një fluks dalës, në masën e diferencës midis vlerës së likuiditetit të aktiveve të marra hua dhe vlerës së likuiditetit të aktiveve të dhëna hua, me përjashtim të rasteve kur kundërpartia është bankë qendrore, ku zbatohet një fluks dalës prej 0%.

6. Banka zbaton një normë të flukseve dalëse prej 100%, për të gjitha obligacionet dhe titujt e tjerë të borxhit të emetuara nga banka, me përjashtim të rasteve kur obligacioni është shitur ekskluzivisht në tregun me pakicë dhe mbahet në një llogari me pakicë. Në raste të tilla, këto instrumente duhet të trajtohen sipas kategorisë përkatëse të depozitave me pakicë, me kushtin që këto instrumente blihen dhe mbahen vetëm nga klientë me pakicë.

Neni 24
Flukset dalëse shtesë

1. Banka përllogarit flukse dalëse shtesë prej 20% të vlerës, për garancitë e vendosura nga banka për kontratat e parashikuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe derivativët e kredisë, me përjashtim të garancive në formën e parave (*cash*) dhe aktiveve të përcaktuara në nenin 11 të kësaj rregulloreje.

2. Banka përllogarit dhe njofton Bankën e Shqipërisë, jo më vonë se data e raportimit, siç përcaktohet në këtë rregullore, mbi flukset dalëse shtesë dhe kërkesat për garanci shtesë, për të gjitha kontratat, kushtet kontraktuale të të cilave do të sjellin nevojën/kërkesën për këto flukse shtesë, brenda 30 ditëve kalendarike dhe që rezultojnë nga një përkeqësim material/i rëndësishëm i cilësisë së kredisë së bankës.

3. Banka e Shqipërisë, në rast se i konsideron të rëndësishme flukset dalëse të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, i njeh/i pranon bankës shtimin e flukseve dalëse shtesë për ato kontrata, të cilat korrespondojnë me kërkesën/nevojën për garanci shtesë ose të flukseve dalëse të mjeteve

monetare (*cash*), që rezultojnë nga një përkeqësim material i cilësisë së kredisë së bankës, që korrespondon me një përkeqësim (*downgrade*) të vlerësimit të jashtëm të cilësisë së kredisë prej tri shkallë (*notches*), si dhe i kërkon bankës zbatimin e një norme prej 100% për garancitë shtesë ose flukset dalëse të mjeteve monetare (*cash*).

Banka rishikon rregullisht rëndësinë e këtij përkeqësimi dhe njofton Bankën e Shqipërisë për rezultatin e këtij rishikimi.

4. Banka përllogarit flukse dalëse shtesë, që korrespondojnë me kërkesat/nevojat për garanci shtesë, që do të rezultojnë nga ndikimi i një skenari negativ të tregut mbi transaksionet derivative të bankës, transaksionet e financimit dhe kontratat e tjera të rëndësishme.

5. Banka përllogarit mbi baza neto, flukset hyrëse dhe flukset dalëse të pritshme përgjatë 30 ditëve kalendarike, që rrjedhin nga kontratat e parashikuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, në përputhje me nenin 17 të kësaj rregulloreje. Në rast se nga përllogaritjet rezulton një fluks dalës neto, banka shumëzon rezultatin me një normë të flukseve dalëse prej 100%. Banka përjashton nga llogaritjet, kërkesat e likuiditetit që rezultojnë nga zbatimi i pikave 1 deri në 4 të këtij neni.

6. Banka përllogarit një fluks dalës shtesë, që i korrespondon 100% të vlerës së tregut të titujve ose të aktiveve të tjera të shitura shkurt (*sold short*) dhe që duhet të dorëzohen brenda 30 ditëve kalendarike. Ky fluks nuk zbatohet në rastet kur banka i zotëron titujt që do të dorëzohen ose i ka marrë hua me kushte, të cilat kërkojnë dorëzimin pas më shumë se 30 ditë kalendarike dhe titujt nuk bëjnë pjesë në aktivet likuide të bankës. Nëse ky pozicion i shkurtër (*short*) mbulohet nga një transaksion i garantuar i financimit nëpërmjet titujve, banka supozon se ky pozicion do të mbahet gjatë periudhës prej 30 ditësh kalendarike dhe zbaton një normë të flukseve dalëse prej 0%.

7. Banka përllogarit një fluks dalës shtesë që korrespondon me 100% të:

a) garancisë shtesë që mban banka, e cila mund të kërkohet në çdo kohë nga kundërpartia, sipas kushteve kontraktuale;

b) garancisë që kërkohet të vendoset te kundërpartia brenda 30 ditëve kalendarike;

c) garancisë që kualifikohet si aktiv likuid për qëllime të kreut III të kësaj rregulloreje, e cilat mund të zëvendësohet pa pëlqimin e bankës me një aktiv që nuk kualifikohet si aktiv likuid për qëllime të kreut III.

8. Depozitat e pranuara si garanci nuk do të konsiderohen si detyrime, për qëllime të nenit 22 të kësaj rregulloreje, por do të jenë subjekt i kërkesave të pikave 1 deri në 7 të këtij neni, në rastet kur është e zbatueshme.

9. Banka, për aktivet e marra hua pa garanci dhe që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike, supozon se tërhiqen plotësisht dhe zbaton një normë të flukseve dalëse prej 100%, me përjashtim të rasteve kur banka i zotëron titujt dhe ato nuk janë pjesë e rezervës së likuiditetit të bankës.

Neni 25

Flukset dalëse që rrjedhin nga lehtësirat e likuiditetit dhe të kredisë

1. Për qëllime të këtij neni, lehtësi likuiditeti do të konsiderohet çdo lehtësi, e parevokueshme ose e anulueshme me kushte dhe e papërdorur (*undrawn back up facility*), që do të përdoret për të rifinancuar detyrimet e një klienti, në situatat kur klienti nuk është në gjendje ta rifinancojë (*rollover*) detyrimin në tregjet financiare. Shuma e lehtësisë së likuiditetit do të përllogaritet si teprica aktuale e detyrimit të klientit, që maturohet brenda 30 ditëve kalendarike dhe që mbështetet nga kjo lehtësi likuiditeti. Pjesa e lehtësisë së likuiditetit që mbështet një detyrim që nuk maturohet brenda 30 ditëve kalendarike, do të përjashtohet nga objekti i përkufizimit të lehtësisë së likuiditetit. Çdo shumë shtesë e lehtësisë, do të trajtohet si një lehtësi kredie, e parevokueshme ose e anulueshme me kushte, së bashku me normën përkatëse të tërheqjes (*drawdown*), siç përcaktohet në këtë nen. Banka, lehtësirat për kapital qarkullues për shoqëritë tregtare (korporatat), nuk i klasifikon si lehtësi likuiditeti, por si lehtësi kredie.

2. Banka përllogarit flukset dalëse nga lehtësirat e likuiditetit dhe të kredisë, duke shumëzuar shumën e lehtësisë me normat përkatëse të përcaktuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni. Flukset dalëse nga lehtësirat e likuiditetit dhe të kredisë, të parevokueshme ose të anulueshme me kushte, përcaktohen si përqindje e sasisë maksimale që mund të tërhiqet

(*draw down*) përgjatë 30 ditëve kalendarike, pasi të zbritet çdo kërkesë për likuiditet që zbatohet për zërat jashtë bilancit të financimit tregtar (*trade finance*), sipas nenit 19 të kësaj rregulloreje dhe pasi të zbritet çdo garanci e vendosur në dispozicion të bankës, e vlerësuar në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje, me kusht që garancia plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) mund të ripërdoret nga banka;

b) mbahet në formën e aktiveve likuide, por nuk njihet si pjesë e rezervës së likuiditetit; dhe

c) nuk është një aktiv i emetuar nga kundërpartia e lehtësisë ose një prej subjekteve të lidhur me të (kundërpartinë).

Në rastet kur banka zotëron informacionin e nevojshëm, shuma maksimale që mund të tërhiqet nga lehtësia, do të përcaktohet si shuma maksimale që mund të tërhiqet, bazuar në detyrimet e kundërpartisë ose bazuar në planin e tërheqjeve të paracaktuar në kontratë, që parashikohen të kryhen përgjatë 30 ditëve kalendarike.

3. Banka shumëzon me 5%, shumën maksimale që mund të tërhiqet përgjatë 30 ditëve kalendarike, nga pjesa e papërdorur e lehtësive të likuiditetit dhe të kredisë, të parevokueshme ose të anulueshme me kushte, nëse këto lehtësi kualifikohen në klasën e ekspozimeve të depozitave me pakicë.

4. Banka shumëzon me 10%, shumën maksimale që mund të tërhiqet përgjatë 30 ditëve kalendarike, nga pjesa e papërdorur e lehtësive të kredisë, të parevokueshme ose të anulueshme me kushte, nëse lehtësitë plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) nuk kualifikohen në klasën e ekspozimeve të depozitave me pakicë;

b) u janë dhënë klientëve jofinanciarë, që përfshijnë shoqëritë tregtare (korporatat), qeveritë, bankat qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe njësitë e sektorit publik;

c) nuk janë dhënë për qëllim të zëvendësimit të financimit të klientit, në situatat ku klienti nuk mund të sigurojë financim në tregjet financiare.

5. Banka shumëzon me 30%, shumën maksimale që mund të tërhiqet përgjatë 30 ditëve kalendarike, nga pjesa e papërdorur e lehtësive të likuiditetit, të parevokueshme ose të anulueshme me kushte, në rast se lehtësitë plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 4, shkronjat "a" dhe "b", të këtij neni.

6. Banka shumëzon shumën maksimale që mund të tërhiqet brenda 30 ditëve kalendarike nga lehtësira të tjera të likuiditetit dhe të kredisë, me normat e flukseve dalëse korresponduese si më poshtë:

a) 40% për lehtësitë e kredisë dhe të likuiditetit të dhëna bankave, si dhe për lehtësitë e kredisë të dhëna institucioneve të tjera financiare të rregulluara, përfshirë shoqëritë e sigurimit, shoqëritë e investimeve ose sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK);

b) 100% për lehtësitë e likuiditetit dhe lehtësitë e kredisë dhënë një klienti financiar, që nuk përfshihen në shkronjën "a" të kësaj pike, si dhe në pikat 1 deri në 5 të këtij neni.

7. Bankat shumëzojnë me 100% çdo fluks dalës likuiditeti, që rezulton nga detyrime që maturohen përgjatë 30 ditëve kalendarike, të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenet 19 deri në 25 të kësaj rregulloreje.

NËNKREU III
FLUKSET HYRËSE TË LIKUIDITETIT

Neni 26
Flukset hyrëse

1. Banka vlerëson flukset hyrëse të likuiditetit përgjatë një periudhe prej 30 ditësh kalendarike. Flukset hyrëse përfshijnë vetëm flukset hyrëse kontraktuale, që burojnë nga ekspozime të cilat janë të klasifikuara në kategorinë "standarde", sipas përcaktimeve në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja" dhe për të cilat pritshmëritë e bankës janë që nuk do të ketë ndryshim në klasifikim brenda 30 ditëve kalendarike.

2. Banka zbaton një normë prej 100% për flukset hyrëse të likuiditetit, si më poshtë:

a) shumat për t'u marrë nga bankat qendrore dhe klientët financiarë. Në veçanti, për klientët financiarë, edhe flukset hyrëse nga transaksionet e mëposhtme do të trajtohen si subjekt i normës së flukseve hyrëse prej 100%:

i. transaksionet me tituj, që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike,

ii. transaksionet afatshkurtra të financimit tregtar, me një maturitet të mbetur prej më pak se 30 ditë kalendarike;

b) shumat për t'u marrë nga pozicionet në indekset kryesore të instrumenteve të kapitalit, me kusht që të mos përllogariten dy herë, si aktive likuide dhe si flukse hyrëse të likuiditetit. Këto shuma përfshijnë të drejta që maturohen brenda 30 ditësh kalendarike, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, të tilla si dividendët në *cash* nga këto indekse kryesore dhe llogari të arkëtueshme (shuma për t'u marrë) nga instrumente të tilla të kapitalit, të shitur, por ende të pashlyer, në rast se nuk janë njohur si aktive likuide në përputhje me kreun III të kësaj rregulloreje.

3. Pa rënë ndesh me pikën 2 të këtij neni, flukset hyrëse të përcaktuara në këtë pikë janë subjekt i kërkesave të mëposhtme:

a) shumat për t'u marrë nga klientët jofinanciarë do të reduktohen për qëllime të pagesës së kryegjësë, me 50% të vlerës së tyre ose me vlerën e angazhimeve kontraktuale për shtimin e financimit ndaj këtyre klientëve, cilado qoftë më e larta. Për qëllime të kësaj shkronje, klientët jofinanciarë përfshijnë klientët me pakicë, shoqëritë tregtare (korporatat), qeveritë qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe njësitë e sektorit publik;

b) shumat për t'u marrë nga huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, siç përcaktohen në rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit, të garantuara me aktive likuide, nuk merren parasysh deri në vlerën e aktiveve likuide, pas zbritjes së *haircut*-eve të zbatueshme, në përputhje me kreun III të kësaj rregulloreje. Shuma e mbetur për t'u marrë, ose në rast se janë të garantuara me aktive që nuk kualifikohen/klasifikohen si aktive likuide në përputhje me kreun III të kësaj rregulloreje, do të merret parasysh në vlerë të plotë. Banka nuk do të përllogarisë flukse hyrëse, nëse garancia përdoret për të mbuluar një pozicion të shkurtër sipas nenit 24, pika 6 të kësaj rregulloreje;

c) collateral swaps që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike, të cilat do të shkaktojnë një fluks hyrës në masën e diferencës midis vlerës së likuiditetit të aktiveve të dhëna hua dhe vlerës së likuiditetit të aktiveve të marra hua;

d) në rastet kur garancia e marrë nga marrëveshjet e anasjella të riblerjes, huamarrja e titujve ose *collateral swaps*, e cila maturohet brenda 30 ditësh, përdoret për të mbuluar pozicionet e shkurtra që mund të tejkalojnë 30 ditë, banka supozon se marrëveshjet e anasjella të riblerjes ose kontratat e huamarrjes së titujve do të rinovohen përsëri dhe nuk do të krijojnë flukse hyrëse, duke pasqyruar nevojën e saj për të vazhduar mbulimin e pozicionit të shkurtër ose për të riblerë titujt përkatës;

e) çdo angazhim i patërhequr i lehtësirave të kredisë ose i lehtësirave të likuiditetit, si dhe çdo angazhim tjetër i marrë nga subjekte të tjera, përveç bankave qendrore, nuk do të konsiderohet si fluks hyrës;

f) shumat për t'u marrë nga titujt e emetuar nga vetë banka ose nga një palë e lidhur me të, do të llogariten mbi baza neto, ku do të zbatohet një normë e flukseve hyrëse, bazuar në normën e flukseve hyrëse që zbatohet për aktivin bazë, në përputhje me këtë nen;

g) për aktivet që nuk kanë një datë maturimi të përcaktuar në kontratë, do të zbatohet një normë e flukseve hyrëse prej 20%, me kusht që kontrata e lejon bankën të tërheqë ose të kërkojë shlyerje të shumës brenda 30 ditësh.

4. Banka nuk zbaton kërkesat e shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, për shumat që do të merren nga huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, që përcaktohen në rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit, të garantuara me aktive likuide në përputhje me kreun III të kësaj rregulloreje, siç përcaktohet në shkronjën "b" të pikës 3 të këtij neni.

5. Banka përllogarit mbi baza neto, flukset dalëse dhe flukset hyrëse të pritshme përgjatë 30 ditëve kalendarike, që rrjedhin nga kontratat e parashikuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, në përputhje me nenin 17 të kësaj rregulloreje. Në rast se nga përllogaritjet rezulton një fluks hyrës neto, banka shumëzon rezultatin me një normë të flukseve hyrëse prej 100%.

6. Banka nuk përfshin në llogaritje, flukset hyrëse që burojnë nga aktivet likuide të përcaktuara në kreun III të kësaj rregulloreje, me përjashtim të pagesave të pritshme nga aktivet që nuk janë reflektuar në vlerën e tregut të aktivit.

7. Banka nuk përfshin në llogaritje, flukset hyrëse që burojnë nga kontratat e reja, të cilat do të nënshkruhen brenda 30 ditëve të ardhshme kalendarike.

8. Banka përfshin në llogaritje flukset hyrëse të likuiditetit që do të merren nga vende të huaja, të cilat aplikojnë kufizime për transfertat ose të cilat janë të denominuara në monedha të pakonvertueshme, deri në shumën që i korrespondon flukseve dalëse në këtë vend të huaj ose në monedhën përkatëse.

Neni 27
***Cap*-i i flukseve hyrëse**

1. Banka njeh shumën e flukseve hyrëse, deri në 75% të flukseve dalëse të likuiditetit, siç përcaktohen në nënkreun II të këtij kreu.

2. Bankat përllogarisin shumën e flukseve dalëse neto, pas zbatimit të *cap*-it të flukseve hyrëse, sipas formulës së paraqitur në aneksin 2 të kësaj rregulloreje.

KREU V
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 28
Kërkesa raportuese

1. Bankat raportojnë mbi baza mujore në Bankën e Shqipërisë, Departamenti i Mbikëqyrjes, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike pas mbylljes së periudhës raportuese, raportin e mbulimit me likuiditet, mbi baza individuale, për totalin dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme, sipas formularëve të aneksit 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

2. Bankat, për qëllime monitorimi nga ana e Bankës së Shqipërisë, raportojnë mbi baza mujore sipas kërkesave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, edhe raportin e mbulimit me likuiditet për monedhën vendase (lek) dhe për secilën prej monedhave të huaja të rëndësishme, sipas formularëve të aneksit 3 të kësaj rregulloreje.

3. Bankat raportojnë mbi baza mujore në Bankën e Shqipërisë, Departamenti i Mbikëqyrjes, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike pas mbylljes së periudhës raportuese, raportin e mbulimit me likuiditet, mbi baza të konsoliduara, për totalin dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme, sipas formularëve të aneksit 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 29
Masat mbikëqyrëse

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të kërkesave të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin për bankat.

Neni 30
Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në datën 1 mars 2020, me përjashtimet e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni.

2. Bankat, në përjashtim të kërkesës së parashikuar në pikën 2 të nenit 5 të kësaj rregulloreje, për raportin minimal të mbulimit me likuiditet për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme, respektojnë kufijtë dhe afatet e mëposhtme:

a) të paktën 50% (duke filluar nga 1 marsi 2020);

b) të paktën 70% (duke filluar nga 1 janari 2021); dhe

c) të paktën 80% (duke filluar nga 1 janari 2022).

3. Bankat, për raportin e mbulimit me likuiditet, për totalin dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme, mbi baza të konsoliduara, respektojnë kërkesat e kësaj rregulloreje, duke filluar nga 1 janari 2022.

4. Bankat raportojnë në Bankën e Shqipërisë, raportin e mbulimit me likuiditet, për totalin dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme, sipas formularëve të aneksit 3 dhe sipas afateve të mëposhtme:

a) mbi baza tremujore, për periudhën qershor 2019–shtator 2019; dhe

b) mbi baza mujore, për periudhën tetor 2019–shkurt 2020.

Neni 31
Dispozitë e fundit

Anekset bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

KRYETARI
Gent Sejko

ANEKSI 1

I.1 Formula për përllogaritjen e raportit të mbulimit me likuiditet

Banka përllogarit raportin e mbulimit me likuiditet sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{Raporti i mbulimit me likuiditet (\%)} = \frac{\text{Rezerva e likuiditetit}}{\text{Flukset dalëse neto të likuiditetit përgjatë një periudhe stresi prej 30 ditësh kalendarike}}$$

I.2 Formula për përcaktimin e përbërjes së rezervës së likuiditetit

1. Banka përdor formulën e paraqitur në këtë aneks, për të përcaktuar përbërjen e rezervës së likuiditetit.

2. Llogaritja e rezervës së likuiditetit:

Rezerva e likuiditetit = aktivet e nivelit 1 + Aktivet e nivelit 2A + aktivet e nivelit 2B – rregullimet për *cap*-in 15% – rregullimet për *cap*-in 40%

ku,

Rregullimet për *cap*-in 15% = Max (aktiveve të rregulluara të nivelit 2B – 15/85*(aktivet e rregulluara të nivelit 1 + aktivet e rregulluara të nivelit 2A), aktive të rregulluara të nivelit 2B - 15/60* aktivet e rregulluara të nivelit 1, 0)

Rregullimet për *cap*-in 40% = Max (aktivet e rregulluara të nivelit 2A + aktivet e rregulluara të nivelit 2B – rregullimet për *cap*-in 15%) - 2/3*aktivet e rregulluara të nivelit 1, 0)

3. Në vijim paraqitet metodologjia e llogaritjes së *cap*-it të aktiveve të nivelit 2 (përfshirë edhe nivelin 2B), në lidhje me transaksionet afatshkurtra të financimit nëpërmjet titujve.

a) Llogaritja e *cap*-it prej 40% për aktivet e nivelit 2, duhet të marrë në konsideratë edhe ndikimin në rezervën e likuiditetit, të shumave të aktiveve të nivelit 1 dhe nivelit 2, të përfshira në transaksionet e financimit të garantuar (*secured funding transactions*), transaksionet e huadhënies së kolateralizuar (*secured lending transactions*) dhe transaksionet e *collateral swaps*, që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike. Shuma maksimale e aktiveve të rregulluara (*adjusted*) të nivelit 2, në rezervën e likuiditetit, është e barabartë me dy të tretat e shumës së rregulluar të aktiveve të nivelit 1, pasi të jenë aplikuar *haircut*-et. Llogaritja e *cap*-it prej 40% për aktivet e nivelit 2, do të marrë parasysh çdo reduktim në aktivet e pranueshme të nivelit 2B, për shkak të *cap*-it prej 15% për aktivet e nivelit 2B.

b) Llogaritja e *cap*-it prej 15% për aktivet e nivelit 2B, duhet të marrë në konsideratë edhe ndikimin në rezervën e likuiditetit, të aktiveve që janë pjesë e rezervës së likuiditetit, të përfshira në transaksionet e financimit të garantuar (*secured funding transactions*), transaksionet e huadhënies së kolateralizuar (*secured lending transactions*) dhe transaksionet e *collateral swaps*, që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike. Shuma maksimale e aktiveve të rregulluara (*adjusted*) të nivelit 2B, në rezervën e likuiditetit, është e barabartë me 15/85 e shumës së rregulluar të aktiveve të nivelit 1 dhe nivelit 2A, ose në rastet kur *cap*-i prej 40% është i detyrueshëm, deri në kufirin maksimal prej 1/4 e shumës së aktiveve të rregulluara të nivelit 1, të dyja pasi të jenë aplikuar *haircut*-et.

4. Vlera e rregulluar e aktiveve të nivelit 1, përcaktohet si shuma e aktiveve të nivelit 1, që do të rezultonte pas marrjes në konsideratë të transaksioneve afatshkurtra të financimit të garantuar, transaksioneve afatshkurtra të huadhënies së kolateralizuar dhe transaksioneve afatshkurtra të *collateral swaps*, që përfshijnë shkëmbimin e çdo aktivi që kualifikohet si aktiv

likuid, me aktive të nivelit 1 (përfshirë edhe paratë *cash*), që plotësojnë ose duhet të plotësojnë, nëse janë të lira nga çdo barrë apo detyrim, kërkesat operacionale për aktivet likuide, të përcaktuara në këtë rregullore.

5. Vlera e rregulluar e aktiveve të nivelit 2A, përcaktohet si shuma e aktiveve të nivelit 2A që do të rezultonte pas marrjes në konsideratë të transaksioneve afatshkurtra të financimit të garantuar, transaksioneve afatshkurtra të huadhënies së kolateralizuar dhe transaksioneve afatshkurtra të *collateral swaps*, që përfshijnë shkëmbimin e çdo aktivi që kualifikohet si aktiv likuid, me aktive të nivelit 2A, që plotësojnë ose duhet të plotësojnë, nëse janë të lira nga çdo barrë apo detyrim, kërkesat operacionale për aktivet likuide, të përcaktuara në këtë rregullore.

6. Vlera e rregulluar e aktiveve të nivelit 2B, përcaktohet si shuma e aktiveve të nivelit 2B që do të rezultonte pas marrjes në konsideratë të transaksioneve afatshkurtra të financimit të garantuar, transaksioneve afatshkurtra të huadhënies së kolateralizuar dhe transaksioneve afatshkurtra të *collateral swaps*, që përfshijnë shkëmbimin e çdo aktivi që kualifikohet si aktiv likuid, me aktive të nivelit 2B, që plotësojnë ose duhet të plotësojnë, nëse janë të lira nga çdo barrë apo detyrim, kërkesat operacionale për aktivet likuide, të përcaktuara në këtë rregullore.

7. Në këtë kontekst, transaksionet afatshkurtra të përmendura më sipër, janë transaksione me afat maturimi deri në 30 ditë kalendarike.

8. Banka zbaton *haircut*-et, përpara llogaritjes së *cap*-eve përkatëse.

ANEKSI 2

I.1 Formula për përllogaritjen e flukseve dalëse neto të likuiditetit

Banka përdor formulën e mëposhtme për llogaritjen e flukseve dalëse neto të likuiditetit:

Flukset dalëse neto të likuiditetit = Totali i flukseve dalëse – Min (totali i flukseve hyrëse; 0.75* Totali i flukseve dalëse)

ANEKSI 3

RAPORTI I MBULIMIT ME LIKUIDITET

FORMULARËT E LIKUIDITETIT		
Numri i formularit	**Kodi i formularit**	**Emri i formularit**
1	F 1	**Formulari 1 - AKTIVET LIKUIDE**
2	F 2	**Formulari 2 - FLUKSET DALËSE**
3	F 3	**Formulari 3 - FLUKSET HYRËSE**
4	F 4	**Formulari 4 - *COLLATERAL SWAPS***
5	F 5	**Formulari 5 - PËRLLOGARITJET**

Shënim:

1. Bankat, për formularët F1 - F5, nuk duhet të plotësojnë fushat me ngjyrë gri.

2. Bankat, respektojnë në çdo kohë, raportin e mbulimit me likuiditet të parashikuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje dhe raportojnë në Bankën e Shqipërisë të dhënat sipas Formularëve F1-F5, mbi baza individuale dhe të konsoliduara, për:

- treguesin total të likuiditetit
- treguesin e likuiditetit për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme

3. Bankat, për qëllime monitorimi raportojnë në Bankën e Shqipërisë të dhënat sipas Formularëve F1-F5, për:

- treguesin e likuiditetit për monedhën vendase (lek)
- treguesin e likuiditetit për çdo monedhë të huaj të rëndësishme

Formulari 1

F 1 - MBULIMI ME LIKUIDITET - AKTIVET LIKUIDE

Monedha		

Rreshti	Kodi	Zëri	Referenca	Shuma/Vlera e tregut	Norma standarde	Norma e zbatuar	Vlera sipas nenit 10 të rregullores
				010	020	030	040 040=010*030
010	1	**AKTIVET LIKUIDE TOTALE TË PARREGULLUARA**		**0**			**0**
020	1.1	**Aktivet totale të nivelit 1 të parregulluara**		**0**			**0**
030	1.1.1	Arka (monedha dhe kartëmonedha)	Neni 11/1/a		1.00		0
040	1.1.2	Rezerva në Bankën Qendrore, deri në masën e lejuar të përdorimit të saj	Neni 11/1/b/iii		1.00		0
050	1.1.3	Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga bankat qendrore	Neni 11/1/b/i & ii		1.00		0
060	1.1.4	Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria shqiptare (në monedhën vendase)	Neni 11/1/c/i		0.90		0
070	1.1.5	Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria shqiptare (në monedhë të huaj)	Neni 11/1/c/ii		0.85		0
080	1.1.6	Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveritë qendrore të vendeve të huaja	Neni 11/1/c/iii		1.00		0
090	1.1.7	Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveritë rajonale ose autoritetet lokale në vende të huaja	Neni 11/1/c/iv		1.00		0
100	1.1.8	Aktive të njohura të qeverive qendrore ose bankave qendrore të vendeve të huaja, që nuk u është caktuar një vlerësim i cilësisë së kredisë i shkallës 1 (në monedhën vendase të atij vendi)	Neni 11/1/d		1.00		0
110	1.1.9	Aktive të njohura të qeverive qendrore ose bankave qendrore të vendeve të huaja, që nuk u është caktuar një vlerësim i cilësisë së kredisë i shkallës 1 (në monedhë të huaj)	Neni 11/1/d		1.00		0
120	1.1.10	Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe organizatat ndërkombëtare	Neni 11/1/e		1.00		0
130	1.2	**Aktivet totale të nivelit 2 të parregulluara**		**0**			**0**
140	1.2.1	Aktivet totale të nivelit 2A të parregulluara		**0**			**0**
150	1.2.1.1	Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria qendrore ose banka qendrore (vend i huaj, peshë rreziku 20%)	Neni 12/1/a		0.85		0
160	1.2.1.2	Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveritë rajonale ose autoritetet lokale (vend i huaj, peshë rreziku 20%)	Neni 12/1/a		0.85		0
170	1.2.1.3	Obligacione të garantuara të emetuara nga bankat e vendeve të huaja (cilësia e kredisë, shkalla 1)	Neni 12/1/b		0.85		0
180	1.2.1.4	Tituj borxhi të shoqërive tregtare (cilësia e kredisë, shkalla 1)	Neni 12/1/c		0.85		0
190	1.2.2	Aktivet totale të nivelit 2B të parregulluara		**0**			**0**
200	1.2.2.1	Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria qendrore ose banka qendrore (vend i huaj, cilësia e kredisë të paktën shkalla 3)	Neni 13/1/a		0.50		0
210	1.2.2.2	Tituj borxhi të shoqërive tregtare (cilësia e kredisë të paktën shkalla 3)	Neni 13/1/b		0.50		0
ZËRA MEMORANDUMI							
220	2	**Rregullime për aktivet, në lidhje me flukset dalëse neto të likuiditetit të shkaktuara nga përfundimet e parakohshme të mbrojtjes.**	**Neni 9/8/b**				
230	3	**Rregullime për aktivet, në lidhje me flukset hyrëse neto të likuiditetit të shkaktuara nga përfundimet e parakohshme të mbrojtjes.**	**Neni 9/8/b**				
240	4	**Aktive të nivelit 1/2A/2B të përjashtuara për qëllime valutore**	**Neni 11/1/d**				
250	5	**Aktive të nivelit 1/2A/2B të përjashtuara për qëllime operacionale, përveç se për qëllime valutore**	**Neni 9**				

Formulari 2

F 2 - MBULIMI ME LIKUIDITET - FLUKSET DALËSE

Monedha		

Rreshti	Kodi	Zëri	Referenca	Shuma	Vlera e tregut të kolateralit të dhënë	Vlera e kolateralit të dhënë, sipas nenit 10 të rregullores	Norma standarde	Norma e zbatuar	Flukset dalëse
				010	020	030	040	050	060 060=010*050
010	**1**	**FLUKSET DALËSE**		**0**					**0**
020	**1.1**	**Flukse dalëse nga transaksione të pasiguruara/depozitat**		**0**					**0**
030	1.1.1	Depozita me pakicë	Neni 20, 21	0					0
040	1.1.1.1	depozita për të cilat banka është njoftuar që do të tërhiqen brenda 30 ditëve kalendarike	Neni 21/8				1.00		0
050	1.1.1.2	depozita, subjekt i normave më të larta të flukseve dalëse	Neni 21/2 dhe 3	0					0
060	1.1.1.2.1	kategoria 1	Neni 21/3/a				0.15		0
070	1.1.1.2.2	kategoria 2	Neni 21/3/b				0.20		0
080	1.1.1.3	depozita të qëndrueshme (pjesa e siguruar)	Neni 20				0.05		0
090	1.1.1.4	depozita të marra në vende të huaja ku zbatohet një normë më e lartë fluksesh dalëse	Neni 21/9						0
100	1.1.1.5	depozita të tjera me pakicë	Neni 21/1				0.10		0
110	1.1.2	Depozita operacionale	Neni 22	0					0
120	1.1.2.1	depozita që mbahen për të mundësuar shërbimin e shlyerjes (*clearing*), marrjes në kujdestari, administrimit të parave *cash*, ose shërbime të tjera të krahasueshme në kontekstin e një marrëdhënieje operacionale të krijuar më parë me bankën		0					0
130	1.1.2.1.1	të mbuluara nga skema e sigurimit të depozitave	Nenet 22/1/a dhe 22/2 dhe 22/3				0.05		0
140	1.1.2.1.2	të pambuluara nga skema e sigurimit të depozitave	Nenet 22/1/a dhe 22/3				0.25		0
150	1.1.2.2	depozita që mbahen në kontekstin e një marrëdhënieje operacionale të krijuar më parë (tjetër) nga klientë jofinanciarë	Neni 22/1/b, 22/3 dhe 22/5				0.25		0
160	1.1.3	Depozita jo-operacionale		0					0
170	1.1.3.1	depozita nga banka korrespondente dhe ofrimi i shërbimeve të ndërmjetësimit (prime brokerage)	Neni 22/4				1.00		0
180	1.1.3.2	depozita nga klientët financiarë	Neni 25/7				1.00		0
190	1.1.3.3	depozita nga klientë të tjerë		0					0
200	1.1.3.3.1	të mbuluara nga skema e sigurimit të depozitave	Neni 23/2				0.20		0
210	1.1.3.3.2	të pambuluara nga skema e sigurimit të depozitave	Neni 23/1				0.40		0
220	1.1.4	Flukse dalëse shtesë		0					0
230	1.1.4.1	për garanci të ndryshme nga aktivet e nivelit 1, të vendosura për kontratat e derivativëve	Neni 24/1				0.20		0
240	1.1.4.2	flukse dalëse të rëndësishme që rezultojnë nga përkeqësimi material i cilësisë së kredisë së bankës	Neni 24/2 dhe 3				1.00		0
250	1.1.4.3	flukse dalëse që rezultojnë nga ndikimi i një skenari negativ të tregut mbi transaksionet derivative, transaksionet e financimit dhe kontrata të tjera të rëndësishme	Neni 24/4						
260	1.1.4.4	flukse dalëse nga kontratat e derivativëve	Neni 24/5				1.00		0
270	1.1.4.5	pozicione të shkurtra	Neni 24/6	0					0
280	1.1.4.5.1	te mbuluara nga transaksione të garantuara të financimit nëpërmjet titujve					0.00		0
290	1.1.4.5.2	të tjera					1.00		0
300	1.1.4.6	garanci shtesë që mban banka, që mund të kërkohet në çdo kohë nga kundërpartia	Neni 24/7/a				1.00		0
310	1.1.4.7	garanci që kërkohet të vendoset te kundërpartia	Neni 24/7/b				1.00		0
320	1.1.4.8	garanci në formën e aktiveve likuide, të cilat mund të zëvendësohen pa pëlqimin e bankës, me aktive që nuk kualifikohen si aktive likuide	Neni 24/7/c				1.00		0
330	1.1.4.9	aktive të marra hua pa garanci	Neni 24/9				1.00		0

340	1.1.5	Lehtësi të parevokueshme ose të anulueshme me kushte		0					0
350	1.1.5.1	lehtësi të kredisë		0					0
360	1.1.5.1.1	për klientë me pakicë	Neni 25/3				0.05		0
370	1.1.5.1.2	për klientë jofinanciarë, përveç klientëve me pakicë	Neni 25/4				0.10		0
380	1.1.5.1.3	për bankat	Neni 25/6/a				0.40		0
390	1.1.5.1.4	për institucione të tjera financiare të rregulluara, përveç bankave	Neni 25/6/a				0.40		0
400	1.1.5.1.5	për klientë të tjerë financiarë	Neni 25/6/b				1.00		0
410	1.1.5.2	lehtësi të likuiditetit		0					0
420	1.1.5.2.1	për klientë me pakicë	Neni 25/3				0.05		0
430	1.1.5.2.2	për klientë jofinanciarë, përveç klientëve me pakicë	Neni 25/5				0.30		0
440	1.1.5.2.3	për bankat	Neni 25/6/a				0.40		0
450	1.1.5.2.4	për klientë të tjerë financiarë	Neni 25/6/b				1.00		0
460	1.1.6	Produkte dhe shërbime të tjera	Neni 19/1	0					0
470	1.1.6.1	garanci të dhëna	Neni 19/1/a				0.10		0
480	1.1.6.2	shuma të patërhequra të linjave të kredisë	Neni 19/1/b				0.10		0
490	1.1.6.3	karta krediti	Neni 19/1/c				0.05		0
500	1.1.6.4	kredi kufi	Neni 19/1/d				0.07		0
510	1.1.6.5	kredi hipotekare të miratuara, por ende të palëvruara/patërhequra	Neni 19/1/e				1.00		0
520	1.1.6.6	flukse dalëse të planifikuara në lidhje me rinovimin apo zgjatjen e afatit për kreditë e reja me pakicë ose me shumicë	Neni 19/1/f	0					0
530	1.1.6.6.1	për klientët jofinanciarë		0					0
540	1.1.6.6.1.1	për klientët me pakicë					1.00		0
550	1.1.6.6.1.2	për shoqëritë tregtare					1.00		0
560	1.1.6.6.1.3	për qeveritë qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe njësitë e sektorit publik					1.00		0
570	1.1.6.6.1.4	për subjekte juridike të tjera (që nuk janë përfshirë në asnjë nga rreshtat e mësipërm)					1.00		0
580	1.1.6.6.2	për klientë të tjerë					1.00		0
590	1.1.6.7	pagesa të planifikuara të lidhura me derivativët	Neni 19/1/g				1.00		0
600	1.1.6.8	produktet e lidhura me zërat jashtë bilancit të financimit tregtar	Neni 19/1/h				0.05		0
610	1.1.6.9	të tjera	Neni 19/1						0
620	1.1.7	Detyrime të tjera		0					0
630	1.1.7.1	detyrime që rezultojnë nga shpenzimet e veprimtarisë	Neni 23/3						0
640	1.1.7.2	në formën e titujve të borxhit, nëse nuk trajtohen si depozita me pakicë	Neni 23/6				1.00		0
650	1.1.7.3	të tjera (që nuk janë përfshirë në asnjë nga rreshtat e mësipërm)	Neni 25/7				1.00		0

660	**1.2**	**Flukse dalëse nga transaksionet e huadhënies së kolateralizuar dhe nga transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit**		**0**					**0**
670	1.2.1	Kundërpartia është bankë qendrore		0					0
680	1.2.1.1	të garantuara me aktive të nivelit 1	Neni 23/4/a				0.00		0
690	1.2.1.2	të garantuara me aktive të nivelit 2A	Neni 23/4/a				0.00		0
700	1.2.1.3	të garantuara me aktive të nivelit 2B	Neni 23/4/a				0.00		0
710	1.2.1.4	të garantuara me aktive jolikuide	Neni 23/4/a				0.00		0
720	1.2.2	Kundërpartia nuk është bankë qendrore		0					0
730	1.2.2.1	të garantuara me aktive të nivelit 1	Neni 23/4/a				0.00		0
740	1.2.2.2	të garantuara me aktive të nivelit 2A	Neni 23/4/b				0.15		0
750	1.2.2.3	të garantuara me aktive të nivelit 2B	Neni 23/4/d				0.50		0
760	1.2.3.4	të garantuara me aktive jolikuide		0					0
770	1.2.3.4.1	kundërpartia është qeveri qendrore, bankë shumëpalëshe zhvillimi ose njësi e sektorit publik (peshë rreziku <=20%)	Neni 23/4/c				0.25		0
780	1.2.3.4.2	kundërparti të tjera	Neni 23/4/e				1.00		0
790	**1.3**	**Flukse dalëse totale nga *collateral swaps***							**0**
ZËRA MEMORANDUMI									
800	**2**	**Obligacione me pakicë me një maturitet të mbetur prej më pak se 30 ditësh**	**Neni 23/6**						
810	**3**	**Depozita me pakicë të përjashtuara nga përllogaritja e flukseve dalëse**	**Neni 21/5**						
820	**4**	**Depozita operacionale që mbahen për të mundësuar shërbimin e shlyerjes *(clearing)*, marrjes në kujdestari, administrimit të parave *cash*, ose shërbime të tjera të krahasueshme në kontekstin e një marrëdhënieje operacionale të krijuar më parë me bankën**							
830	4.1	të vendosura nga bankat							
840	4.2	të vendosura nga klientë financiarë, përveç bankave							
850	4.3	të vendosura nga qeveritë qendrore, bankat qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe njësitë e sektorit publik							
860	4.4	të vendosura nga klientë të tjerë							
870	**5**	**Depozita jo-operacionale të mbajtura nga klientët financiarë dhe klientë të tjerë**							
880	5.1	të vendosura nga bankat							
890	5.2	të vendosura nga klientë financiarë, përveç bankave							
900	5.3	të vendosura nga qeveritë qendrore, bankat qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe njësitë e sektorit publik							
910	5.4	të vendosura nga klientë të tjerë							
920	**6**	**Angazhime financimi për klientët jofinanciarë**	**Neni 26/3/a**						
930	**7**	**Aktivet e nivelit 1, të vendosura si garanci për derivativët**							
940	**8**	**Monitorimi i transaksioneve të financimit nëpërmjet titujve**							
950	**9**	**Flukse dalëse në valutë**							
960	**10**	**Flukse dalëse në vende të huaja - me kufizime për transfertat ose që janë të denominuara në monedha të pakonvertueshme**							

Formulari 3

F 3 - MBULIMI ME LIKUIDITET - FLUKSET HYRËSE

Monedha	

Rreshti	Kodi	Zëri	Referenca	Shuma	Vlera e tregut e kolateralit të marrë	Norma standarde	Norma e zbatuar	Vlera e kolateralit të marrë, sipas nenit 10 të rregullores	Flukset hyrëse
				Subjekt i *cap*-it 75%	Subjekt i *cap*-it 75%		Subjekt i *cap*-it 75%	Subjekt i *cap*-it 75%	Subjekt i *cap*-it 75%
				010	020	030	040	050 050=020*040	060 Të pasiguruara=010*040 Të siguruara=010-050
010	1	**FLUKSET HYRËSE TOTALE**		**0**					**0**
020	1.1	**Flukse hyrëse nga transaksione të pasiguruara/depozitat**		**0**					**0**
030	1.1.1	shuma për t'u marrë nga klientët jofinanciarë (me përjashtim të bankave qendrore)		0					0
040	1.1.1.1	shumat për t'u marrë (interesa dhe komisione) nga klientët jofinanciarë (me përjashtim të bankave qendrore) që nuk i korrespondojnë pagesave të kryegjësë	Neni 26/3/a			1.00			0
050	1.1.1.2	shumat për t'u marrë nga klientët jofinanciarë (me përjashtim të bankave qendrore) që i korrespondojnë pagesave të kryegjësë	Neni 26/3/a	0					0
060	1.1.1.2.1	shumat për t'u marrë nga klientët me pakicë	Neni 26/3/a			0.50			0
070	1.1.1.2.2	shumat për t'u marrë nga shoqëritë tregtare				0.50			0
080	1.1.1.2.3	shumat për t'u marrë nga qeveritë qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe njësitë e sektorit publik				0.50			0
090	1.1.1.2.4	shumat për t'u marrë nga subjekte juridike të tjera (që nuk janë përfshirë në asnjë nga rreshtat e mësipërm)				0.50			0
100	1.1.2	shumat për t'u marrë nga bankat qendrore dhe klientët financiarë							
110	1.1.2.1	shumat për t'u marrë nga bankat qendrore dhe klientët financiarë, që nuk klasifikohen si depozita operacionale		0					0
120	1.1.2.1.1	shumat për t'u marrë nga bankat qendrore	Neni 26/2/a			1.00			0
130	1.1.2.1.2	shumat për t'u marrë nga klientët financiarë	Neni 26/2/a			1.00			0
140	1.1.3	shumat për t'u marrë nga transaksionet e financimit tregtar	Neni 26/2/a/ii			1.00			0
150	1.1.4	shumat për t'u marrë nga tituj që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike	Neni 26/2/a/i			1.00			0
160	1.1.5	aktivet që nuk kanë një datë maturimi të përcaktuar në kontratë	Neni 26/3/g			0.20			0
170	1.1.6	shumat për t'u marrë nga pozicionet në indekset kryesore të instrumentave të kapitalit, me kushtin që të mos përllogariten edhe si aktive likuide	Neni 26/2/b			1.00			0
180	1.1.7	flukse hyrëse nga lehtësirat e patërhequra të kredisë ose të likuiditetit, si dhe çdo angazhim tjetër i marrë nga bankat qendrore, me kushtin që të mos përllogariten edhe si aktive likuide	Neni 26/3/e			1.00			0
190	1.1.8	flukse hyrëse nga kontratat e derivativëve	Neni 26/5			1.00			0
200	1.1.9	flukse hyrëse të tjera (që nuk janë përfshirë në asnjë nga rreshtat e mësipërm)	Neni 26/2			1.00			0
210	1.2	**Flukset hyrëse nga transaksionet e huadhënies së kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit**		**0**					**0**
220	1.2.1	të garantuara me aktive likuide		0	0			0	0
230	1.2.1.1	të garantuara me aktive të nivelit 1	Neni 26/3/b			1.00		0	0
240	1.2.1.2	të garantuara me aktive të nivelit 2A	Neni 26/3/b			0.85		0	0
250	1.2.1.3	të garantuara me aktive të nivelit 2B	Neni 26/3/b			0.50		0	0
260	1.2.2	garancia përdoret për të mbuluar një pozicion të shkurtër	Neni 26/3/b						
270	1.2.3	të garantuara me aktive që nuk klasifikohen si aktive likuide	Neni 26/3/b			1.00			0
280	1.3	**Flukse hyrëse totale nga *collateral swaps***							**0**
290	1.4	**(Diferencat midis flukseve hyrëse totale të ponderuara dhe flukseve dalëse totale të ponderuara, që burojnë nga transaksione me vende të huaja, të cilat aplikojnë kufizime për transfertat ose që janë të denominuara në monedha të pakonvertueshme)**	**Neni 26/8**						
ZËRA MEMORANDUMI									
300	2	**Flukse hyrëse në valutë**							
310	3	**Flukse hyrëse brenda grupit**		**0**					**0**
320	3.1	Nga transaksione të garantuara							
330	3.2	Shuma për t'u marrë nga tituj që maturohen brenda 30 ditësh							
340	3.3	Flukse hyrëse nga lehtësira të patërhequra të kredisë ose likuiditetit, të dhëna nga subjektet e tjera të grupit bankar/financiar							

Formulari 4

F 4 - MBULIMI ME LIKUIDITET - *COLLATERAL SWAPS*

Monedha

										Vetëm derivativët e kolateralizuar			
			Referenca	Vlera e tregut të garancisë së dhënë hua	Vlera e likuiditetit të garancisë së dhënë hua	Vlera e tregut të garancisë së marrë hua	Vlera e likuiditetit të garancisë së marrë hua	Flukset dalëse	Flukset hyrëse subjekt i cap-it 75%	Vlera e tregut të garancisë së dhënë hua	Vlera e likuiditetit të garancisë së dhënë hua	Vlera e tregut të garancisë së marrë hua	Vlera e likuiditetit të garancisë së marrë hua
Rreshti	Kodi	Zëri		010	020	030	040	050 050=040-020	060 060=020-040	070	080	090	100
010	1	***COLLATERAL SWAPS* & DERIVATIVËT E KOLATERALIZUAR TOTALE**	Veni 23/5 dhe neni 26/3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
020	1.1	**Totali i transaksioneve, në të cilat janë dhënë hua aktive të nivelit 1 dhe janë marrë hua kolateralet e mëposhtme:**	Veni 23/5 dhe neni 26/3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
030	1.1.1	Aktive të nivelit 1											
040	1.1.2	Aktive të nivelit 2A											
050	1.1.3	Aktive të nivelit 2B											
060	1.1.4	Aktive jolikuide											
070	1.2	**Totali i transaksioneve në të cilat janë dhënë hua aktive të nivelit 2A dhe janë marrë hua kolateralet e mëposhtme:**	Veni 23/5 dhe neni 26/3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
080	1.2.1	Aktive të nivelit 1											
090	1.2.2	Aktive të nivelit 2A											
100	1.2.3	Aktive të nivelit 2B											
110	1.2.4	Aktive jolikuide											
120	1.3	**Totali i transaksioneve në të cilat janë dhënë hua aktive të nivelit 2B dhe janë marrë hua kolateralet e mëposhtme:**	Veni 23/5 dhe neni 26/3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
130	1.3.1	Aktive të nivelit 1											
140	1.3.2	Aktive të nivelit 2A											
150	1.3.3	Aktive të nivelit 2B											
160	1.3.4	Aktive jolikuide											
170	1.4	**Totali i transaksioneve në të cilat janë dhënë hua aktive jolikuide dhe janë marrë hua kolateralet e mëposhtme:**	Veni 23/5 dhe neni 26/3	0		0	0	0	0	0		0	0
180	1.4.1	Aktive të nivelit 1											
190	1.4.2	Aktive të nivelit 2A											
200	1.4.3	Aktive të nivelit 2B											
210	1.4.4	Aktive jolikuide											
ZËRA MEMORANDUMI													
220	2	***Collateral swaps* totale (përfshirë të gjitha kundërpartitë), ku kolaterali i marrë hua, është përdorur për të mbuluar pozicionet e shkurtra**											
230	3	***Collateral swaps* totale me kundërparti, subjektet e grupit**											
240	4	***Collateral swaps* totale me kundërparti, bankat qendrore**											

Formulari 5

F 5 - MBULIMI ME LIKUIDITET - PËRLLOGARITJET

Monedha	

			Shuma/ Përqindja	Shënime shpjeguese
Rreshti	Kodi	Zëri	010	
PËRLLOGARITJET				
Numëruesi, emëruesi, raporti				
010	1	Rezerva e likuiditetit	0	
020	2	Flukset dalëse neto	0	
030	3	Raporti i mbulimit me likuiditet (%)		
Përllogaritjet e numëruesit				
040	4	Aktivet e nivelit 1 (vlera sipas nenit 10): të parregulluara	0	A = Nga Formulari F1
050	5	Flukset dalëse nga kolaterali në formën e aktiveve të nivelit 1, brenda 30 ditëve	0	B= Nga Formulari F3 dhe F4
060	6	Flukset hyrëse nga kolaterali në formën e aktiveve të nivelit 1, brenda 30 ditëve	0	C= Nga Formulari F2 dhe F4
070	7	Flukset dalëse në *cash* brenda 30 ditëve, nga transaksionet e garantuara	0	D= Nga Formulari F2
080	8	Flukset hyrëse në *cash* brenda 30 ditëve, nga transaksionet e garantuara	0	E= Nga Formulari F3
090	9	Aktivet e nivelit 1 (vlera e rregulluar, para llogaritjes së *cap*-it)	0	F = A-B+C-D+E
100	10	Aktivet e nivelit 2A (vlera sipas nenit 10): të parregulluara	0	G = Nga Formulari F1
110	11	Flukset dalëse nga kolaterali në formën e aktiveve të nivelit 2A, brenda 30 ditëve	0	H= Nga Formulari F3 dhe F4
120	12	Flukset hyrëse nga kolaterali në formën e aktiveve të nivelit 2A, brenda 30 ditëve	0	I= Nga Formulari F2 dhe F4
130	13	Aktivet e nivelit 2A (vlera e rregulluar, para llogaritjes së *cap*-it)	0	J= G-H+I
140	14	Aktivet e nivelit 2B (vlera sipas nenit 10): të parregulluara	0	K = Nga Formulari F1
150	15	Flukset dalëse nga kolaterali në formën e aktiveve të nivelit 2B, brenda 30 ditëve	0	L= Nga Formulari F3 dhe F4
160	16	Flukset hyrëse nga kolaterali në formën e aktiveve të nivelit 2B, brenda 30 ditëve	0	M= Nga Formulari F2 dhe F4
170	17	Aktivet e nivelit 2B (vlera e rregulluar, para llogaritjes së *cap*-it)	0	N= L-M+N
180	18	Rregullimet për *cap*-in 15%	0	O=MAX (N-15/85*(F+J), N-15/60*F,0)
190	19	Rregullimet për *cap*-in 40%	0	P=MAX ((J+N-O)-2/3*F,0)
200	20	Rezerva e likuiditetit	0	Q=F+J+N-O-P
Përllogaritjet e emëruesit				
210	21	Flukset dalëse totale	0	FD= Nga Formulari F2
220	22	Flukse hyrëse subjekt i *cap*-it 75%	0	FH= Nga Formulari F3
230	23	Flukset dalëse neto	0	FDN=FD-MIN(FH,0.75*FD)

ANEKSI 4
FLUKSE DALËSE PËR PRODUKTE DHE SHËRBIME TË TJERA

Formulari 6

F6 FLUKSE DALËSE SHTESË PËR PRODUKTE DHE SHËRBIME TË TJERA (raportim 1 herë në vit, përkatësisht me të dhënat e datës 31 dhjetor)											
Detaje mbi flukset dalëse											
					Flukset dalëse aktuale të evidentuara nga banka (përfshirë edhe subjektet e tjera të grupit, që i nënshtrohen konsolidimit) (të shprehura si përqindje e ekspozimit përkatës jashtë bilancit, në fillim të muajit)							
	Produkti/shërbimi i përcaktuar në nenin 19 të rregullores	Norma e flukseve dalëse e zbatuar nga banka	Përgjigjuni me "Po" ose "Jo", nëse mundësia e ndodhjes dhe vëllimi i mundshëm i flukseve dalëse të likuiditetit të produktit ose shërbimit, përgjatë 30 ditëve të ardhshme kalendarike (që nga data e raportimit), vlerësohen si materiale.	Përshkruani shkurt supozimet e përdorura për të vlerësuar si "materiale" ose "jomateriale" flukset dalëse të likuiditetit.	Shuma maksimale e flukseve dalëse aktuale përgjatë një muaji, gjatë vitit të fundit	Muaji/viti dhe përshkrimi i faktorëve që kanë shkaktuar këto flukse dalëse të larta (banka e plotëson këtë kolonë, vetëm nëse shuma e raportuar në kolonën (040), tejkalon 2 devijime standarde)	Shuma maksimale e flukseve dalëse aktuale përgjatë një muaji, gjatë tre viteve të fundit	Muaji/viti dhe përshkrimi i faktorëve që kanë shkaktuar këto flukse dalëse të larta (banka e plotëson këtë kolonë, vetëm nëse shuma e raportuar në kolonën (060), tejkalon 2 devijime standarde)	Shuma maksimale e flukseve dalëse aktuale përgjatë një muaji, deri në datën e raportimit	Muaji/viti dhe përshkrimi i faktorëve që kanë shkaktuar këto flukse dalëse të larta (banka e plotëson këtë kolonë, vetëm nëse shuma e raportuar në kolonën (080), tejkalon 2 devijime standarde)	Mesatare rrëshqitëse e flukseve dalëse aktuale përgjatë një muaji (që nga data e hyrjes në fuqi të rregullores)
		010	020	030	040	050	060	070	080	090	100
1	Garanci të dhëna nga banka										
2	Linja të kredisë që mund të anulohen pa kushte										
3	Karta krediti										
4	Kredi kufi										
5	Kredi të siguruara me pasuri të paluajtshme, të miratuara, por ende të patërhequra										
6	Flukse dalëse të planifikuara për rinovimin apo zgjatjen e afatit të kredive të reja										
	- për klientët me pakicë										
	- për shoqëritë tregtare										
	- për qeveritë qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe njësitë e sektorit publik										
	- për subjekte juridike të tjera (që nuk janë përfshirë në asnjë nga rreshtat e mësipërm)										
7	Pagesa të planifikuara për derivativët										
8	Zëra jashtë bilancit të financimit tregtar										
9	Të tjera										

Shënime:
Kolonat 020 dhe 030: Vlerësimi duhet të kryhet nga banka mbi baza mujore dhe raportimi në Bankën e Shqipërisë, do të bëhet një herë në vit.
Kolonat 040 dhe 050: Përllogaritjet do të bazohen në një periudhë më të shkurtër se 12 muaj, gjatë vitit të parë që nga hyrja në fuqi e rregullores. Raportimi i parë sipas kolonës 040 do të kryhet për datën 31 dhjetor 2020.
Kolonat 060 dhe 070: Përllogaritjet do të bazohen në një periudhë më të shkurtër se 36 muaj, gjatë 3 viteve të para që nga hyrja në fuqi e rregullores. Raportimi i parë sipas kolonës 060 do të kryhet për datën 31 dhjetor 2022.
Kolonat 080 dhe 090: Përllogaritjet do të bazohen në të dhënat mujore që banka zotëron, që nga data e hyrjes në fuqi të rregullores. Raportimi i parë do të kryhet për datën 31 dhjetor 2022.
Data e raportimit të këtij formulari: Brenda dy muajve pas mbylljes së periudhës raportuese.

UDHËZUES SHPJEGUES PËR
PLOTËSIMIN E
FORMULARËVE TË ANEKSIT 3

FORMULARI F1: AKTIVET LIKUIDE

Shënime të përgjithshme

1. Formulari F1 është një formular përmbledhës, i cili përmban informacion rreth aktiveve të bankës, me qëllim raportimin e kërkesës për mbulimin me likuiditet, siç përcaktohet në këtë rregullore. Qelizat që nuk është e nevojshme të plotësohen nga banka, janë të shënuara me ngjyrë gri në formular.

2. Aktivet e raportuara në këtë formular, duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në kreun III të kësaj rregulloreje.

3. Banka raporton këtë formular sipas monedhave përkatëse, siç përcaktohet në nenin 28 të kësaj rregulloreje.

4. Në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje, banka duhet të raportojë, aty ku është e përshtatshme, shumën/vlerën e tregut të aktiveve likuide, duke marrë parasysh flukset dalëse neto të likuiditetit dhe flukset hyrëse neto të likuiditetit që rezultojnë nga përfundimi i parakohshëm i mbrojtjeve të përcaktuara në nenin 9, pika 8 dhe në përputhje me *haircut*-et përkatëse të përcaktuara në kreun III të kësaj rregulloreje.

5. Në këtë rregullore, fjala "normë" i referohet një numri midis 0 dhe 1, e cila shumëzohet me shumën/vlerën, duke përllogaritur shumën e ponderuar ose vlerën, respektivisht sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje.

6. Banka nuk duhet të raportojë në mënyrë të dyfishtë zërat brenda dhe ndërmjet seksioneve 1.1, 1.2.1 dhe 1.2.2.

7. Në këtë formular janë përfshirë edhe disa zëra memorandumi. Këta zëra duhet të plotësohen nga banka, ndonëse nuk janë shumë të nevojshëm për llogaritjen e raportit të mbulimit me likuiditet. Këta zëra sigurojnë informacionin e nevojshëm për Bankën e Shqipërisë, për të vlerësuar saktë përputhshmërinë e bankës me kërkesat për likuiditet. Në disa raste ata paraqesin një detajim më të hollësishëm të zërave të përfshirë në seksionet kryesore të formularëve, ndërsa në raste të tjera pasqyrojnë burime shtesë të likuiditetit që mund të ketë banka.

Shënime specifike për shlyerjen dhe transaksionet që do të fillojnë në të ardhmen (*forward starting transactions*)

8. Të gjitha aktivet në përputhje me nenet 8, 9 dhe 10 të kësaj rregulloreje, të cilat ndodhen në stokun e aktiveve të bankës në datën e raportimit, do të raportohen në rreshtin përkatës në formularin F1, edhe nëse ato janë shitur ose përdorur në transaksione që do të fillojnë në të ardhmen (*forward starting*). Në të njëjtën mënyrë, asnjë aktiv likuid nuk do të raportohet në formularin F1, nga transaksionet që do të fillojnë në të ardhmen (*forward starting*), që i referohen blerjeve të aktiveve likuide të dakorduara kontraktualisht, por ende të pashlyera, si dhe blerjeve të ardhshme të aktiveve likuide.

Udhëzime në lidhje me kolonat specifike

Kolona	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
010	**Shuma/vlera e tregut** Banka duhet të raportojë në kolonën 010, vlerën e tregut, ose shumën (kur është e aplikueshme), të aktiveve likuide të përcaktuara në kreun III të kësaj rregulloreje. **Shuma/vlera e tregut e raportuar në kolonën 010:** - do të marrë parasysh flukset dalëse neto dhe flukset hyrëse neto të likuiditetit, në rast të përfundimit të parakohshëm të mbrojtjes të përcaktuar në nenin 9, pika 8 të rregullores; - nuk do të marrë parasysh *haircut*-et e përcaktuara në kreun III të rregullores. Referuar nenit 9, pika 8 të rregullores, banka duhet të marrë në konsideratë flukset neto të parasë, të cilat mund të jenë flukse dalëse ose flukse hyrëse, që do të rezultonin në rast të përfundimit të mbrojtjes në datën e raportimit. Banka në këtë rast nuk merr në konsideratë, ndryshimet e ardhshme në vlerën e aktivit.
020	**Norma standarde** Kolona 020 përmban normat (peshat) që pasqyrojnë shumën që do të rezultojë pas aplikimit të *haircut*-eve përkatëse të përcaktuara në kreun III të rregullores. Normat synojnë të reflektojnë reduktimin në vlerën e aktiveve likuide, pas aplikimit të *haircut*-eve përkatëse.
030	**Norma e zbatuar** Banka duhet të raportojë në kolonën 030 normën e zbatuar prej saj, për aktivet likuide të përcaktuara në kreun III të rregullores. Normat e zbatuara mund të rezultojnë në vlera mesatare të ponderuara dhe do të raportohen në numra dhjetorë (d.m.th. 1.00 për një normë të zbatueshme prej 100%, ose 0.50 për një normë të zbatueshme prej 50%). Normat e zbatuara mund të reflektojnë, por nuk kufizohen në, karakteristikat specifike të bankës apo të vendit.
040	**Vlera sipas nenit 10 të rregullores** Banka duhet të raportojë në kolonën 040 vlerën e aktiveve likuide në përputhje me përcaktimet e nenit 10 të rregullores. Kjo vlerë është shuma/vlera e tregut, që merr në konsideratë flukset dalëse neto dhe flukset hyrëse neto të likuiditetit, në rast të përfundimit të parakohshëm të mbrojtjes, e shumëzuar me normën e zbatuar.

Udhëzime në lidhje me rreshtat specifikë

Rreshti	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
010	**1. Aktivet likuide totale të parregulluara** *Kreu III i rregullores* Banka raporton shumën/vlerën e tregut totale të aktiveve likuide, në kolonën 010. Banka raporton vlerën totale të aktiveve likuide sipas nenit 10 të rregullores, në kolonën 040.
020	**1.1 Aktivet totale të nivelit 1 të parregulluara** *Neni 11 i rregullores* Aktivet e raportuara në këtë seksion janë identifikuar qartë si aktive të nivelit 1, në përputhje me kërkesat e rregullores. Banka raporton shumën/vlerën e tregut totale të aktiveve të nivelit 1, në kolonën 010. Banka raporton vlerën totale të aktiveve likuide të nivelit 1, sipas nenit 10 të rregullores, në kolonën 040.
030	**1.1.1 Arka (monedha dhe kartëmonedha)** *Neni 11, pika 1, shkronja "a" e rregullores* Shuma totale e parave *cash*, përfshirë monedhat dhe kartëmonedhat.

040	**1.1.2 Rezerva në Bankën Qendrore, deri në masën e lejuar të përdorimit të saj** *Neni 11, pika 1, shkronja "b", nënpika "iii" e rregullores* Shuma totale e rezervës së detyrueshme, që mund të tërhiqet gjatë periudhave të stresit, deri në masën e lejuar të përdorimit të saj, nga Banka e Shqipërisë, si dhe për filialet ose degët e bankës në vendet e huaja, nga banka qendrore e atij vendi, me kusht që ekspozimeve ndaj bankës qendrore ose qeverisë qendrore përkatëse të vendit të huaj, u është caktuar cilësia e kredisë e shkallës 1 nga një ECAI e emëruar, në përputhje me nenin 12, pika 2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.
050	**1.1.3 Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga bankat qendrore** *Neni 11, pika 1, shkronja "b", nënpikat "i" dhe "ii" të rregullores* Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga Banka e Shqipërisë dhe nga bankat qendrore të vendeve të huaja, me kusht që ekspozimeve ndaj bankës qendrore ose qeverisë qendrore të këtyre vendeve, u është caktuar cilësia e kredisë e shkallës 1 nga një ECAI e emëruar, në përputhje me nenin 12, pika 2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.
060	**1.1.4 Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria shqiptare (në monedhën vendase)** *Neni 11, pika 1, shkronja "c", nënpika "i" e rregullores* Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria shqiptare, me kusht që të jenë të emetuara dhe të financuara në monedhën kombëtare (lek).
070	**1.1.5 Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria shqiptare (në monedhë të huaj)** *Neni 11, pika 1, shkronja "c", nënpika "ii" e rregullores* Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria shqiptare, të emetuara dhe të financuara në monedhë të huaj, deri në shumën e flukseve dalëse neto të likuiditetit në atë monedhë të huaj, që i korrespondon veprimtarive të bankës në Shqipëri.
080	**1.1.6 Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveritë qendrore të vendeve të huaja** *Neni 11, pika 1, shkronja "c", nënpika "iii" e rregullores* Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria qendrore e një vendi të huaj, me kusht që t'i jetë caktuar cilësia e kredisë e shkallës 1 nga një ECAI e emëruar, në përputhje me nenin 12, pika 2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.
090	**1.1.7 Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveritë rajonale ose autoritetet lokale në vende të huaja** *Neni 11, pika 1, shkronja "c", nënpika "iv" e rregullores* Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveritë rajonale ose autoritetet lokale në vende të huaja, me kusht që ato të trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore, në përputhje me nenin 13 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të cilave u është caktuar cilësia e kredisë e shkallës 1 nga një ECAI e emëruar.

100	**1.1.8 Aktive të njohura të qeverive qendrore ose bankave qendrore të vendeve të huaja, që nuk u është caktuar një vlerësim i cilësisë së kredisë i shkallës 1 (në monedhën vendase të atij vendi)** *Neni 11, pika 1, shkronja "d" e rregullores* Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria qendrore ose banka qendrore e një vendi të huaj, të cilat janë të denominuara në monedhën vendase të atij vendi, ku banka e ushtron veprimtarinë nëpërmjet një dege ose filiali, së cilës (qeverisë qendrore ose bankës qendrore) nuk i është caktuar një vlerësim i cilësisë së kredisë i shkallës 1, në përputhje me nenin 12, pika 2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, ku banka mund ta përfshijë aktivin në aktivet e nivelit 1, me qëllim mbulimin e flukseve dalëse neto të likuiditetit, në atë juridiksion.
110	**1.1.9 Aktive të njohura të qeverive qendrore ose bankave qendrore të vendeve të huaja, që nuk u është caktuar një vlerësim i cilësisë së kredisë i shkallës 1 (në monedhë të huaj)** *Neni 11, pika 1, shkronja "d" e rregullores* Aktivet që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria qendrore ose banka qendrore e një vendi të huaj, të cilat nuk janë të denominuara në monedhën vendase të atij vendi, ku banka e ushtron veprimtarinë nëpërmjet një dege ose filiali, së cilës (qeverisë qendrore ose bankës qendrore) nuk i është caktuar një vlerësim i cilësisë së kredisë i shkallës 1, në përputhje me nenin 12, pika 2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, ku banka mund ta përfshijë aktivin në aktivet e nivelit 1, deri në shumën e flukseve dalëse neto të likuiditetit në atë monedhë të huaj, që i korrespondon veprimtarive të saj në atë juridiksion.
120	**1.1.10 Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe organizatat ndërkombëtare** *Neni 11, pika 1, shkronja "e" e rregullores* Aktivet që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe organizatat ndërkombëtare, në përputhje me nenin 15, pika 3 dhe nenin 16 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.
130	**1.2 Aktive totale të nivelit 2 të parregulluara** *Neni 12 dhe neni 13 i rregullores* Aktivet e raportuara në këtë seksion janë identifikuar qartë si aktive të nivelit 2A ose të nivelit 2B, në përputhje me kërkesat e rregullores. Banka raporton shumën/vlerën e tregut totale të aktiveve të nivelit 2, në kolonën 010. Banka raporton vlerën totale të aktiveve likuide të nivelit 2, sipas nenit 10 të rregullores, në kolonën 040.
140	**1.2.1 Aktive totale të nivelit 2A të parregulluara** *Neni 12 i rregullores* Aktivet e raportuara në këtë nënseksion janë identifikuar qartë si aktive të nivelit 2A, në përputhje me kërkesat e rregullores. Banka raporton në kolonën 010, shumën e vlerës totale të tregut të aktiveve të nivelit 2A, të parregulluar sipas kërkesave të nenit 14 të rregullores. Banka raporton në kolonën 040, shumën e vlerës totale të ponderuar të aktiveve të nivelit 2A, të parregulluar sipas kërkesave të nenit 14 të rregullores.
150	**1.2.1.1 Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria qendrore ose banka qendrore (vend i huaj, peshë rreziku 20%)**

	Neni 12, pika 1, shkronja "a" e rregullores Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria qendrore ose banka qendrore e një vendi të huaj, në rastin kur këtyre ekspozimeve u është caktuar një peshë rreziku prej 20%, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit.
160	**1.2.1.2 Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveritë rajonale ose autoritetet lokale (vend i huaj, peshë rreziku 20%)** *Neni 12, pika 1, shkronja "a" e rregullores* Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveritë rajonale ose autoritetet lokale të një vendi të huaj, në rastin kur këtyre ekspozimeve u është caktuar një peshë rreziku prej 20%, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit.
170	**1.2.1.3 Obligacione të garantuara të emetuara nga bankat e vendeve të huaja (cilësia e kredisë, shkalla 1)** *Neni 12, pika 1, shkronja "b" e rregullores* Aktive që përfaqësojnë ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara, të emetuara nga bankat e vendeve të huaja, të cilat plotësojnë kërkesat e nenit 12, pika 1, shkronja "b" të rregullores dhe me kusht që u është caktuar cilësia e kredisë e shkallës 1 nga një ECAI e emëruar, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit.
180	**1.2.1.4 Tituj borxhi të shoqërive tregtare (cilësia e kredisë, shkalla 1)** *Neni 12, pika 1, shkronja "c" e rregullores* Tituj të borxhit të shoqërive tregtare, të cilët plotësojnë kërkesat e parashikuara në nenin 12, pika 1, shkronja "c" të rregullores.
190	**1.2.2 Aktive totale të nivelit 2B të parregulluara** *Neni 13 i rregullores* Aktivet e raportuara në këtë nënseksion janë identifikuar qartë si aktive të nivelit 2B, në përputhje me kërkesat e rregullores. Banka raporton në kolonën 010, shumën e vlerës totale të tregut të aktiveve të nivelit 2B, të parregulluar sipas kërkesave të nenit 14 të rregullores. Banka raporton në kolonën 040, shumën e vlerës totale të ponderuar të aktiveve të nivelit 2B, të parregulluar sipas kërkesave të nenit 14 të rregullores.
200	**1.2.2.1 Aktive që përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria qendrore ose banka qendrore (vend i huaj, cilësia e kredisë të paktën shkalla 3)** *Neni 13, pika 1, shkronja "a" e rregullores* Aktive, të cilat përfaqësojnë pretendime ndaj ose të garantuara nga qeveria qendrore ose banka qendrore e një vendi të huaj, në rastin kur këtyre ekspozimeve u është caktuar cilësia e kredisë të paktën e shkallës 3, nga një ECAI e emëruar, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit.
210	**1.2.2.2 Tituj borxhi të shoqërive tregtare (cilësia e kredisë të paktën shkalla 3)** *Neni 13, pika 1, shkronja "b" e rregullores* Tituj të borxhit të shoqërive tregtare, të cilët plotësojnë kërkesat e parashikuara në nenin 13, pika 1, shkronja "b" të rregullores.
Zëra memorandumi	
220	**2. Rregullime për aktivet, në lidhje me flukset dalëse neto të likuiditetit të shkaktuara nga përfundimet e parakohshme të mbrojtjes** *Neni 9, pika 8, shkronja "b" e rregullores*

	Banka duhet të raportojë shumën totale të rregullimeve të bëra në vlerën e aktiveve likuide, të raportuara në seksionet për aktivet e nivelit 1, 2A dhe 2B, në lidhje me flukset dalëse neto të parasë, që rezultojnë në rast të përfundimit të parakohshëm të mbrojtjes, në përputhje me nenin 9, pika 8, shkronja "b" të rregullores.
230	**3. Rregullime për aktivet, në lidhje me flukset hyrëse neto të likuiditetit të shkaktuara nga përfundimet e parakohshme të mbrojtjes** *Neni 9, pika 8, shkronja "b" e rregullores* Banka duhet të raportojë shumën totale të rregullimeve të bëra në vlerën e aktiveve likuide, të raportuara në seksionet për aktivet e nivelit 1, 2A dhe 2B, në lidhje me flukset hyrëse neto të parasë, që rezultojnë në rast të përfundimit të parakohshëm të mbrojtjes, në përputhje me nenin 9, pika 8, shkronja "b" të rregullores.
240	**4. Aktivet e Nivelit 1/2A/2B të përjashtuara për qëllime valutore** *Neni 11, pika 1, shkronja "d" e rregullores* Banka duhet të raportojë pjesën e aktiveve që plotësojnë kërkesat e nenit 11, pika 1, shkronja "d", e cila nuk është njohur nga banka, sipas dispozitave të parashikuara në këtë nen.
250	**5. Aktive të nivelit 1/2A/2B të përjashtuara për qëllime operacionale, përveçse për qëllime valutore** *Neni 9 i rregullores* Banka raporton aktivet që plotësojnë kërkesat e nenit 8 të rregullores, por që nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara në nenin 9, me kusht që ato nuk janë raportuar në rreshtin 210, për qëllime valutore.

FORMULARI F2 : FLUKSET DALËSE

Shënime të përgjithshme

1. Formulari F2 është një formular përmbledhës, i cili përmban informacion rreth flukseve dalëse të likuiditetit të matura përgjatë 30 ditëve të ardhshme kalendarike, me qëllim raportimin e kërkesës për mbulimin me likuiditet, siç përcaktohet në këtë rregullore. Qelizat që nuk është e nevojshme të plotësohen nga banka, janë të shënuara me ngjyrë gri në formular.

2. Banka raporton këtë formular sipas monedhave përkatëse, siç përcaktohet në nenin 28 të kësaj rregulloreje.

3. Në këtë formular janë përfshirë edhe disa zëra memorandumi. Këta zëra duhet të plotësohen nga banka, ndonëse nuk janë shumë të nevojshëm për llogaritjen e raportit të mbulimit me likuiditet. Këta zëra sigurojnë informacionin e nevojshëm për Bankën e Shqipërisë, për të vlerësuar saktë përputhshmërinë e bankës me kërkesat për likuiditet. Në disa raste, ata paraqesin një detajim më të hollësishëm të zërave të përfshirë në seksionet kryesore të formularëve, ndërsa në raste të tjera pasqyrojnë burime shtesë të likuiditetit që mund të ketë banka.

4. Në përputhje me nenin 18, pika 1 të rregullores, flukset dalëse të likuiditetit:

a) përfshijnë kategoritë e parashikuara në nenin 18, pika 2, të rregullores; dhe

b) llogariten duke shumëzuar gjendjen (tepricën e llogarisë) e kategorive të ndryshme të detyrimeve dhe angazhimeve jashtë bilancit, me normat me të cilat ato pritet të tërhiqen ose të përdoren, siç përcaktohet në këtë rregullore.

5. Në këtë udhëzim, koncepti "flukse dalëse" sipas kolonës 060, përdoret si term i përgjithshëm për të treguar shumën e llogaritur pas aplikimit të normave përkatëse dhe çdo udhëzimi tjetër shtesë (në rastin e huadhënies së kolateralizuar dhe financimit të garantuar).

6. Flukset dalëse të likuiditetit duhet të raportohen vetëm një herë në këtë formular, me përjashtim të rastit kur zbatohen flukse dalëse shtesë sipas nenit 24 të rregullores ose kur zëri përkatës është gjithashtu edhe një zë memorandumi. Raportimi i zërave të memorandumit nuk ndikon në përllogaritjet e flukseve dalëse të likuiditetit.

7. Kur banka raporton në një monedhë të huaj të rëndësishme, zbaton kërkesat e mëposhtme:

- raporton vetëm zërat dhe flukset e denominuara në atë monedhë;

- në rast të mospërputhjeve midis pozicioneve (*legs*) të një transaksioni, do të raportohet vetëm pozicioni në atë monedhë;

- në rastet kur lejohet netimi sipas kësaj rregulloreje, netimi mund të zbatohet vetëm për flukset në atë monedhë;

- kur një fluks ka opsionin e disa monedhave, banka duhet të bëjë vlerësimin e monedhës në të cilën fluksi ka të ngjarë të ndodhë dhe raporton zërat, vetëm në atë monedhë të rëndësishme.

8. Normat standarde në kolonën 040 të formularit F2 janë normat e parashikuara në këtë rregullore.

9. Formulari përmban informacion mbi flukset e kolateralizuara të likuiditetit, të referuara si "huadhënie e kolateralizuar dhe transaksione të bazuara në tregun e kapitalit" dhe për llogaritjen e raportit të mbulimit me likuiditet, siç përcaktohet në këtë rregullore.

10. Një formular i veçantë ekziston për *collateral swaps*, formulari F4 i aneksit 3 të rregullores. *Collateral swaps*, të cilat janë transaksione shkëmbimi "garanci (kolateral) me garanci" nuk do të raportohen në formularin F2 – flukset dalëse, pasi ky formular mbulon vetëm transaksionet e shkëmbimit "*cash* kundrejt garancisë (kolateralit)".

Shënime specifike për shlyerjen dhe transaksionet që do të fillojnë në të ardhmen (*forward starting transactions*)

11. Banka raporton flukset dalëse që rrjedhin nga marrëveshjet e riblerjes, marrëveshjet e anasjella të riblerjes dhe *collateral swaps* që fillojnë brenda një periudhe prej 30 ditësh kalendarike dhe maturohen pas periudhës prej 30 ditësh kalendarike, kur pozicioni fillestar (*leg*) prodhon një fluks dalës. Në rastin e një marrëveshjeje të anasjellë të riblerjes, shuma që do t'i jepet hua kundërpartisë do të konsiderohet si fluks dalës dhe do të raportohet në zërin 1.1.7.3 të këtij formulari, pasi të zbritet vlera e tregut të aktivit që do të merret si garanci (kolateral), pas aplikimit të *haircut*-it përkatës (nëse aktivi kualifikohet si aktiv likuid). Nëse shuma që do të jepet hua, është më e ulët se vlera e tregut e aktivit (pas aplikimit të *haircut*-it) që do të merret si garanci (kolateral), diferenca do të raportohet si një fluks hyrës në formularin F3. Nëse garancia (kolaterali) e marrë, nuk është një "aktiv likuid", flukset dalëse do të raportohen të plota. Në rastin e një marrëveshjeje të riblerjes, ku vlera e tregut të aktivit që do të jepet si garanci (kolateral), pas aplikimit të *haircut*-it përkatës (nëse aktivi kualifikohet si aktiv likuid), është më e madhe se shuma e parave që do të merren, diferenca do të raportohet si një fluks dalës në rreshtin e sipërpërmendur. Për *collateral swaps* ku efekti neto i shkëmbimit fillestar të aktiveve likuide (duke marrë parasysh *haircut*-et përkatëse) krijon një fluks dalës, ky fluks dalës do të raportohet në rreshtin e sipërpërmendur.

Marrëveshjet e riblerjes, marrëveshjet e anasjella të riblerjes dhe *collateral swaps* të ardhshme, që fillojnë dhe maturohen brenda 30 ditëve kalendarike, nuk kanë ndonjë ndikim në raportin e mbulimit me likuiditet të bankës, prandaj mund të mos merren parasysh.

Udhëzime në lidhje me kolonat specifike

Kolona	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
010	**Shuma** 1.1 Udhëzime për flukset dalëse nga transaksionet e pasiguruara/depozitat: Banka raporton në këtë kolonë, tepricën (*outstanding*) e kategorive të ndryshme të detyrimeve dhe angazhimeve jashtë bilancit, siç përcaktohet në nenet 18 deri 25 të kësaj rregulloreje. 1.2 Udhëzime për transaksionet e huadhënies së kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit: Banka raporton në këtë kolonë, tepricën (*outstanding*) e detyrimeve në përputhje me nenin 18, pika 2 të rregullores, e cila përfaqëson pjesën e transaksionit të siguruar që i korrespondon parave *cash*.
020	**Vlera e tregut e kolateralit (garancisë) të dhënë** Udhëzime për transaksionet e huadhënies së kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit: Banka raporton në këtë kolonë, vlerën e tregut të kolateralit (garancisë) të dhënë, e përllogaritur si vlera aktuale bruto e tregut (para zbatimit të *haircut*-it), pas marrjes në konsideratë të flukseve që rezultojnë nga përfundimi i mbrojtjes, në përputhje me nenin 9, pika 8 të rregullores, që duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme: - banka raporton në këtë kolonë vetëm kolateralin (garancinë) e dhënë që i referohet aktiveve të nivelit 1, 2A dhe 2B, të cilat do të kualifikoheshin në maturimin e transaksionit, si aktive likuide, në përputhje me kreun III të rregullores. Kur kolaterali (garancia) është aktiv i nivelit 1, 2A ose 2B, por nuk kualifikohet si aktiv likuid në përputhje me kreun III të kësaj rregulloreje, ai do të raportohet si aktiv jolikuid. Në mënyrë të ngjashme, kur banka njeh vetëm një pjesë të aktiveve të qeverisë qendrore ose të bankës qendrore në monedhë të huaj ose të aktiveve të qeverisë qendrore ose të bankës qendrore në monedhën vendase si pjesë të rezervës së likuiditetit, vetëm pjesa e njohur duhet të raportohet brenda aktiveve të nivelit 1, 2A dhe 2B (në përputhje me nenin 11, pika 1, shkronja "d"). Në rastin kur një aktiv është përdorur si kolateral (garanci), por në një vlerë që është më e lartë se vlera që mund të njihet brenda aktiveve likuide, shuma e tepërt do të raportohet në seksionin e aktiveve jolikuide.
030	**Vlera e kolateralit (garancisë) të dhënë, sipas nenit 10 të rregullores** Udhëzime për transaksionet e huadhënies së kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit: Banka raporton në këtë kolonë, vlerën e kolateralit (garancisë) të dhënë, në përputhje me nenin 10 të rregullores. Vlera llogaritet duke shumëzuar kolonën 020 të formularit F2 të aneksit 3, me normën/*haircut*-in e zbatuar, sipas formularit F1 të këtij aneksi, që korrespondon me llojin e aktivit përkatës. Kolona 030 e formularit F2 të aneksit 3 përdoret në llogaritjen e shumës së rregulluar të aktiveve likuide në formularin F5 të këtij aneksi.
040	**Norma standarde** *Nenet 19–25 të rregullores* Normat standarde në kolonën 040 i referohen normave të përcaktuara në këtë rregullore.
050	**Norma e zbatuar** Për transaksionet e siguruara dhe të pasiguruara: Banka raporton në këtë kolonë, normat e zbatuara prej saj. Këto norma janë ato të parashikuara në nenet 18 deri 25 të rregullores. Normat e zbatuara mund të rezultojnë në vlera mesatare të ponderuara dhe do të raportohen në numra dhjetorë (d.m.th. 1,00 për një normë të zbatueshme prej 100% ose 0,50 për një normë të zbatueshme prej 50%). Normat e zbatuara mund të reflektojnë, por nuk kufizohen në, karakteristikat specifike të bankës apo të vendit.

060	**Flukset dalëse** Për transaksionet e siguruara dhe të pasiguruara: Banka raporton në këtë kolonë, flukset dalëse. Flukset dalëse llogariten duke shumëzuar kolonën 010 të formularit F2 të aneksit 3, me kolonën 050 të formularit F2.

Udhëzime në lidhje me rreshtat specifikë

Rreshti	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
010	**1. Flukset dalëse** *Nënkreu II i kreut IV të rregullores* Banka raporton në këtë rresht, flukset dalëse të likuiditetit, në përputhje me kërkesat e nënkreut II, të kreut IV të rregullores.
020	**1.1 Flukse dalëse nga transaksione të pasiguruara/depozitat** *Nenet 16 deri 25 të rregullores* Banka raporton në këtë rresht, flukset dalëse në përputhje me nenet 16 deri 25, të rregullores, me përjashtim të flukseve dalëse të përcaktuara në pikën 4 dhe pikën 5, të nenit 23 të kësaj rregulloreje.
030	**1.1.1 Depozita me pakicë** *Nenet 20 dhe 21 të rregullores* Banka raporton në këtë rresht, depozitat me pakicë (*retail*), siç përcaktohen në nenin 4 të rregullores. Në përputhje me pikën 6 të nenit 23 të rregullores, banka duhet të raportojë gjithashtu në kategorinë përkatëse të depozitave me pakicë, shumën e obligacioneve dhe të titujve të tjerë të borxhit të emetuar nga banka dhe që janë shitur ekskluzivisht në tregun me pakicë dhe mbahen në një llogari me pakicë. Banka duhet të konsiderojë për këtë kategori detyrimesh, zbatimin e normës së flukseve dalëse të parashikuar në rregullore, për kategoritë e ndryshme të depozitave me pakicë.
040	**1.1.1.1 Depozita për të cilat banka është njoftuar që do të tërhiqen brenda 30 ditëve kalendarike** *Neni 21, pika 8 e rregullores* Banka, në përputhje me pikën 8 të nenit 21 të rregullores, raporton në këtë rresht, depozitat (pavarësisht datës së maturimit), për të cilat banka është njoftuar se do të tërhiqen brenda 30 ditësh kalendarike.
050	**1.1.1.2 Depozita, subjekt i normave më të larta të flukseve dalëse** *Nenit 21, pikat 2 dhe 3 e rregullores* Bankat raportojnë në këtë rresht tepricën e plotë të depozitave, të cilat janë subjekt i normave më të larta të flukseve dalëse të likuiditetit, në përputhje me pikat 2 dhe 3, të nenit 21, të rregullores.
060	**1.1.1.2.1 Kategoria 1** *Neni 21, pika 3 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, tepricën e plotë të çdo depozite me pakicë që përmbush kushtin e përcaktuar në shkronjën "a" ose dy nga kushtet e përcaktuara në shkronjat "b" deri në "e", të pikës 2, të nenit 21, përveç rasteve kur këto depozita janë marrë në vende të huaja, për të cilat do të zbatohet një normë më e lartë e flukseve dalëse të likuiditetit, në përputhje me pikën 9, të nenit 21 (këto të fundit, banka i raporton në rreshtin 090).
070	**1.1.1.2.2 Kategoria 2** *Neni 21, pika 3 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, tepricën e plotë të çdo depozite me pakicë që përmbush kushtin e përcaktuar në shkronjën "a" dhe të paktën një kusht tjetër të

	përcaktuar në shkronjat "b" deri në "e", të pikës 2, të nenit 21, ose tri apo më shumë kushte të përcaktuara në këtë pikë, përveç rasteve kur këto depozita janë marrë në vende të huaja, për të cilat do të zbatohet një normë më e lartë e flukseve dalëse të likuiditetit, në përputhje me pikën 9, të nenit 21 (këto të fundit, banka i raporton në rreshtin 090).
080	**1.1.1.3 Depozita të qëndrueshme (pjesa e siguruar)** *Neni 20 i rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, pjesën e depozitave me pakicë, të siguruar nga skema e sigurimit të depozitave, siç përcaktohet në legjislacionin shqiptar në fuqi për sigurimin e depozitave dhe nga skemat ekuivalente të sigurimit të depozitave në vendet e huaja dhe të cilat, ose janë pjesë e një marrëdhënieje të krijuar më parë me bankën që e bën tërheqjen e depozitave pothuajse të pamundur, ose mbahen në formën e një llogarie rrjedhëse (transaksionesh), në përputhje me pikën 2 dhe pikën 3, të nenit 20, të rregullores dhe, ku: • këto depozita nuk i plotësojnë kushtet për një normë më të lartë të flukseve dalëse, në përputhje me pikat 2, 3 dhe 9, të nenit 21, të kësaj rregulloreje, rast në të cilin këto depozita duhet të raportohen si depozita subjekt i normave më të larta të flukseve dalëse; ose • këto depozita nuk janë marrë në vendet e huaja ku zbatohen norma më të larta të flukseve dalëse, në përputhje me pikën 9, të nenit 21, rast në të cilin këto depozita duhet të raportohen brenda kësaj kategorie.
090	**1.1.1.4 Depozita të marra në vende të huaja ku zbatohet një normë më e lartë e flukseve dalëse** *Neni 21, pika 9 e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, shumën e depozitave me pakicë të marra në vendet e huaja, ku zbatohet një normë më e lartë e flukseve dalëse, në përputhje me legjislacionin përkatës të atyre vendeve, i cili përcakton kërkesat për likuiditet në ato vende.
100	**1.1.1.5 Depozita të tjera me pakicë** *Neni 21, pika 1 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën e depozitave të tjera me pakicë, të ndryshme nga depozitat me pakicë të përfshira (raportuara) në rreshtat e mësipërm.
110	**1.1.2 Depozita operacionale** *Neni 22 i rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, depozitat operacionale në përputhje me nenin 22 të kësaj rregulloreje, me përjashtim të depozitave që rrjedhin nga një marrëdhënie me një bankë korrespondente ose nga ofrimi i shërbimeve të ndërmjetësimit (*prime brokerage*), të cilat konsiderohen si depozita jooperacionale në përputhje me kërkesat e pikës 4 të nenit 22 të rregullores.
120	**1.1.2.1 Depozita që mbahen për të mundësuar shërbimin e shlyerjes (*clearing*), marrjes në kujdestari, administrimit të parave *cash* ose shërbime të tjera të krahasueshme në kontekstin e një marrëdhënieje operacionale të krijuar më parë me bankën** *Neni 22, pika 1, shkronja "a", pika 2 dhe pika 3 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, depozitat e mbajtura nga depozituesit për të mundësuar shërbimin e shlyerjes (*clearing*), marrjes në kujdestari, administrimit të parave *cash* ose shërbime të tjera të krahasueshme në kontekstin e një marrëdhënieje të krijuar më parë (në përputhje me nenin 22, pika 1, shkronja "a" të kësaj rregulloreje), e cila është shumë e rëndësishme për depozituesit (në përputhje me nenin 22, pika 3); fondet që tejkalojnë masën e kërkuar për ofrimin e shërbimeve operacionale, banka i trajton si depozita jooperacionale (në përputhje me nenin 22, pika 3 të rregullores). Banka do të raportojë vetëm depozitat që kanë kufizime të rëndësishme

	ligjore/kontraktuale ose operacionale, të cilat do ta bënin të pamundur një tërheqje të konsiderueshme brenda 30 ditëve kalendarike (në përputhje me pikën 3, të nenit 22). Banka duhet të raportojë veçmas, në përputhje me pikën 2, të nenit 22, të rregullores, shumat e depozitave operacionale të parashikuara në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 22, të cilat janë të siguruara dhe të pasiguruara nga skemat e sigurimit të depozitave, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 20, të rregullores.
130	**1.1.2.1.1 Të mbuluara nga skema e sigurimit të depozitave** *Neni 22, pika 1, shkronja "a", pika 2 dhe pika 3 e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, pjesën e tepricës së depozitave operacionale të mbajtura në kontekstin e një marrëdhënieje operacionale të krijuar më parë, që përmbush kushtet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 1 dhe në pikën 3, të nenit 22, të rregullores, e cila është e siguruar/mbuluar nga skema e sigurimit të depozitave, siç përcaktohet në legjislacionin shqiptar në fuqi për sigurimin e depozitave dhe nga skemat ekuivalente të sigurimit të depozitave në vendet e huaja.
140	**1.1.2.1.2 Të pambuluara nga skema e sigurimit të depozitave** *Neni 22, pika 1, shkronja "a", pika 2 dhe pika 3 e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, pjesën e tepricës së depozitave operacionale të mbajtura në kontekstin e një marrëdhënieje operacionale të krijuar më parë, që përmbush kushtet e përcaktuara në shkronjën "a" të pikës 1 dhe në pikën 3 të nenit 22 të rregullores, e cila nuk është e siguruar/mbuluar nga skema e sigurimit të depozitave, siç përcaktohet në legjislacionin shqiptar në fuqi për sigurimin e depozitave dhe nga skemat ekuivalente të sigurimit të depozitave në vendet e huaja.
150	**1.1.2.2 Depozita që mbahen në kontekstin e një marrëdhënieje operacionale të krijuar më parë (tjetër) nga klientë jofinanciarë** *Neni 22, pika 1, shkronja "b", pika 3 dhe pika 5 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, tepricën e depozitave të mbajtura/vendosura nga klientë jofinanciarë në kontekstin e një marrëdhënieje operacionale të krijuar më parë, të ndryshme nga ajo e përmendur në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 22, të rregullores dhe që është subjekt i kërkesave të përcaktuara në pikën 5, të nenit 22. Banka do të raportojë vetëm depozitat që kanë kufizime të rëndësishme ligjore/kontraktuale ose operacionale, të cilat do ta bënin të pamundur një tërheqje të konsiderueshme brenda 30 ditëve kalendarike (në përputhje me pikën 3, të nenit 22).
160	**1.1.3 Depozita jooperacionale** *Neni 22, pika 4 dhe neni 23, pika 1 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, depozitat e pasiguruara të referuara në pikën 1 të nenit 23 të rregullores, si dhe depozitat që krijohen si rezultat i një marrëdhënieje me një bankë korrespondente ose nga ofrimi i shërbimeve të ndërmjetësimit në përputhje me pikën 4, të nenit 22, të rregullores. Banka duhet të raportojë veçmas, sipas përcaktimeve të bëra në pikat e mëposhtme të udhëzimit, shumat e depozitave jooperacionale të siguruara dhe të pasiguruara nga skema e sigurimit të depozitave, siç përcaktohet në legjislacionin shqiptar në fuqi për sigurimin e depozitave dhe nga skemat ekuivalente të sigurimit të depozitave në vendet e huaja, me përjashtim të detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhëniet me bankat korrespondente ose nga ofrimi i shërbimeve të ndërmjetësimit në përputhje me pikën 4 të nenit 22 të rregullores.
170	**1.1.3.1 Depozita nga banka korrespondente dhe ofrimi i shërbimeve të ndërmjetësimit (*prime brokerage*)** *Neni 22, pika 4 e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, tepricën e depozitave që krijohen si rezultat i marrëdhënieve me bankat korrespondente ose nga ofrimi i shërbimeve të ndërmjetësimit, siç përcaktohet në pikën 4, të nenit 22, të kësaj rregulloreje.

180	**1.1.3.2 Depozita nga klientët financiarë** *Neni 25, pika 7 e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, tepricën e depozitave të mbajtura nga klientët financiarë, në masën që ato nuk konsiderohen si depozita operacionale në përputhje me nenin 22, të rregullores. Banka gjithashtu përfshin në këtë rresht edhe vlerën e fondeve që tejkalojnë vlerën që nevojitet për ofrimin e shërbimeve operacionale, në përputhje me pikën 3 të nenit 22, të kësaj rregulloreje.
190	**1.1.3.3 Depozita nga klientë të tjerë** *Neni 23, pikat 1 dhe 2 të rregullores* Banka raporton në këtë rresht, depozitat e mbajtura nga klientët e tjerë (përveç klientëve financiarë dhe klientëve të depozitave me pakicë), në përputhje me pikat 1 dhe 2, të nenit 23, të rregullores, me kusht që ato të mos konsiderohen si depozita operacionale në përputhje me nenin 22. Ky rresht do të përfshijë gjithashtu: - fondet që tejkalojnë vlerën që kërkohet për ofrimin e shërbimeve operacionale, në përputhje me pikën 3, të nenit 22, të rregullores, me kusht që këto fonde të mos jenë vendosur nga klientët financiarë; dhe - pjesa e tepërt e depozitave, në përputhje me pikën 5, të nenit 22, të rregullores. Këto depozita duhet të raportohen në dy rreshta të veçantë, në varësi të shumës së depozitës së siguruar/mbuluar ose të pasiguruar/pambuluar (nga skema e sigurimit të depozitave, siç përcaktohet në legjislacionin shqiptar në fuqi për sigurimin e depozitave dhe nga skemat ekuivalente të sigurimit të depozitave në vendet e huaja).
200	**1.1.3.3.1 Të mbuluara nga skema e sigurimit të depozitave** *Neni 23, pika 2 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, tepricën e depozitave të mbajtura nga klientët e tjerë dhe të siguruara/mbuluara nga skema e sigurimit të depozitave, siç përcaktohet në legjislacionin shqiptar në fuqi për sigurimin e depozitave dhe nga skemat ekuivalente të sigurimit të depozitave në vendet e huaja, siç përcaktohet në pikën 2, të nenit 23, të rregullores.
210	**1.1.3.3.2 Të pambuluara nga skema e sigurimit të depozitave** *Neni 23, pika 1 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, tepricën e depozitave të mbajtura nga klientët e tjerë dhe të pasiguruara/pambuluara nga skema e sigurimit të depozitave, siç përcaktohet në legjislacionin shqiptar në fuqi për sigurimin e depozitave dhe nga skemat ekuivalente të sigurimit të depozitave në vendet e huaja, siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 23, të rregullores.
220	**1.1.4 Flukse dalëse shtesë** *Neni 24 i rregullore s* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse shtesë siç përcaktohen në nenin 24 të rregullores. Në përputhje me pikën 8, të nenit 24, të rregullores, depozitat e pranuara si garanci nuk do të konsiderohen si detyrime për qëllime të nenit 22 të kësaj rregulloreje, por do të jenë subjekt i kërkesave të pikave 1 deri në 7 të nenit 24, kur është e zbatueshme.
230	**1.1.4.1 Për garanci të ndryshme nga aktivet e nivelit 1, të vendosura për kontratat e derivativëve** *Neni 24, pika 1 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, vlerën e tregut të garancive (kolateraleve) të vendosura për kontratat e parashikuara në Aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe derivativët e kredisë, me përjashtim të garancive në formën e aktiveve të nivelit 1.

240	**1.1.4.2 Flukse dalëse të rëndësishme që rezultojnë nga përkeqësimi material i cilësisë së kredisë së bankës** *Neni 24, pika 2 dhe pika 3 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse shtesë që ka llogaritur dhe për të cilat ka njoftuar Bankën e Shqipërisë, në përputhje me pikën 2 të nenit 24 të rregullores. Bankat, të cilat janë pjesë e grupeve të huaja bankare, raportojnë në këtë rresht, edhe flukset dalëse shtesë që rezultojnë nga përkeqësimi material i cilësisë së kredisë së bankës mëmë. Nëse një shumë (vlerë), subjekt i flukseve dalëse për shkak të përkeqësimit të cilësisë së kredisë, është raportuar në një rresht tjetër me një normë më të ulët se 100%, atëherë, në përputhje me pikat 2 dhe 3, të nenit 24, një shumë (vlerë) duhet të raportohet gjithashtu edhe në rreshtin 240, në mënyrë që shuma totale e flukseve dalëse të jetë sa 100% e vlerës së transaksionit.
250	**1.1.4.3 Flukse dalëse që rezultojnë nga ndikimi i një skenari negativ të tregut në transaksionet derivative, transaksionet e financimit dhe kontrata të tjera të rëndësishme** *Neni 24, pika 4 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën e flukseve dalëse shtesë, në përputhje me kërkesën e pikës 4 të nenit 24 të rregullores. **Rëndësia (materialiteti) e transaksioneve derivative të bankës** Për qëllime të pikës 4 të nenit 24 të rregullores, transaksionet derivative të bankës, do të konsiderohen të rëndësishme (materiale), kur shuma totale nominale (notional) e këtyre transaksioneve, tejkalon 10% të flukseve dalëse neto të likuiditetit, në çdo kohë gjatë dy viteve të mëparshme. Për qëllime të përllogaritjeve të këtij rreshti, flukset dalëse neto të likuiditetit, llogariten pa përfshirë flukset dalëse shtesë të parashikuara në pikën 4 të nenit 24 të rregullores. **Llogaritja e flukseve dalëse shtesë që korrespondon me nevojat për garanci shtesë që rezultojnë nga ndikimi i një skenari negativ të tregut mbi transaksionet derivative të bankës** Flukset dalëse shtesë që korrespondojnë me nevojat për garanci shtesë që rezultojnë nga ndikimi i një skenari negativ të tregut mbi transaksionet derivative të bankës, të cilat janë konsideruar si të rëndësishme (materiale), do të jenë të barabarta me fluksin absolut neto më të madh të garancisë (kolateralit) përgjatë 30 ditëve kalendarike, të realizuar gjatë 24 muajve përpara datës së llogaritjes së raportit të mbulimit me likuiditet, siç përcaktohet në këtë rregullore. Banka mund të trajtojë flukset hyrëse dhe dalëse të transaksioneve në baza neto, vetëm nëse ato ekzekutohen nën të njëjtën marrëveshje tip të netimit. Fluksi absolut neto i garancisë (kolateralit) do të bazohet në flukset hyrëse dhe dalëse të realizuara dhe netimi do të llogaritet në nivel portofoli të bankës.
260	**1.1.4.4 Flukse dalëse nga kontratat e derivativëve** *Neni 24, pika 5 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse të pritshme përgjatë 30 ditëve kalendarike, që rrjedhin nga kontratat e parashikuara në Aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, të përllogaritura në përputhje me nenin 17 të kësaj rregulloreje. Për raportimet sipas monedhave të huaja të rëndësishme, banka duhet të raportojë flukset dalëse që ndodhin vetëm në atë monedhë të huaj. Netimi sipas kundërpartive mund të zbatohet vetëm për flukset në atë monedhë; për shembull kundërpartia A: fluks hyrës +10 euro dhe kundërpartia A: fluks dalës -20 euro, do të raportohet si fluks dalës 10 euro. Banka nuk mund të netojë midis kundërpartive të ndryshme në të njëjtën monedhë; për shembull kundërpartia A: fluks dalës -10 euro dhe kundërpartia B: fluks hyrës +40 euro, duhet të raportohen si flukse dalëse 10 euro (në formularin F2) dhe flukse hyrëse +40 euro (në formularin F3).

270	**1.1.4.5 Pozicione të shkurtra** *Neni 24, pikat 6 dhe 9 e rregullores* Banka përllogarit një fluks dalës shtesë që i korrespondon 100% të vlerës së tregut të titujve ose të aktiveve të tjera të shitura shkurt (*sold short*) dhe që duhet të dorëzohen brenda 30 ditëve kalendarike, për të reflektuar kërkesën që banka duhet të garantojë një huamarrje, për të shlyer një shitje të shkurtër. Banka nuk llogarit flukse dalëse, në rastet kur banka i zotëron titujt që do të dorëzohen, duke qenë se ata janë paguar plotësisht, ose në rastet kur banka i ka marrë hua me kushte të cilat kërkojnë dorëzimin pas më shumë se 30 ditë kalendarike dhe titujt nuk bëjnë pjesë në aktivet likuide të bankës. Nëse ky pozicion i shkurtër mbulohet nga një transaksion i garantuar i financimit nëpërmjet titujve, banka supozon se ky pozicion do të mbahet gjatë një periudhe prej 30 ditësh kalendarike dhe zbaton një normë të flukseve dalëse prej 0%.
280	**1.1.4.5.1 Të mbuluara nga transaksione të garantuara të financimit nëpërmjet titujve** *Neni 24, pika 6 e rregullores* Banka duhet të raportojë vlerën e tregut të titujve ose të aktiveve të tjera të shitura shkurt (*sold short*), që mbulohen nga një transaksion i garantuar i financimit nëpërmjet titujve dhe që duhen dorëzuar brenda 30 ditëve kalendarike, me përjashtim të rasteve kur banka i zotëron titujt që do të dorëzohen ose i ka marrë hua me kushte që kërkojnë dorëzimin pas më shumë se 30 ditë kalendarike dhe titujt nuk bëjnë pjesë në aktivet likuide të bankës. Nëse ky pozicion i shkurtër mbulohet nga një transaksion i garantuar i financimit nëpërmjet titujve, banka supozon se ky pozicion do të mbahet gjatë një periudhe prej 30 ditësh kalendarike dhe zbaton një normë të flukseve dalëse prej 0%.
290	**1.1.4.5.2 Të tjera** *Neni 24, pika 6 e rregullores* Banka duhet të raportojë vlerën e tregut të titujve ose të aktiveve të tjera të shitura shkurt (*sold short*), me përjashtim të atyre që mbulohen nga një transaksion i garantuar i financimit nëpërmjet titujve, dhe që duhen dorëzuar brenda 30 ditëve kalendarike, duke përjashtuar rastet kur banka i zotëron titujt që do të dorëzohen ose i ka marrë hua me kushte, që kërkojnë dorëzimin pas më shumë se 30 ditë kalendarike dhe titujt nuk bëjnë pjesë në aktivet likuide të bankës.
300	**1.1.4.6 Garanci shtesë që mban banka, që mund të kërkohet në çdo kohë nga kundërpartia** *Neni 24, pika 7, shkronja "a" e rregullores* Banka duhet të raportojë vlerën e tregut të garancisë (kolateralit) shtesë që mban, e cila mund të kërkohet në çdo kohë nga kundërpartia, sipas kushteve kontraktuale.
310	**1.1.4.7 Garanci që kërkohet të vendoset te kundërpartia** *Neni 24, pika 7, shkronja "b" e rregullores* Banka duhet të raportojë vlerën e tregut të garancisë (kolateralit), që kërkohet të vendoset te kundërpartia brenda 30 ditëve kalendarike.
320	**1.1.4.8 Garanci në formën e aktiveve likuide, të cilat mund të zëvendësohen pa pëlqimin e bankës, me aktive që nuk kualifikohen si aktive likuide** *Neni 24, pika 7, shkronja "c" e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, vlerën e tregut të garancive (kolateraleve), që kualifikohen si aktive likuide, për qëllime të kreut III të rregullores, të cilat mund të zëvendësohen pa pëlqimin e bankës, me aktive që nuk kualifikohen si aktive likuide sipas kreut III.
	1.1.4.9 Aktive të marra hua pa garanci *Neni 24, pika 9 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, aktivet e marra hua pa garanci dhe që

330	maturohen brenda 30 ditëve kalendarike. Këto aktive supozohet se tërhiqen plotësisht, duke arritur në flukse dalëse prej 100%. Ky trajtim synon të pasqyrojë faktin se letrat me vlerë të huazuara kundrejt një komisioni, ka të ngjarë të thirren mbrapsht në situata stresi ose që huadhënësit do të kërkojnë garantim (kolateralizim) të plotë. Banka duhet të raportojë vlerën e tregut të aktiveve të marra hua pa garanci dhe që maturohen brenda 30 ditëve, kur banka nuk i zotëron titujt dhe ato nuk janë pjesë e rezervës së likuiditetit të bankës.
340	**1.1.5 Lehtësi të parevokueshme ose të anulueshme me kushte** *Neni 25 i rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse sipas përcaktimeve të nenit 25 të rregullores. Shuma maksimale që mund të tërhiqet do të vlerësohet në përputhje me nenin 25, pika 2 e rregullores.
350	**1.1.5.1 Lehtësi të kredisë** Banka duhet të raportojë në këtë rresht, lehtësirat e kredisë siç përcaktohen në pikën 1 të nenit 25 të rregullores.
360	**1.1.5.1.1 Për klientë me pakicë** *Neni 25, pika 3 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën maksimale që mund të tërhiqet nga pjesa e papërdorur e lehtësive të kredive për klientët me pakicë, siç përcaktohen në nenin 4, shkronja "j" e rregullores.
370	**1.1.5.1.2 Për klientë jofinanciarë, përveç klientëve me pakicë** *Neni 25, pika 4 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën maksimale që mund të tërhiqet nga pjesa e papërdorur e lehtësive të kredisë për klientët, të cilët nuk janë as klientë financiarë siç përcaktohen në nenin 4, shkronja "n" dhe as klientë me pakicë siç përcaktohen në nenin 4, shkronja "j" e rregullores, ku këto lehtësira të kredisë nuk janë dhënë për qëllim të zëvendësimit të financimit të klientit, në situatat ku klienti nuk mund të sigurojë financim në tregjet financiare.
380	**1.1.5.1.3 Për bankat** *Neni 25, pika 6, shkronja "a" e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, lehtësirat e kredisë dhënë bankave.
390	**1.1.5.1.4 Për institucione të tjera financiare të rregulluara, përveç bankave** *Neni 25, pika 6, shkronja "a" e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën maksimale që mund të tërhiqet nga pjesa e papërdorur e lehtësive të kredisë, dhënë institucioneve të tjera financiare të rregulluara, përveç bankave.
400	**1.1.5.1.5 Për klientë të tjerë financiarë** *Neni 25, pika 6, shkronja "b" e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën maksimale që mund të tërhiqet nga pjesa e papërdorur e lehtësive të kredisë, dhënë klientëve financiarë, përveç atyre të raportuar më lart.
410	**1.1.5.2 Lehtësi të likuiditetit** Banka do të raportojë në këtë rresht, lehtësitë e likuiditetit siç përcaktohen në pikën 1 të nenit 25 të rregullores.
420	**1.1.5.2.1 Për klientë me pakicë** *Neni 25, pika 3 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën maksimale që mund të tërhiqet nga pjesa e papërdorur e lehtësive të likuiditetit për klientët me pakicë, siç përcaktohen në nenin

	4, shkronja "j" e rregullores.
430	**1.1.5.2.2 Për klientë jofinanciarë, përveç klientëve me pakicë** *Neni 25, pika 5 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën maksimale që mund të tërhiqet nga pjesa e papërdorur e lehtësive të likuiditetit për klientët, të cilët nuk janë as klientë financiarë siç përcaktohen në nenin 4, shkronja "n" dhe as klientë me pakicë siç përcaktohen në nenin 4, shkronja "j" e rregullores.
440	**1.1.5.2.3 Për bankat** *Neni 25, pika 6, shkronja "a" e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, lehtësirat e likuiditetit të dhëna bankave.
450	**1.1.5.2.4 Për klientë të tjerë financiarë** *Neni 25, pika 6, shkronja "b" e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën maksimale që mund të tërhiqet nga pjesa e papërdorur e lehtësive të likuiditetit, dhënë klientëve financiarë, përveç atyre të raportuar më lart.
460	**1.1.6 Produkte dhe shërbime të tjera** *Neni 19, pika 1 e rregullores* Bankat duhet të raportojnë në këtë rresht, produktet dhe shërbimet e parashikuara në nenin 19, pika 1 të rregullores. Shuma që do të raportohet është shuma maksimale që mund të tërhiqet nga produktet dhe shërbimet e parashikuara në nenin 19, pika 1 e rregullores. Normat që do të përdoren janë ato të parashikuara në nenin 19, pika 1 e rregullores.
470	**1.1.6.1 Garanci të dhëna** *Neni 19, pika 1, shkronja "a" e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën e garancive të dhëna, siç parashikohen në nenin 19, pika 1, shkronja "a" e rregullores.
480	**1.1.6.2 Shuma të patërhequra të linjave të kredisë** *Neni 19, pika 1, shkronja "b" e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën e patërhequr të linjave të kredisë, sipas përcaktimeve në nenin 19, pika 1, shkronja "b" e rregullores.
490	**1.1.6.3 Karta krediti** *Neni 19, pika 1, shkronja "c" e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën e patërhequr të kartave të kreditit, sipas përcaktimeve në nenin 19, pika 1, shkronja "c" e rregullores.
500	**1.1.6.4 Kredi kufi** *Neni 19, pika 1, shkronja "d" e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën e patërhequr të kredive kufi, sipas përcaktimeve në nenin 19, pika 1, shkronja "d" e rregullores.
510	**1.1.6.5 Kredi hipotekare të miratuara, por ende të palëvruara/patërhequra** *Neni 19, pika 1, shkronja "e" e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën e patërhequr të kredive të siguruara me pasuri të paluajtshme, të miratuara, por ende të palëvruara/patërhequra, sipas përcaktimeve në nenin 19, pika 1, shkronja "e" e rregullores.
520	**1.1.6.6 Flukse dalëse të planifikuara në lidhje me rinovimin apo zgjatjen e afatit për kreditë e reja me pakicë ose me shumicë** *Neni 19, pika 1, shkronja "f" e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën e flukseve dalëse të planifikuara në lidhje me rinovimin apo zgjatjen e afatit për kreditë e reja me pakicë apo shumicë, sipas përcaktimeve në nenin 19, pika 1, shkronja "f" e rregullores.

530	**1.1.6.6.1 Për klientët jofinanciarë** Banka duhet të raportojë në këtë rresht, diferencën mes angazhimit kontraktual për të financuar klientët jofinanciarë dhe shumave që këta klientë i detyrohen bankës, sipas përcaktimit të bërë në nenin 26, pika 3, shkronja "a" e rregullores, në rastin kur financimi e tejkalon detyrimin.
540	**1.1.6.6.1.1 Për klientët me pakicë** Banka duhet të raportojë në këtë rresht, diferencën mes angazhimit kontraktual për të financuar klientët me pakicë dhe shumave që këta klientë i detyrohen bankës, sipas përcaktimit të bërë në nenin 26, pika 3, shkronja "a" e rregullores, në rastin kur financimi e tejkalon detyrimin.
550	**1.1.6.6.1.2 Për shoqëritë tregtare** Banka duhet të raportojë në këtë rresht, diferencën mes angazhimit kontraktual për të financuar shoqëritë tregtare dhe shumave që shoqëritë tregtare i detyrohen bankës, sipas përcaktimit të bërë në nenin 26, pika 3, shkronja "a" e rregullores, në rastin kur financimi e tejkalon detyrimin.
560	**1.1.6.6.1.3 Për qeveritë qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe njësitë e sektorit publik** Banka duhet të raportojë në këtë rresht, diferencën mes angazhimit kontraktual për të financuar qeveritë qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe njësitë e sektorit publik dhe shumave që këto të fundit i detyrohen bankës, sipas përcaktimit të bërë në nenin 26, pika 3, shkronja "a" e rregullores, në rastin kur financimi e tejkalon detyrimin.
570	**1.1.6.6.1.4 Për subjekte juridike të tjera (që nuk janë përfshirë në asnjë nga rreshtat e mësipërm)** Banka duhet të raportojë në këtë rresht, diferencën mes angazhimit kontraktual për të financuar subjekte të tjera juridike dhe shumave që këto të fundit i detyrohen bankës, sipas përcaktimit të bërë në nenin 26, pika 3, shkronja "a" e rregullores, në rastin kur financimi e tejkalon detyrimin.
580	**1.1.6.6.2 Për klientë të tjerë** Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën e flukseve dalëse të planifikuara në lidhje me rinovimin ose zgjatjen e afatit për kreditë e reja, me pakicë apo shumicë, sipas përcaktimeve në nenin 19, pika 1, shkronja "f" e rregullores, të cilat nuk janë raportuar në rreshtat e mësipërm.
590	**1.1.6.7 Pagesa të planifikuara të lidhura me derivativët** *Neni 19, pika 1, shkronja "g" e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, pagesat e planifikuara të lidhura me derivativët, siç përcaktohen në nenin 19, pika 1, shkronja "g" e rregullores.
600	**1.1.6.8 Produkte të lidhura me zërat jashtë bilancit të financimit tregtar** *Neni 19, pika 1, shkronja "h" e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën e produkteve apo shërbimeve që lidhen me financimin tregtar, siç përcaktohen në nenin 19, pika 1, shkronja "h" e rregullores.
610	**1.1.6.9 Të tjera** Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumën e produkteve apo shërbimeve të tjera, të cilat nuk përfshihen në nenin 19, pika 1 e rregullores.
620	**1.1.7 Detyrime të tjera** *Neni 23, pikat 3 dhe 6 dhe neni 25, pika 7 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse nga detyrimet e tjera, siç parashikohen në nenin 23, pikat 3 dhe 6, si dhe në nenin 25, pika 7 e rregullores.
630	**1.1.7.1 Detyrime që rezultojnë nga shpenzimet e veprimtarisë** *Neni 23, pika 3 e rregullores*

	Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumat e detyrimeve që lidhen me shpenzimet e veprimtarisë së vetë bankës, sipas përcaktimeve të nenit 23, pika 3 e rregullores.
640	**1.1.7.2 Në formën e titujve të borxhit, nëse nuk trajtohen si depozita me pakicë** *Neni 23, pika 6 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, tepricën (*outstanding*) e obligacioneve dhe titujve të tjerë të borxhit që janë emetuar nga banka, përveç atyre që janë raportuar në klasën e depozitave me pakicë, sipas përcaktimeve të nenit 23, pika 6 e rregullores. Shuma e raportuar duhet të përfshijë edhe vlerën e kuponit të këtyre titujve, që do të paguhet në 30 ditët e ardhshme kalendarike.
650	**1.1.7.3 Të tjera (që nuk janë përfshirë në asnjë nga rreshtat e mësipërm)** *Neni 25, pika 7 e rregullores* Banka duhet të raportojë në këtë rresht, shumat e detyrimeve të tjera që maturohen dhe duhet të paguhen në 30 ditët e ardhshme kalendarike, në përputhje me nenin 25, pika 7 të rregullores, me përjashtim të atyre të përcaktuara në nenet 19 deri në 25 të kësaj rregulloreje, të raportuara në rreshta të tjerë të këtij formulari.
660	**1.2 Flukse dalëse nga transaksionet e huadhënies së kolateralizuar dhe nga transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit** Banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse që vijnë si rezultat i huadhënies së kolateralizuar dhe transaksioneve të bazuara në tregjet e kapitalit, sipas përcaktimeve në rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit. *Collateral swaps* (që janë transaksione shkëmbimi "garanci (kolateral) me garanci") do të raportohen në formularin F4.
670	**1.2.1 Kundërpartia është bankë qendrore** Banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse që vijnë si rezultat i huadhënies së kolateralizuar dhe transaksioneve të bazuara në tregjet e kapitalit, ku kundërpartia është një bankë qendrore.
680	**1.2.1.1 Të garantuara me aktive të nivelit 1** *Neni 23, pika 4, shkronja "a" e rregullores* Sipas përcaktimit të bërë në nenin 23, pika 4, shkronja "a", banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse që vijnë si rezultat i huadhënies së kolateralizuar dhe transaksioneve të bazuara në tregjet e kapitalit, ku kundërpartia është një bankë qendrore dhe garancia (kolaterali) është aktiv i nivelit 1, në përputhje me nenin 11 të rregullores.
690	**1.2.1.2 Të garantuara me aktive të nivelit 2A** *Neni 23, pika 4, shkronja "a" e rregullores* Sipas përcaktimit të bërë në nenin 23, pika 4, shkronja "a", banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse që vijnë si rezultat i huadhënies së kolateralizuar dhe transaksioneve të bazuara në tregjet e kapitalit, ku kundërpartia është një bankë qendrore dhe garancia (kolaterali) është aktiv i nivelit 2A, në përputhje me nenin 12 të rregullores.
700	**1.2.1.3 Të garantuara me aktive të nivelit 2B** *Neni 23, pika 4, shkronja "a" e rregullores* Sipas përcaktimit të bërë në nenin 23, pika 4, shkronja "a", banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse që vijnë si rezultat i huadhënies së kolateralizuar dhe transaksioneve të bazuara në tregjet e kapitalit, ku kundërpartia është një bankë qendrore dhe garancia (kolaterali) është aktiv i nivelit 2B, në përputhje me nenin 13 të rregullores.
710	**1.2.1.4 Të garantuara me aktive jolikuide** *Neni 23, pika 4, shkronja "a" e rregullores* Sipas përcaktimit të bërë në nenin 23, pika 4, shkronja "a", banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse që vijnë si rezultat i huadhënies së kolateralizuar dhe transaksioneve të bazuara në tregjet e kapitalit, ku kundërpartia është një bankë qendrore dhe garancia (kolaterali) është aktiv jolikuid.

720	**1.2.2 Kundërpartia nuk është bankë qendrore** Banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse që vijnë si rezultat i huadhënies së kolateralizuar dhe transaksioneve të bazuara në tregjet e kapitalit, ku kundërpartia nuk është një bankë qendrore.
730	**1.2.2.1 Të garantuara me aktive të nivelit 1** *Neni 23, pika 4, shkronja "a" e rregullores* Sipas përcaktimit të bërë në nenin 23, pika 4, shkronja "a", banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse që vijnë si rezultat i huadhënies së kolateralizuar dhe transaksioneve të bazuara në tregjet e kapitalit, ku kundërpartia nuk është një bankë qendrore dhe garancia (kolaterali) është aktiv i nivelit 1, në përputhje me nenin 11 të rregullores.
740	**1.2.2.2 Të garantuara me aktive të nivelit 2A** *Neni 23, pika 4, shkronja "b" e rregullores* Sipas përcaktimit të bërë në nenin 23, pika 4, shkronja "b", banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse që vijnë si rezultat i huadhënies së kolateralizuar dhe transaksioneve të bazuara në tregjet e kapitalit, ku kundërpartia nuk është një bankë qendrore dhe garancia (kolaterali) është aktiv i nivelit 2A, në përputhje me nenin 12 të rregullores.
750	**1.2.2.3 Të garantuara me aktive të nivelit 2B** *Neni 23, pika 4, shkronja "d" e rregullores* Sipas përcaktimit të bërë në nenin 23, pika 4, shkronja "d", banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse që vijnë si rezultat i huadhënies së kolateralizuar dhe transaksioneve të bazuara në tregjet e kapitalit, ku kundërpartia nuk është një bankë qendrore dhe garancia (kolaterali) është aktiv i nivelit 2B, në përputhje me nenin 13 të rregullores.
760	**1.2.2.4 Të garantuara me aktive jolikuide** Banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse që vijnë si rezultat i huadhënies së kolateralizuar dhe transaksioneve të bazuara në tregjet e kapitalit, ku kundërpartia nuk është një bankë qendrore dhe garancia (kolaterali) është aktiv jolikuid.
770	**1.2.2.4.1 Kundërpartia është qeveri qendrore, bankë shumëpalëshe zhvillimi ose njësi e sektorit publik (peshë rreziku <=20%)** *Neni 23, pika 4, shkronja "c" e rregullores* Sipas përcaktimit të bërë në nenin 23, pika 4, shkronja "c", banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse që vijnë si rezultat i huadhënies së kolateralizuar dhe transaksioneve të bazuara në tregjet e kapitalit, ku garancia (kolaterali) është aktiv jolikuid dhe kundërpartia është qeveria qendrore, një bankë shumëpalëshe zhvillimi ose një njësi e sektorit publik, së cilës i është caktuar një peshë rreziku prej 20% ose më e ulët, në përputhje me nenin 14 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.
780	**1.2.2.4.2 Kundërparti të tjera** *Neni 23, pika 4, shkronja "e" e rregullores* Sipas përcaktimit të bërë në nenin 23, pika 4, shkronja "e", banka duhet të raportojë në këtë rresht, flukset dalëse që vijnë si rezultat i huadhënies së kolateralizuar dhe transaksioneve të bazuara në tregjet e kapitalit, ku garancia (kolaterali) është aktiv jolikuid dhe kundërpartia nuk është bankë qendrore, qeveri qendrore, një bankë shumëpalëshe zhvillimi ose një njësi e sektorit publik, së cilës i është caktuar një peshë rreziku prej 20% ose më e ulët.
790	**1.3 Flukse dalëse totale nga *collateral swaps*** Shuma e flukseve dalëse totale të kolonës 050 të formularit F4, duhet të raportohet në kolonën 060 të këtij formulari (F2).

Zëra memorandumi	
	2. Obligacione me pakicë me një maturitet të mbetur prej më pak se 30 ditësh *Neni 23, pika 6 e rregullores*
800	Banka raporton në këtë rresht, shumën e obligacioneve dhe të titujve të tjerë të borxhit të emetuar nga banka, të cilat janë shitur ekskluzivisht në tregun me pakicë dhe mbahen në një llogari me pakicë. Këto obligacione me pakicë duhet të jenë raportuar edhe brenda kategorisë përkatëse të depozitave me pakicë, siç shpjegohet në përshkrimin e depozitave me pakicë (udhëzimet për rreshtat 030-100).
	3. Depozita me pakicë të përjashtuara nga përllogaritja e flukseve dalëse *Neni 21, pika 5 e rregullores*
810	Banka raporton në këtë rresht, kategoritë e depozitave të përjashtuara nga llogaritja e flukseve dalëse, nëse janë përmbushur kushtet e nenit 21, pika 5 (p.sh. kur depozituesi nuk ka të drejtë ta tërheqë depozitën brenda 30 ditëve kalendarike ose nëse tërheqja e parakohshme brenda 30 ditëve kalendarike, do të rezultonte në një penalitet të konsiderueshëm, materialisht më të lartë se humbja e interesit të përllogaritur deri në datën e tërheqjes).
820	**4. Depozita operacionale që mbahen për të mundësuar shërbimin e shlyerjes (*clearing*), marrjes në kujdestari, administrimit të parave *cash* ose shërbime të tjera të krahasueshme në kontekstin e një marrëdhënieje operacionale të krijuar më parë me bankën** Banka raporton në këtë rresht, depozitat operacionale të parashikuara në zërin 1.1.2.1, të vendosura nga kundërpartitë e mëposhtme: - bankat; - klientë financiarë, përveç bankave; - nga qeveritë qendrore, bankat qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe njësitë e sektorit publik; - klientë të tjerë.
	4.1 Të vendosura nga bankat
830	Banka duhet të raportojë shumën e tepricës (*outstanding*) së depozitave operacionale, të parashikuara në zërin 1.1.2.1, të vendosura nga bankat.
	4.2 Të vendosura nga klientë financiarë, përveç bankave
840	Banka duhet të raportojë shumën e tepricës (*outstanding*) së depozitave operacionale, të parashikuara në zërin 1.1.2.1, të vendosura nga klientët financiarë, përveç bankave.
	4.3 Të vendosura nga qeveritë qendrore, bankat qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe njësitë e sektorit publik
850	Banka duhet të raportojë shumën e tepricës (*outstanding*) së depozitave operacionale, të parashikuara në zërin 1.1.2.1, të vendosura nga qeveritë qendrore, bankat qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe njësitë e sektorit publik.
	4.4 Të vendosura nga klientë të tjerë
860	Banka duhet të raportojë shumën e tepricës (*outstanding*) së depozitave operacionale, të parashikuara në zërin 1.1.2.1, të vendosura nga klientët e tjerë (përveç atyre të përmendur më lart dhe klientëve që konsiderohen për depozitat me pakicë).
	5. Depozita jooperacionale të mbajtura nga klientët financiarë dhe klientë të tjerë
870	Banka raporton në këtë rresht, depozitat jooperacionale të parashikuara në zërat 1.1.3.2 dhe 1.1.3.3, të vendosura nga kundërpartitë e mëposhtme: - bankat; - klientë financiarë, përveç bankave; - nga qeveritë qendrore, bankat qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe njësitë e sektorit publik; - klientë të tjerë.

880	**5.1 Të vendosura nga bankat** Banka duhet të raportojë shumën e tepricës (*outstanding*) së depozitave jooperacionale, të parashikuara në zërin 1.1.3.2, të vendosura nga bankat.
890	**5.2 Të vendosura nga klientë financiarë, përveç bankave** Banka duhet të raportojë shumën e tepricës (*outstanding*) së depozitave jooperacionale, të parashikuara në zërin 1.1.3.2, të vendosura nga klientët financiarë, përveç bankave.
900	**5.3 Të vendosura nga qeveritë qendrore, bankat qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe njësitë e sektorit publik** Banka duhet të raportojë shumën e tepricës (*outstanding*) së depozitave jooperacionale, të parashikuara në zërin 1.1.3.3, të vendosura nga qeveritë qendrore, bankat qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe njësitë e sektorit publik.
910	**5.4 Të vendosura nga klientë të tjerë** Banka duhet të raportojë shumën e tepricës (*outstanding*) së depozitave jooperacionale, të parashikuara në zërin 1.1.3.3, të vendosura nga klientët e tjerë (përveç atyre të përmendur më lart dhe klientëve që konsiderohen për depozitat me pakicë).
920	**6. Angazhime financimi për klientët jofinanciarë** *Neni 26, pika 3, shkronja "a" e rregullores* Banka duhet të raportojë tepricën (*outstanding*) e angazhimeve kontraktuale, për shtimin e financimeve ndaj klientëve jofinanciarë, brenda 30 ditëve. Për qëllimet e kësaj pike, angazhimet kontraktuale do të përfshijnë vetëm ato angazhime që nuk njihen si flukse dalëse të likuiditetit.
930	**7. Aktivet e nivelit 1, të vendosura si garanci për derivativët** Banka duhet të raportojë vlerën e tregut të garancisë (kolateralit) të nivelit 1, që është vendosur për kontratat e parashikuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe derivativët e kredisë.
940	**8. Monitorimi i transaksioneve të financimit nëpërmjet titujve** Banka duhet të raportojë shumën totale të garancisë (kolateralit) të vendosur për transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, ku një ndryshim në kursin e këmbimit, mund të shkaktojë flukse dalëse të garancisë (kolateralit) nga banka, për shkak se një pjesë e pozicionit (*leg*) të transaksioneve të financimit nëpërmjet titujve është e denominuar në një monedhë të ndryshme nga pozicioni (*leg*) tjetër.
950	**9. Flukse dalëse në valutë** Ky zë memorandumi do të raportohet vetëm në rastin e raportimit sipas monedhave të huaja të rëndësishme. Për raportimin sipas monedhave të huaja të rëndësishme, banka duhet të raportojë pjesën e flukseve dalëse nga derivativët (të raportuara në zërin 1.1.4.4), që lidhen me flukset dalëse në valutë, në monedhën përkatëse të rëndësishme nga *swap*-et e monedhave dhe transaksionet *spot* dhe *forward* të kursit të këmbimit, që maturohen brenda periudhës 30-ditore. Netimi sipas kundërpartive mund të zbatohet vetëm për flukset në atë monedhë; Për shembull, kundërpartia A: fluks hyrës +10 euro dhe kundërpartia A: fluks dalës -20 euro, do të raportohet si fluks dalës 10 euro. Banka nuk mund të netojë midis kundërpartive të ndryshme në të njëjtën monedhë; për shembull, kundërpartia A: fluks dalës -10 euro dhe kundërpartia B: fluks hyrës +40 euro, duhet të raportohen si flukse dalëse 10 euro (në formularin F2) dhe flukse hyrëse +40 euro (në formularin F3).
960	**10. Flukse dalëse në vende të huaja - me kufizime për transfertat ose që janë të denominuara në monedha të pakonvertueshme** Banka raporton në këtë rresht, flukset dalëse të likuiditetit nga vende të huaja, ku ka kufizime për transfertat ose që janë të denominuara në monedha të pakonvertueshme.

FORMULARI F3: FLUKSET HYRËSE

Shënime të përgjithshme

1. Formulari F3 është një formular përmbledhës, i cili përmban informacion rreth flukseve hyrëse të likuiditetit, të matura përgjatë 30 ditëve të ardhshme kalendarike, me qëllim raportimin e kërkesës për mbulimin me likuiditet, siç përcaktohet në këtë rregullore. Qelizat që nuk është e nevojshme të plotësohen nga banka, janë të shënuara me ngjyrë gri në formular.

2. Banka raporton këtë formular në monedhat përkatëse, siç përcaktohet në nenin 28 të kësaj rregulloreje.

3. Në përputhje me nenin 26 të kësaj rregulloreje, flukset hyrëse të likuiditetit:

a) përfshijnë vetëm flukset hyrëse kontraktuale, që burojnë nga ekspozime të cilat janë të klasifikuara në kategorinë "standarde" dhe për të cilat banka pret që të mos ketë ndryshim në klasifikim brenda 30 ditëve kalendarike;

b) llogariten duke shumëzuar tepricën e llogarisë (*outstanding balance*) të llojeve të ndryshme të llogarive të arkëtueshme kontraktuale, me normat e përcaktuara në nënkreun III të kreut IV të kësaj rregulloreje.

4. Flukset hyrëse brenda një grupi do të raportohen në kategoritë përkatëse. Shumat e paponderuara do të raportohen gjithashtu edhe si zëra memorandumi në seksionin 3 të formularit.

5. Në përputhje me nenin 26, pika 6 të kësaj rregulloreje, banka nuk duhet të raportojë flukse hyrëse që burojnë nga aktivet likuide të përcaktuara në kreun III të kësaj rregulloreje, me përjashtim të pagesave të pritshme nga aktivet që nuk janë reflektuar në vlerën e tregut të aktivit.

6. Flukset hyrëse që do të merren nga vendet e huaja, të cilat aplikojnë kufizime për transfertat ose që janë të denominuara në monedha të pakonvertueshme, duhet të raportohen në rreshtat përkatës të seksioneve 1.1, 1.2 ose 1.3. Flukset hyrëse duhet të raportohen në vlerë të plotë, pavarësisht nga shuma që i korrespondon flukseve dalëse në këtë vend të huaj apo në monedhën përkatëse.

7. Shumat për t'u marrë nga titujt e emetuar nga vetë banka ose nga një palë e lidhur me të, duhet të llogariten mbi baza neto, ku do të zbatohet një normë e flukseve hyrëse, bazuar në normën e flukseve hyrëse që zbatohet për aktivin bazë, në përputhje me nenin 26 të kësaj rregulloreje.

8. Banka nuk raporton flukse hyrëse që burojnë nga çdo kontratë e re, e cila do të nënshkruhet gjatë 30 ditëve të ardhshme kalendarike, siç parashikohet në nenin 26, pika 7 e kësaj rregulloreje.

9. Për transaksionet në monedha të huaja të rëndësishme, tepricat e raportuara do të përfshijnë vetëm vlerat që janë të denominuara në monedhën e rëndësishme përkatëse, me qëllim që të sigurohet një pasqyrim i saktë i "*gap*-eve" të monedhave. Kjo nënkupton se në formularin përkatës të raportimit në monedhën e huaj të rëndësishme, do të pasqyrohet vetëm njëra anë e transaksionit. Për shembull, në rastin e derivativëve të këmbimeve valutore, banka mund të netojë flukse hyrëse dhe flukse dalëse, në përputhje me nenin 17 të kësaj rregulloreje, vetëm nëse ata janë të denominuar në të njëjtën monedhë.

10. Në përputhje me nenin 5, pika 8 e kësaj rregulloreje, për qëllime të raportimit në baza të konsoliduara, flukset hyrëse të likuiditetit të filialit/degës së bankës në një vend të huaj, të cilat janë subjekt i kërkesave ligjore/rregullative të atij vendi të huaj, ku zbatohen norma më të ulëta të flukseve hyrëse se ato të parashikuara në nënkreun III të kreut IV të kësaj rregulloreje, banka zbaton për këto flukse hyrëse, normat më të ulëta të parashikuara në kërkesat ligjore/rregullative të atij vendi të huaj.

11. Në këtë udhëzim, koncepti "flukse hyrëse" sipas kolonës 060, përdoret si term i përgjithshëm për të treguar shumën e llogaritur pas aplikimit të normave dhe çdo udhëzimi tjetër shtesë (në rastin e huadhënies së kolateralizuar dhe financimit të garantuar).

12. Në këtë formular janë përfshirë edhe disa zëra memorandumi. Këta zëra duhet të plotësohen nga banka, ndonëse nuk janë shumë të nevojshëm për llogaritjen e raportit të mbulimit me likuiditet. Këta zëra sigurojnë informacionin e nevojshëm për Bankën e Shqipërisë, për të vlerësuar saktë përputhshmërinë e bankës me kërkesat për likuiditet. Në disa raste, ata paraqesin një detajim më të hollësishëm të zërave të përfshirë në seksionet kryesore të formularëve, ndërsa në

raste të tjera pasqyrojnë burime shtesë të likuiditetit që mund të ketë banka.

Shënime specifike në lidhje me huadhënien e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit

13. Formulari F3 i klasifikon flukset e kolateralizuara, sipas cilësisë së aktivit bazë ose të pranueshmërisë së aktiveve likuide. Një formular i veçantë ekziston për *collateral swaps*, formulari F4 i Aneksit 3 të rregullores. *Collateral swaps*, të cilat janë transaksione shkëmbimi "garanci (kolateral) me garanci" nuk do të raportohen në formularin F3, pasi ky formular mbulon vetëm transaksionet e shkëmbimit "*cash* kundrejt garancisë (kolateralit)".

14. Për transaksionet në monedha të huaja të rëndësishme, tepricat e raportuara do të përfshijnë vetëm vlerat që janë të denominuara në monedhën e rëndësishme përkatëse, me qëllim që të sigurohet një pasqyrim i saktë i "*gap*-eve" të monedhave. Kjo nënkupton se në formularin përkatës të raportimit në monedhën e huaj të rëndësishme, do të pasqyrohet vetëm njëra anë e transaksionit. Për shembull, një transaksion i marrëveshjeve të anasjella të riblerjes mund të rezultojë në një fluks hyrës negativ. Transaksionet e marrëveshjeve të anasjella të riblerjes, të raportuara në të njëjtin zë, do të mblidhen (vlera pozitive dhe negative). Nëse vlera totale rezulton pozitive, atëherë kjo vlerë do të raportohet në formularin e flukseve hyrëse. Nëse vlera totale rezulton negative, atëherë kjo vlerë do të raportohet në formularin e flukseve dalëse. Për marrëveshjet e riblerjes do të ndiqet qasja e anasjellë.

15. Banka duhet të raportojë vetëm aktivet e nivelit 1, 2A dhe 2B, të cilat kualifikohen si aktive likuide në përputhje me kreun III të rregullores. Nëse garancia (kolaterali) plotëson kriteret për t'u kualifikuar si aktiv i nivelit 1, 2A ose 2B, por nuk kualifikohet si aktiv likuid në përputhje me kreun III të rregullores, atëherë do të raportohet si aktiv jolikuid.

Në mënyrë të ngjashme, kur banka njeh si pjesë të rezervës së likuiditetit vetëm një pjesë të ekspozimeve ndaj qeverive apo bankave qendrore në valutë, apo të ekspozimeve ndaj qeverive apo bankave qendrore në monedhën vendase, vetëm pjesa e njohur do të raportohet në rreshtat përkatës të aktiveve të nivelit 1, 2A dhe 2B (referojuni nenit 11, pika 1, shkronja "d").

Në rastin kur një aktiv i veçantë është përdorur si garanci (kolateral), por vlera e tij e tejkalon pjesën e njohur si aktiv likuid, atëherë pjesa e tepërt, do të raportohet në seksionin e aktiveve jolikuide.

Shënime specifike për shlyerjen dhe transaksionet që do të fillojnë në të ardhmen (*forward starting transactions*)

16. Banka raporton flukset hyrëse që rrjedhin nga marrëveshjet e riblerjes që fillojnë brenda një periudhe prej 30 ditësh kalendarike dhe maturohen pas periudhës prej 30 ditësh kalendarike. Flukset hyrëse që pritet të merren, do të raportohen në formularin F3 ("flukse hyrëse të tjera (që nuk janë përfshirë në asnjë nga rreshtat e mësipërm)"), pasi të zbritet vlera e tregut e aktivit që do t'i dorëzohet kundërpartisë, pas aplikimit të *haircut*-it përkatës. Nëse aktivi nuk është një "aktiv likuid", fluksi hyrës që pritet të merret do të raportohet i plotë. Aktivi që do të vendoset si garanci (kolateral), do të raportohet në formularin F1, nëse banka e mban aktivin në llogaritë kontabël të saj në datën e raportimit dhe nëse aktivi plotëson kushtet përkatëse.

17. Banka raporton flukset hyrëse që rrjedhin nga marrëveshjet e riblerjes, marrëveshjet e anasjella të riblerjes dhe *collateral swaps* që fillojnë brenda një periudhe prej 30 ditësh kalendarike dhe maturohen pas periudhës prej 30 ditësh kalendarike, kur pozicioni fillestar (*leg*) prodhon një fluks hyrës. Në rastin e një marrëveshjeje të riblerjes, flukset hyrëse që pritet të merren do të raportohen në formularin F3 ("flukse hyrëse të tjera (që nuk janë përfshirë në asnjë nga rreshtat e mësipërm)"), pasi të zbritet vlera e tregut të aktivit që do t'i dorëzohet kundërpartisë, pas aplikimit të *haircut*-it përkatës. Nëse shuma që do të merret është më e ulët se vlera e tregut e aktivit (pas aplikimit të haircut-it) që do të jepet si garanci (kolateral), diferenca do të raportohet si një fluks dalës në formularin F2. Nëse aktivi nuk është një "aktiv likuid", flukset hyrëse që pritet të merren do të raportohen të plota. Aktivi që do të vendoset si garanci (kolateral), do të raportohet në formularin F1, nëse banka e mban aktivin në llogaritë kontabël të saj në datën e raportimit dhe nëse aktivi plotëson kushtet përkatëse. Në rastin e një marrëveshjeje të

anasjellë të riblerjes, ku vlera e tregut të aktivit që do të merret si garanci (kolateral), pas aplikimit të *haircut*-it përkatës (nëse aktivi kualifikohet si aktiv likuid), është më e madhe se shuma e parave për t'u dhënë hua, diferenca do të raportohet si një fluks hyrës në rreshtin e sipërpërmendur. Për *collateral swaps*, ku efekti neto i shkëmbimit fillestar të aktiveve (duke marrë parasysh *haircut*-et përkatëse) krijon një fluks hyrës, ky fluks hyrës do të raportohet në rreshtin e sipërpërmendur.

18. Marrëveshjet e riblerjes, marrëveshjet e anasjella të riblerjes dhe *collateral swaps* të ardhshme, që fillojnë dhe maturohen brenda 30 ditëve kalendarike, nuk kanë ndonjë ndikim në raportin e mbulimit me likuiditet të bankës, prandaj mund të mos merren parasysh.

Udhëzime në lidhje me kolonat specifike

Kolona	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
010	**Shuma - Subjekt i *cap*-it 75% mbi flukset hyrëse** *Neni 26 dhe neni 27 i rregullores* Banka raporton në kolonën 010, shumën totale të aktiveve/shumat për t'u marrë/shumat maksimale që mund të tërhiqen dhe që janë subjekt i *cap*-it 75% mbi flukset hyrëse, siç përcaktohen në nenin 27, pika 1 e kësaj rregulloreje, duke ndjekur udhëzimet përkatëse të përfshira në këtë udhëzues.
020	**Vlera e tregut e kolateralit (garancisë) të marrë - subjekt i *cap*-it 75% mbi flukset hyrëse** *Neni 26 dhe neni 27 i rregullores* Banka raporton në kolonën 020, vlerën e tregut të kolateralit (garancisë) të pranuar në transaksionet e huadhënies së kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, subjekt i *cap*-it 75% mbi flukset hyrëse, siç përcaktohen në nenin 27, pika 1 të kësaj rregulloreje.
030	**Norma standarde** *Neni 26 dhe neni 27 i rregullores* Normat standarde në kolonën 030 i referohen normave të përcaktuara në këtë rregullore.
040	**Norma e zbatuar - subjekt i *cap*-it 75% mbi flukset hyrëse** *Neni 26 dhe neni 27 i rregullores* Banka raporton në këtë kolonë, normat e zbatuara prej saj. Këto norma janë ato të parashikuara në nenet 26 dhe 27 të rregullores. Normat e zbatuara mund të rezultojnë në vlera mesatare të ponderuara dhe do të raportohen në numra dhjetorë (d.m.th. 1,00 për një normë të zbatueshme prej 100% ose 0,50 për një normë të zbatueshme prej 50%). Normat e zbatuara mund të reflektojnë, por nuk kufizohen në, karakteristikat specifike të bankës apo të vendit. Banka raporton në kolonën 040, normën e flukseve hyrëse të zbatuar prej saj, për aktivet/shumat për t'u marrë/shumat maksimale që mund të tërhiqen, subjekt i *cap*-it 75% mbi flukset hyrëse siç përcaktohet në nenin 27, pika 1 e rregullores, ose normën e zbatuar për vlerën e tregut të kolateralit (garancisë) të pranuar në transaksionet e huadhënies së kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, subjekt i *cap*-it 75% mbi flukset hyrëse.
050	**Vlera e kolateralit të marrë, sipas nenit 10 të rregullores - subjekt i *cap*-it 75% mbi flukset hyrëse** *Neni 26 dhe neni 27 i rregullores* Banka raporton në kolonën 050, sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje, vlerën e kolateralit të marrë në transaksionet e huadhënies së kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit.
	Flukset hyrëse - Subjekt i *cap*-it 75% mbi flukset hyrëse *Neni 26 dhe neni 27 i rregullores* Banka raporton në kolonën 060, flukset hyrëse totale që janë subjekt i *cap*-it 75% mbi

060	flukset hyrëse, siç përcaktohet në nenin 27, pika 1 e rregullores, të cilat llogariten duke shumëzuar shumën totale/shumën maksimale që mund të tërhiqet (në kolonën 010) me normën përkatëse të zbatuar nga banka (në kolonën 040). Për rreshtat {060}-{090}, do të ndiqet procedura e mëposhtme: Nëse nuk ka angazhime kontraktuale ose nëse angazhimet kontraktuale për këta tipa klientësh, janë më pak se 50% e shumave për t'u marrë prej tyre, të raportuara në kolonën 010, atëherë shumat për t'u marrë do të reduktohen me 50% dhe rezultati do të raportohet në kolonën 060. Në këtë rast, nuk do raportohet asnjë detyrim në formularin F2. • Nëse angazhimet kontraktuale ndaj klientit janë më të mëdha ose të barabarta me 50%, por jo më të mëdha se 100% e shumave për t'u marrë prej tij, që raportohen në kolonën 010, atëherë shumat për t'u marrë do të reduktohen me angazhimin kontraktual ndaj këtij tipi klienti dhe rezultati do të raportohet në kolonën 060. Në këtë rast nuk do të raportohet asnjë detyrim në formularin F2. • Nëse angazhimet kontraktuale ndaj klientit janë më të mëdha se 100% e shumave për t'u marrë prej tij, që raportohen në kolonën 010, atëherë në kolonën 060 do të raportohet vlera "0" dhe diferenca midis angazhimeve kontraktuale dhe shumave për t'u marrë në kolonën 010, do të raportohet në zërat 1.1.6.6.1.1, 1.1.6.6.1.2, 1.1.6.6.1.3 ose 1.1.6.6.1.4 të formularit F2. • Banka sigurohet që këta zëra nuk përllogariten dy herë (*double-counting*), në formularin F2 dhe në formularin F3. Për rreshtat {230}-{250} dhe për rreshtin {320}, banka raporton në kolonën 060, flukset hyrëse totale që janë subjekt i *cap*-it 75% mbi flukset hyrëse, siç përcaktohen në nenin 27, pika 1 e rregullores, që llogaritet duke zbritur kolonën 050 nga kolona 010. Nëse rezultati është pozitiv, do të raportohet vlera në kolonën 060; nëse rezultati është negativ, do të raportohet vlera "0".

Udhëzime në lidhje me rreshtat specifikë

Rreshti	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
010	**1. Flukset hyrëse totale** *Neni 26 dhe neni 27 i rregullores* Banka raporton në rreshtin 010 të formularit F3: • Për kolonën 010, shumën totale të aktiveve/shumën për t'u marrë/shumën maksimale që mund të tërhiqet, e llogaritur si shumë e aktiveve/shumave për t'u marrë/shumave maksimale që mund të tërhiqen nga transaksionet e pasiguruara/depozitat dhe huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e tregut të kapitalit; • Për kolonën 060, flukset hyrëse totale si shumë e flukseve hyrëse nga transaksionet e pasiguruara/depozitat, huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e tregut të kapitalit dhe transaksionet e *Collateral Swaps* minus diferencën midis totalit të flukseve hyrëse të ponderuara dhe totalit të flukseve dalëse të ponderuara, që burojnë nga transaksionet në vende të huaja, ku ka kufizime për transfertat ose që janë të denominuara në monedha të pakonvertueshme.
020	**1.1 Flukse hyrëse nga transaksione të pasiguruara/depozitat** *Nenet 26 dhe 27 të rregullores* Banka raporton në rreshtin 020 të formularit F3: • Për kolonën 010, shumën totale të aktiveve/shumën për t'u marrë/shumën maksimale që mund të tërhiqet nga transaksionet e pasiguruara/depozitat; dhe • Për kolonën 060, flukset hyrëse totale nga transaksionet e pasiguruara/depozitat.
	1.1.1 Shumat për t'u marrë nga klientët jofinanciarë (me përjashtim të bankave qendrore)

030	*Neni 26, pika 3, shkronja "a" e rregullores* Banka raporton në rreshtin 030 të formularit F3: • Për kolonën 010, vlerën totale të shumave për t'u marrë nga klientët jofinanciarë (me përjashtim të bankave qendrore), të cilat nuk korrespondojnë me pagesat e kryegjësë, si dhe çdo shumë tjetër për t'u marrë nga klientët jofinanciarë); dhe • Për kolonën 060, flukset hyrëse totale nga klientët jofinanciarë (me përjashtim të bankave qendrore), të cilët nuk korrespondojnë me pagesat e kryegjësë, si dhe çdo fluks hyrës tjetër nga klientët jofinanciarë. Shumat për t'u marrë nga transaksionet e huadhënies së kolateralizuar dhe transaksionet e tregut të kapitalit (siç përcaktohen në pikat (27) dhe (28) të nenit 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit) me një klient jofinanciar, që janë të garantuara me aktive likuide në përputhje me kreun III të kësaj rregulloreje, do të raportohen në seksionin 1.2 dhe jo në seksionin 1.1.1. Shumat për t'u marrë nga transaksione të tilla, që janë të garantuara me tituj të transferueshëm që nuk kualifikohen si aktive likuide në përputhje me kreun III të kësaj rregulloreje, do të raportohen në seksionin 1.2 dhe jo në seksionin 1.1.1. Shumat për t'u marrë nga transaksione të tilla me klientët jofinanciarë që janë të garantuara me aktive jo të transferueshme, që nuk kualifikohen si aktive likuide në përputhje me kreun III të kësaj rregulloreje, do të raportohen në rreshtin përkatës të seksionit 1.1.1. Shumat për t'u marrë nga bankat qendrore do të raportohen në seksionin 1.1.2 dhe nuk do të raportohen në këtë rresht.
040	**1.1.1.1 Shumat për t'u marrë (interesa dhe komisione) nga klientët jofinanciarë (me përjashtim të bankave qendrore) që nuk i korrespondojnë pagesave të kryegjësë** *Neni 26, pika 3, shkronja "a" e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, shumat për t'u marrë nga klientët jofinanciarë (me përjashtim të bankave qendrore) që nuk korrespondojnë me pagesën e kryegjësë. Këto flukse hyrëse përfshijnë interesat dhe komisionet, që pritet të merren nga klientët jofinanciarë (me përjashtim të bankave qendrore). Shumat për t'u marrë nga bankat qendrore, që nuk i korrespondojnë pagesave të kryegjësë, do të raportohen në seksionin 1.1.2 dhe jo në këtë rresht.
050	**1.1.1.2 Shumat për t'u marrë nga klientët jofinanciarë (me përjashtim të bankave qendrore) që i korrespondojnë pagesave të kryegjësë** *Neni 26, pika 3, shkronja "a" e rregullores* Banka raporton në rreshtin 050 të formularit F3: • Për kolonën 010, vlerën totale të shumave për t'u marrë nga klientët jofinanciarë (me përjashtim të bankave qendrore), e llogaritur si shumë e vlerave që priten të merren nga klientët jofinanciarë, që i korrespondojnë pagesave të kryegjësë dhe shumave të tjera për t'u marrë, sipas kundërpartive; dhe • Për kolonën 060, flukset hyrëse totale nga klientët jofinanciarë (me përjashtim të bankave qendrore), e llogaritur si shumë e flukseve hyrëse që i korrespondojnë pagesave të kryegjësë dhe flukseve hyrëse të tjera nga klientët jofinanciarë, sipas kundërpartive. Shumat për t'u marrë nga klientët jofinanciarë (me përjashtim të bankave qendrore), që nuk i korrespondojnë pagesave të kryegjësë, do të raportohen në seksionin 1.1.1.1 dhe jo në këtë rresht. Shumat për t'u marrë nga bankat qendrore, që i korrespondojnë pagesave të kryegjësë dhe shuma të tjera, do të raportohen në seksionin 1.1.2 dhe jo në këtë rresht.

060	**1.1.1.2.1 Shumat për t'u marrë nga klientët me pakicë** *Neni 26, pika 3, shkronja "a" e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, shumat për t'u marrë nga klientë me pakicë.
070	**1.1.1.2.2 Shumat për t'u marrë nga shoqëritë tregtare** *Neni 26, pika 3, shkronja "a" e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, shumat për t'u marrë nga shoqëritë tregtare.
080	**1.1.1.2.3 Shumat për t'u marrë nga qeveritë qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe njësitë e sektorit publik** *Neni 26, pika 3, shkronja "a" e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, shumat për t'u marrë nga qeveritë qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe njësitë e sektorit publik.
090	**1.1.1.2.4 Shumat për t'u marrë nga subjekte juridike të tjera (që nuk janë të përfshirë në asnjë nga rreshtat e mësipërm)** *Neni 26, pika 3, shkronja "a" e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, shumat për t'u marrë nga subjekte të tjera juridike, që nuk përfshihen në rreshtat e mësipërm.
100	**1.1.2 Shumat për t'u marrë nga bankat qendrore dhe klientët financiarë** *Neni 26, pika 2, shkronja "a" e rregullores* Banka raporton në rreshtin 100 të formularit F3: • Për kolonën 010, vlerën totale të shumave për t'u marrë nga bankat qendrore dhe klientët financiarë; dhe • Për kolonën 060, flukset hyrëse totale nga bankat qendrore dhe klientët financiarë. Banka raporton në këtë rresht, shumat për t'u marrë përgjatë 30 ditëve të ardhshme kalendarike, nga bankat qendrore dhe klientët financiarë, që burojnë nga ekspozime, të cilat janë të klasifikuara në kategorinë "standarde" dhe për të cilat banka pret të mos ketë ndryshim në klasifikim brenda 30 ditëve kalendarike.
110	**1.1.2.1 Shumat për t'u marrë nga bankat qendrore dhe klientët financiarë që nuk klasifikohen si depozita operacionale** *Neni 26, pika 2, shkronja "a" e rregullores* Banka raporton në rreshtin 110 të formularit F3: • Për kolonën 010, vlerën totale të shumave për t'u marrë nga bankat qendrore dhe klientët financiarë, që nuk klasifikohen si depozita operacionale; dhe • Për kolonën 060, flukset hyrëse totale nga bankat qendrore dhe klientët financiarë, që nuk klasifikohen si depozita operacionale. Banka raporton në këtë rresht, shumat për t'u marrë nga bankat qendrore dhe klientët financiarë, që nuk klasifikohen si depozita operacionale, sipas përcaktimeve në nenin 22 të kësaj rregulloreje.
120	**1.1.2.1.1 Shumat për t'u marrë nga bankat qendrore** *Neni 26, pika 2, shkronja "a" e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, shumat për t'u marrë nga bankat qendrore.
130	**1.1.2.1.2 Shumat për t'u marrë nga klientët financiarë** *Neni 26, pika 2, shkronja "a" e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, shumat për t'u marrë nga klientët financiarë, që nuk klasifikohen si depozita operacionale, siç përcaktohen në nenin 22 të kësaj rregulloreje.
140	**1.1.3 Shumat për t'u marrë nga transaksionet e financimit tregtar** *Neni 26, pika 2, shkronja "a", nënpika "ii" e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, shumat për t'u marrë përgjatë 30 ditëve të ardhshme nga transaksionet afatshkurtra të financimit tregtar (*trade finance*), në përputhje me nenin 26,

	pika 2, shkronja "a", nënpika "ii" e kësaj rregulloreje.
150	**1.1.4 Shumat për t'u marrë nga tituj që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike** *Neni 26, pika 2, shkronja "a", nënpika "i" e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, shumat për t'u marrë nga titujt që maturohen brenda 30 ditëve, në përputhje me nenin 26, pika 2, shkronja "a", nënpika "i" e kësaj rregulloreje.
160	**1.1.5 Aktivet që nuk kanë një datë maturimi të përcaktuar në kontratë** *Neni 26, pika 3, shkronja "g" e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, aktivet të cilat nuk kanë një datë maturimi të përcaktuar në kontratë, në përputhje me nenin 26, pika 3, shkronja "g" të kësaj rregulloreje. Banka i konsideron flukset hyrëse, vetëm nëse kontrata e lejon bankën të tërheqë ose të kërkojë pagesën e shumës brenda 30 ditëve. Interesat dhe pagesat minimale që do të debitohen kundrejt llogarisë së klientit brenda 30 ditëve, do të përfshihen në shumën e raportuar. Interesat dhe pagesat minimale nga aktivet me një datë maturimi të papërcaktuar në kontratë, të cilat maturohen dhe krijojnë një fluks aktual hyrës të *cash*-it brenda 30 ditëve të ardhshme, do të konsiderohen si shuma për t'u marrë dhe do të raportohen në rreshtin përkatës, duke ndjekur trajtimin e përshkruar në nenin 26 të kësaj rregulloreje, për shumat për t'u marrë. Banka nuk raporton interesa të tjera të përllogaritura, të cilat nuk e debitojnë llogarinë e klientit dhe as nuk krijojnë një fluks aktual hyrës të *cash*-it përgjatë 30 ditëve.
170	**1.1.6 Shuma për t'u marrë nga pozicionet në indekset kryesore të instrumenteve të kapitalit, me kushtin që të mos përllogariten edhe si aktive likuide** *Neni 26, pika 2, shkronja "b" e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, shumat për t'u marrë nga pozicionet në indekset kryesore të instrumenteve të kapitalit, me kusht që të mos përllogariten edhe si aktive likuide, në përputhje me nenin 26, pika 2, shkronja "b" të kësaj rregulloreje. Pozicionet përfshijnë shumat që maturohen brenda 30 ditëve të ardhshme sipas kushteve të kontratës, të tilla si dividendë në *cash* nga indekset kryesore të instrumenteve të kapitalit dhe llogari të arkëtueshme (shuma për t'u marrë) nga instrumente të tilla të kapitalit, të shitur, por ende të pashlyer, në rast se nuk janë njohur si aktive likuide në përputhje me kreun III të kësaj rregulloreje.
180	**1.1.7 Flukse hyrëse nga lehtësirat e patërhequra të kredisë ose të likuiditetit, si dhe çdo angazhim tjetër i marrë nga bankat qendrore me kushtin që të mos përllogariten edhe si aktive likuide** *Neni 26, pika 3, shkronja "e" e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, flukset hyrëse nga lehtësirat e patërhequra të kredive ose të likuiditetit, si dhe nga çdo angazhim tjetër i marrë nga bankat qendrore, në përputhje me nenin 26, pika 3, shkronja "e" e kësaj rregulloreje, me kusht që të mos përllogariten edhe si aktive likuide. Lehtësirat e patërhequra të kredive ose të likuiditetit, si dhe çdo angazhim tjetër, të marra nga subjekte të tjera, që nuk janë banka qendrore, nuk do të merren në konsideratë dhe nuk do të raportohen në këtë rresht.
190	**1.1.8 Flukset hyrëse nga kontratat e derivativëve** *Neni 26, pika 5 e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, shumat neto të llogarive të arkëtueshme, të pritshme për t'u marrë gjatë periudhës prej 30 ditë kalendarike, nga kontratat e listuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Banka i përllogarit flukset hyrëse të pritshme përgjatë 30 ditëve kalendarike, mbi baza neto, sipas kundërpartive, që janë subjekt i marrëveshjeve dypalëshe të netimit (kompensimit), në përputhje me nenin 134 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

	Llogaritja mbi baza neto nënkupton gjithashtu zbritjen e vlerës së garancisë (kolateralit) që do të merret, me kushtin që të jetë e kualifikuar si aktiv likuid, në përputhje me kreun III të kësaj rregulloreje. Flukset dalëse dhe flukset hyrëse që krijohen nga transaksionet derivative të monedhave të huaja, që përfshijnë shkëmbimin e plotë të shumave të kryegjësë mbi baza të njëkohshme/simultane (ose brenda së njëjtës ditë) do të llogariten mbi baza neto, edhe në rastin kur këto transaksione nuk mbulohen nga një marrëveshje dypalëshe netimi (kompensimi). Për raportimin sipas monedhave të huaja të rëndësishme, flukset e transaksioneve në monedha të huaja, do të ndahen sipas monedhave përkatëse. Netimi sipas kundërpartisë mund të zbatohet vetëm për flukset në të njëjtën monedhë.
200	**1.1.9 Flukse hyrëse të tjera (që nuk janë përfshirë në asnjë nga rreshtat e mësipërm)** *Neni 26, pika 2 e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, të gjitha flukset hyrëse të tjera në përputhje me nenin 26, pika 2 të kësaj rregulloreje, të cilat nuk janë raportuar në asnjë nga rreshtat e tjerë të këtij formulari.
210	**1.2 Flukse hyrëse nga transaksionet e huadhënies së kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit** *Neni 26, pika 3, shkronjat "b" dhe "d" të rregullores* Banka raporton në rreshtin 210 të formularit F3: • Për kolonën 010, vlerën totale të shumave për t'u marrë nga huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit (pavarësisht nëse garancia (kolaterali) kualifikohet si një aktiv likuid ose jo); dhe • Për kolonën 060, flukset hyrëse totale nga huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit (pavarësisht nëse garancia (kolaterali) kualifikohet si një aktiv likuid ose jo).
220	**1.2.1 Të garantuara me aktive likuide** Banka raporton në rreshtin 220 të formularit F3: • Për kolonën 010, vlerën totale të shumave për t'u marrë nga huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, ku garancia (kolaterali) kualifikohet si aktiv likuid, e llogaritur si totali i shumave për t'u marrë nga huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, sipas llojit të garancisë (kolateralit); • Për kolonën 020, vlerën totale të tregut të garancisë (kolateralit) të marrë nga huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, ku garancia (kolaterali) kualifikohet si aktiv likuid, e llogaritur si shuma e vlerave të tregut të garancisë (kolateralit) të marrë nga huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, sipas llojit të garancisë (kolateralit); • Për kolonën 050, vlerën totale të garancisë (kolateralit) të marrë, e vlerësuar në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje, nga huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, ku garancia (kolaterali) kualifikohet si aktiv likuid, e llogaritur si shuma e vlerave të garancisë (kolateralit) të marrë, të vlerësuar në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje, nga huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, sipas llojit të garancisë (kolateralit); dhe • Për kolonën 060, flukset hyrëse totale nga huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, ku garancia (kolaterali) kualifikohet si aktiv likuid, të llogaritura si shuma e flukseve hyrëse nga huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, sipas llojit të garancisë (kolateralit).

230	1.2.1.1 **Të garantuara me aktive të nivelit 1** *Neni 26, pika 3, shkronja "b" e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, transaksionet e huadhënies së kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, ku garancitë (kolateralet) i përkasin aktiveve të nivelit 1.
240	**1.2.1.2 Të garantuara me aktive të nivelit 2A** *Neni 26, pika 3, shkronja "b" e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, transaksionet e huadhënies së kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, ku garancitë (kolateralet) i përkasin aktiveve të nivelit 2A.
250	**1.2.1.3 Të garantuara me aktive të nivelit 2B** *Neni 26, pika 3, shkronja "b" e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, transaksionet e huadhënies së kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, ku garancitë (kolateralet) i përkasin aktiveve të nivelit 2B, në përputhje me nenin 13 të rregullores.
260	**1.2.2 Garancia përdoret për të mbuluar një pozicion të shkurtër** *Neni 26, pika 3, shkronja "b" e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, transaksionet e huadhënies së kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, ku garancia (kolaterali) përdoret për të mbuluar një pozicion të shkurtër. Banka mban parasysh që nuk duhet të ketë përllogaritje të dyfishta.
270	**1.2.3 Të garantuara me aktive që nuk klasifikohen si aktive likuide** Banka raporton në rreshtin 270 të formularit F3: Për kolonën 010, vlerën totale të shumave për t'u marrë nga huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, ku garancia (kolaterali) nuk kualifikohet si aktiv likuid, e llogaritur si totali i shumave për t'u marrë nga huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, ku garancia (kolaterali) është aktiv jolikuid; dhe • Për kolonën 060, flukset hyrëse totale nga huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, ku garancia (kolaterali) nuk kualifikohet si aktiv likuid, e llogaritur si shuma e flukseve hyrëse nga huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, ku garancia (kolaterali) është aktiv jolikuid.
280	**1.3 Flukse hyrëse totale nga *collateral swaps*** Banka raporton në këtë rresht, shumën e flukseve hyrëse totale nga *collateral swaps*, të llogaritura në kolonën 060 të formularit F4.
290	**1.4 (Diferenca midis flukseve hyrëse totale të ponderuara dhe flukseve dalëse totale të ponderuara, që burojnë nga transaksione me vende të huaja, të cilat zbatojnë kufizime për transfertat ose që janë të denominuara në monedha të pakonvertueshme)** *Neni 26, pika 8 e rregullores* Banka raporton në kolonën 060, shumën e flukseve hyrëse totale të ponderuara, që do të merren nga vende të huaja, ku aplikohen kufizime për transfertat, ose që janë të denominuara në monedha të pakonvertueshme, minus shumën e flukseve dalëse totale të ponderuara në vendet e huaja (siç raportohen në formularin F2 te zërat e memorandumit), ku aplikohen kufizime për transfertat, ose që janë të denominuara në monedha të pakonvertueshme. Në rastet kur shuma rezulton negative, banka do të raportojë vlerën "0".

Zëra memorandumi	
300	**2. Flukse hyrëse në valutë** Ky zë memorandumi do të raportohet vetëm në rastin e raportimit sipas monedhave të huaja të rëndësishme. Për raportimin sipas monedhave të huaja të rëndësishme, banka duhet të raportojë pjesën e flukseve hyrëse nga derivativët (të raportuara në seksionin 1.1.8), që lidhen me flukset hyrëse në valutë, në monedhën përkatëse të rëndësishme nga *swap*-et e monedhave dhe transaksionet *spot* dhe *forward* të kursit të këmbimit, që maturohen brenda periudhës 30-ditore. Netimi sipas kundërpartisë mund të zbatohet vetëm për flukset në atë monedhë.
310	**3. Flukse hyrëse brenda grupit** Banka raporton në këtë rresht, si zëra memorandumi, të gjitha transaksionet e raportuara në seksionin 1, ku kundërpartia është banka mëmë ose një filial i bankës ose një filial tjetër i bankës mëmë. Banka raporton në rreshtin 310 të formularit F3: • Për kolonën 010, vlerën totale të shumave për t'u marrë/shumës maksimale që mund të tërhiqet brenda një grupi, e llogaritur si totali i shumave për t'u marrë/shumës maksimale që mund të tërhiqet brenda një grupi, sipas llojit të transaksionit dhe të kundërpartisë, dhe • Për kolonën 060, flukset hyrëse totale brenda grupit, të llogaritura si shuma e flukseve hyrëse brenda një grupi, sipas llojit të transaksionit dhe të kundërpartisë.
320	**3.1 Nga transaksione të garantuara** Banka raporton në këtë rresht, të gjitha shumat për t'u marrë nga huadhënia e kolateralizuar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit, si dhe vlerën totale të tregut të garancisë (kolateralit) të marrë, të raportuara në seksionin 1.2 dhe vlerën e garancisë (kolateralit) të marrë, të vlerësuar në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje (në kolonën 050), ku kundërpartia është banka mëmë ose një filial i bankës, ose një filial tjetër i bankës mëmë.
330	**3.2 Shuma për t'u marrë nga tituj që maturohen brenda 30 ditëve** Banka raporton në këtë rresht, të gjitha shumat për t'u marrë nga tituj që maturohen brenda 30 ditëve, të raportuara në seksionin 1.1.4, ku emetuesi është banka mëmë ose një filial i bankës ose një filial tjetër i bankës mëmë.
340	**3.3 Flukse hyrëse nga lehtësira të patërhequra të kredisë ose likuiditetit, të dhëna nga subjektet e tjera të grupit bankar/financiar** Flukse hyrëse nga lehtësira të patërhequra të kredisë ose likuiditetit, të dhëna nga subjektet e tjera të grupit bankar/financiar ku banka bën pjesë.

FORMULARI F4: *COLLATERAL SWAPS*

Shënime të përgjithshme

1. Në këtë formular duhet të raportohet çdo transaksion me maturim deri në 30 ditë, në të cilin aktivet "*jocash*" këmbehen me aktive të tjera "*jocash*". Qelizat që nuk është e nevojshme të plotësohen nga banka, janë të shënuara me ngjyrë gri në formular.

2. *Collateral swaps* që maturohen brenda 30 ditësh, do të shkaktojnë flukse dalëse për diferencën (tepricën) midis vlerës së likuiditetit të aktiveve të marra hua, kundrejt atyre të dhëna hua, me përjashtim të rastit kur kundërpartia është një bankë qendrore, për të cilën do të zbatohet një normë e flukseve dalëse prej 0%.

3. *Collateral swaps*, që maturohen brenda 30 ditësh, do të shkaktojnë flukse hyrëse për diferencën (tepricën) midis vlerës së likuiditetit të aktiveve të dhëna hua, kundrejt atyre të marra hua, me përjashtim të rastit kur garancia (kolaterali) e marrë rivendoset si garanci, për të mbuluar pozicionet e shkurtra, që mund të tejkalojnë 30 ditë, për të cilat do të zbatohet një normë e flukseve hyrëse prej 0%.

4. Për aktivet likuide, vlera e likuiditetit llogaritet në përputhje me kërkesat e nenit 10 të rregullores, ndërsa për aktivet jolikuide, vlera e likuiditetit është zero.

5. Çdo transaksion i *collateral swaps*, do të vlerësohet individualisht dhe flukset do të raportohen në rreshtin përkatës, si fluks hyrës apo dalës (mbi baza transaksioni). Nëse një marrëveshje përmban disa lloje garancish (kolateralesh), për qëllime raportimi, garancitë duhet të ndahen sipas rreshtave përkatës dhe të vlerësohen në mënyrë të veçuar.

6. Për transaksionet në monedha të huaja të rëndësishme, tepricat e raportuara do të përfshijnë vetëm vlerat që janë të denominuara në monedhën e rëndësishme përkatëse, me qëllim që të sigurohet një pasqyrim i saktë i "*gap*-eve" të monedhave. Kjo nënkupton se në formularin përkatës të raportimit në monedhën e huaj të rëndësishme, do të pasqyrohet vetëm njëra anë e transaksionit, çka do të ndikojë përkatësisht në diferencën (tepricën) e vlerës së likuiditetit.

7. Banka raporton këtë formular sipas monedhave përkatëse, siç përcaktohet në nenin 28 të kësaj rregulloreje.

8. Flukset e derivativëve të kolateralizuar brenda 30 ditësh, do të raportohen në këtë formular në kolonat 070–100 dhe jo në kolonat 010–060.

Shënime specifike

9. Banka duhet të raportojë vetëm aktivet e nivelit 1, 2A dhe 2B, të cilat kualifikohen si aktive likuide në përputhje me kreun III të rregullores. Për garancitë e dhëna hua, i referohet aktiveve që klasifikohen në maturitet si aktive likuide, në përputhje me kreun III dhe me kërkesat e përgjithshme dhe operacionale, siç përcaktohen në nenet 8 dhe 9 të rregullores.

10. Nëse garancia (kolaterali) plotëson kriteret për t'u kualifikuar si aktiv i nivelit 1, 2A ose 2B të parashikuara në nenet 11-15 të rregullores, por nuk kualifikohet si aktiv likuid në përputhje me kreun III dhe me kërkesat e përgjithshme dhe operacionale, siç përcaktohen në nenet 8 dhe 9 të rregullores, atëherë do të raportohet si aktiv jolikuid.

Në mënyrë të ngjashme, kur banka njeh si pjesë të rezervës së likuiditetit vetëm një pjesë të ekspozimeve ndaj qeverive apo bankave qendrore në valutë, apo të ekspozimeve ndaj qeverive apo bankave qendrore në monedhën vendase, vetëm pjesa e njohur do të raportohet në rreshtat përkatës të aktiveve të nivelit 1, 2A dhe 2B (referojuni nenit 11, pika 1, shkronja "d").

Në rastin kur një aktiv i veçantë është përdorur si garanci (kolateral), por vlera e tij e tejkalon pjesën e njohur si aktiv likuid, atëherë pjesa e tepërt, do të raportohet në seksionin e aktiveve jolikuide.

Udhëzime në lidhje me kolonat specifike

Kolona	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
010	**Vlera e tregut të garancisë të dhënë hua** Vlera e tregut të garancisë (kolateralit) të dhënë hua, do të raportohet në kolonën 010. Vlera e tregut do të reflektojë vlerën aktuale të tregut, para zbatimit të *haircut*-eve dhe pas marrjes në konsideratë të flukseve që do të rezultonin nga përfundimi i mbrojtjes (*hedge*), të lidhur me të (neni 9, pika 8 e rregullores).
020	**Vlera e likuiditetit të garancisë së dhënë hua** Vlera e likuiditetit të garancisë (kolateralit) së dhënë hua, do të raportohet në kolonën 020. Për aktivet likuide, vlera e likuiditetit do të reflektojë vlerën e aktivit pas zbatimit të *haircut*-it përkatës. *Haircut*-i që do të zbatohet do të lidhet me *haircut*-in e zbatuar për aktivin përkatës në formularin F1. *Haircut*-i i përdorur do të përcaktohet nga vetë banka, por në çdo rast banka do të marrë në konsideratë *haircut*-et përkatëse standarde minimale të parashikuara në kreun III të rregullores.
030	**Vlera e tregut të garancisë së marrë hua** Vlera e tregut të garancisë së marrë hua do të raportohet në kolonën 030. Vlera e tregut do të reflektojë vlerën aktuale të tregut, para zbatimit të *haircut*-eve dhe pas marrjes në konsideratë të flukseve që do të rezultonin nga përfundimi i mbrojtjes (*hedge*), të lidhur me

	të (neni 9, pika 8 e rregullores).
040	**Vlera e likuiditetit të garancisë të marrë hua** Vlera e likuiditetit e garancisë (kolateralit) të marrë hua, do të raportohet në kolonën 040. Për aktivet likuide, vlera e likuiditetit do të reflektojë vlerën e aktivit pas zbatimit të *haircut*-it përkatës. *Haircut*-i që do të zbatohet do të lidhet me *haircut*-in e zbatuar për aktivin përkatës në formularin F1. *Haircut*-i i përdorur do të përcaktohet nga vetë banka, por në çdo rast banka do të marrë në konsideratë *haircut*-et përkatëse standarde minimale të parashikuara në kreun III të rregullores.
050	**Flukset dalëse** Në rastin kur vlera e kolonës 040 është më e madhe se vlera e kolonës 020 (në nivel transaksioni), diferenca do të raportohet në kolonën 050 (flukset dalëse), me përjashtim të rasteve kur kundërpartia është një bankë qendrore, për të cilën do të raportohet vlera zero për flukset dalëse.
060	**Flukset hyrëse subjekt i *cap*-it 75%** Në rastin kur vlera e kolonës 020 është më e madhe se vlera e kolonës 040 (në nivel transaksioni), diferenca do të raportohet në kolonën 060 (flukset hyrëse), me përjashtim të rasteve kur garancia (kolaterali) e marrë rivendoset si garanci, për të mbuluar pozicionet e shkurtra, që mund të tejkalojnë 30 ditë, për të cilat do të raportohet vlera zero për flukset hyrëse.
070	**Vetëm për derivativët e kolateralizuar: vlera e tregut të garancisë të dhënë hua** Vlera e tregut të garancisë (kolateralit) të dhënë hua, do të raportohet në kolonën 070. Vlera e tregut do të reflektojë vlerën aktuale të tregut, para zbatimit të *haircut*-eve dhe pas marrjes në konsideratë të flukseve që do të rezultonin nga përfundimi i mbrojtjes (*hedge*), të lidhur me të (neni 9, pika 8 e rregullores).
080	**Vetëm për derivativët e kolateralizuar: vlera e likuiditetit të garancisë të dhënë hua** Vlera e likuiditetit e garancisë (kolateralit) të dhënë hua, do të raportohet në kolonën 080. Për aktivet likuide, vlera e likuiditetit do të reflektojë vlerën e aktivit pas zbatimit të *haircut*-it përkatës. *Haircut*-i që do të zbatohet, do të lidhet me *haircut*-in e zbatuar për aktivin përkatës në formularin F1. *Haircut*-i i përdorur do të përcaktohet nga vetë banka, por në çdo rast banka do të marrë në konsideratë *haircut*-et përkatëse standarde minimale të parashikuara në kreun III të rregullores.
090	**Vetëm për derivativët e kolateralizuar: vlera e tregut të garancisë së marrë hua** Vlera e tregut të garancisë së marrë hua, do të raportohet në kolonën 090. Vlera e tregut do të reflektojë vlerën aktuale të tregut, para zbatimit të *haircut*-eve dhe pas marrjes në konsideratë të flukseve që do të rezultonin nga përfundimi i mbrojtjes (*hedge*), të lidhur me të (neni 9, pika 8 e rregullores).
100	**Vetëm për derivativët e kolateralizuar: vlera e likuiditetit të garancisë së marrë hua** Vlera e likuiditetit e garancisë (kolateralit) së marrë hua, do të raportohet në kolonën 100. Për aktivet likuide, vlera e likuiditetit do të reflektojë vlerën e aktivit pas zbatimit të *haircut*-it përkatës. *Haircut*-i që do të zbatohet, do të lidhet me *haircut*-in e zbatuar për aktivin përkatës në formularin F1. *Haircut*-i i përdorur do të përcaktohet nga vetë banka, por në çdo rast banka do të marrë në konsideratë *haircut*-et përkatëse standarde minimale të parashikuara në kreun II të rregullores.

Udhëzime në lidhje me rreshtat specifikë

Rreshti	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
010	**1. *Collateral swaps* dhe derivativët e kolateralizuar totale** *Neni 23, pika 5 dhe neni 26, pika 3 e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, për secilën kolonë, totalin e vlerës së *collateral swaps* dhe derivativëve të kolateralizuar.
020	**1.1 Totali i transaksioneve, në të cilat janë dhënë hua aktive të nivelit 1 dhe janë marrë hua kolateralet e mëposhtme:** *Neni 23, pika 5 dhe neni 26, pika 3 e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, për secilën kolonë, totalin e vlerës së *collateral swaps* dhe derivativëve të kolateralizuar, për transaksionet në të cilat janë dhënë hua aktive të nivelit 1.
030	**1.1.1 Aktive të nivelit 1** Në këto transaksione, banka ka këmbyer (ka dhënë hua) aktive të nivelit 1 me aktive të tjera të nivelit 1 (të marra hua).
040	**1.1.2 Aktive të nivelit 2A** Në këto transaksione, banka ka këmbyer (ka dhënë hua) aktive të nivelit 1 me aktive të nivelit 2A (të marra hua).
050	**1.1.3 Aktive të nivelit 2B** Në këto transaksione, banka ka këmbyer (ka dhënë hua) aktive të nivelit 1 me aktive të nivelit 2B (të marra hua).
060	**1.1.4 Aktive jolikuide** Në këto transaksione, banka ka këmbyer (ka dhënë hua) aktive të nivelit 1 me aktive jolikuide (të marra hua).
070	**1.2 Totali i transaksioneve në të cilat janë dhënë hua aktive të nivelit 2A dhe janë marrë hua kolateralet e mëposhtme:** *Neni 23, pika 5 dhe neni 26, pika 3 e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, për secilën kolonë, totalin e vlerës së *collateral swaps* dhe derivativëve të kolateralizuar, për transaksionet në të cilat janë dhënë hua aktive të nivelit 2A.
080	**1.2.1 Aktive të nivelit 1** Në këto transaksione, banka ka këmbyer (ka dhënë hua) aktive të nivelit 2A, me aktive të nivelit 1 (të marra hua).
090	**1.2.2 Aktive të nivelit 2A** Në këto transaksione, banka ka këmbyer (ka dhënë hua) aktive të nivelit 2A, me aktive të tjera të nivelit 2A (të marra hua).
100	**1.2.3 Aktive të nivelit 2B** Në këto transaksione, banka ka këmbyer (ka dhënë hua) aktive të nivelit 2A, me aktive të nivelit 2B (të marra hua).
110	**1.2.4 Aktive jolikuide** Në këto transaksione, banka ka këmbyer (ka dhënë hua) aktive të nivelit 2A, me aktive jolikuide (të marra hua).
120	**1.3 Totali i transaksioneve në të cilat janë dhënë hua aktive të nivelit 2B dhe janë marrë hua kolateralet e mëposhtme:** *Neni 23, pika 5 dhe neni 26, pika 3 e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, për secilën kolonë, totalin e vlerës së *collateral swaps* dhe derivativëve të kolateralizuar, për transaksionet në të cilat janë dhënë hua aktive të nivelit 2B.
130	**1.3.1 Aktive të nivelit 1** Në këto transaksione, banka ka këmbyer (ka dhënë hua) aktive të nivelit 2B me aktive të

	nivelit 1 (të marra hua).
140	**1.3.2 Aktive të nivelit 2A** Në këto transaksione, banka ka këmbyer (ka dhënë hua) aktive të nivelit 2B me aktive të nivelit 2A (të marra hua).
150	**1.3.3 Aktive të nivelit 2B** Në këto transaksione, banka ka këmbyer (ka dhënë hua) aktive të nivelit 2B me aktive të tjera të nivelit 2B (të marra hua).
160	**1.3.4 Aktive jolikuide** Në këto transaksione, banka ka këmbyer (ka dhënë hua) aktive të nivelit 2B me aktive jolikuide (të marra hua).
170	**1.4 Totali i transaksioneve në të cilat janë dhënë hua aktive jolikuide dhe janë marrë hua kolateralet e mëposhtme:** *Neni 23, pika 5 dhe neni 26, pika 3 e rregullores* Banka raporton në këtë rresht, për secilën kolonë, totalin e vlerës së *collateral swaps* dhe derivativëve të kolateralizuar, për transaksionet në të cilat janë dhënë hua aktive jolikuide.
180	**1.4.1 Aktive të nivelit 1** Në këto transaksione, banka ka këmbyer (ka dhënë hua) aktive jolikuide me aktive të nivelit 1 (të marra hua).
190	**1.4.2 Aktive të nivelit 2A** Në këto transaksione, banka ka këmbyer (ka dhënë hua) aktive jolikuide me aktive të nivelit 2A (të marra hua).
200	**1.4.3 Aktive të nivelit 2B** Në këto transaksione, banka ka këmbyer (ka dhënë hua) aktive jolikuide me aktive të nivelit 2B (të marra hua).
210	**1.4.4 Aktive jolikuide** Në këto transaksione, banka ka këmbyer (ka dhënë hua) aktive jolikuide me aktive të tjera jolikuide (të marra hua).
Zëra memorandumi	
220	**2. *Collateral swaps* totale (përfshirë të gjitha kundërpartitë), ku kolaterali i marrë hua, është përdorur për të mbuluar pozicionet e shkurtra** Banka raporton në këtë rresht, totalin e *collateral swaps* (me të gjitha kundërpartitë) të raportuara në rreshtat e mësipërm, ku kolaterali i marrë hua është përdorur për të mbuluar pozicionet e shkurtra, për të cilat ka zbatuar një normë të flukseve dalëse prej 0%.
230	**3. *Collateral swaps* totale me kundërparti, subjektet e grupit** Banka raporton në këtë rresht, totalin e *collateral swaps* të raportuara në rreshtat e mësipërm, të kryera me kundërparti, subjektet e grupit.
240	**4. *Collateral swaps* totale me kundërparti, bankat qendrore** Banka raporton në këtë rresht, totalin e *collateral swaps* me kundërparti bankat qendrore, të raportuara në rreshtat e mësipërm, për të cilat ka zbatuar një normë të flukseve dalëse prej 0%.

FORMULARI F5: PËRLLOGARITJET

Shënime të përgjithshme

1. Formulari F5 është një formular përmbledhës, i cili përmban informacion mbi llogaritjet për qëllime të raportimit të raportit të mbulimit me likuiditet, siç përcaktohet në këtë rregullore. Qelizat që nuk është e nevojshme të plotësohen nga banka, janë të shënuara me ngjyrë gri në formular.

Shënime specifike

2. Referencat e qelizave paraqiten në formatin: {formulari; rreshti; kolona}. Për shembull {F1; rr 130; k 040} i referohet formularit F1 – Aktive Likuide; rreshti 130; kolona 040.

Udhëzime në lidhje me rreshtat specifikë

Rreshti	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
PËRLLOGARITJET	
Numëruesi, emëruesi, raporti *Neni 5 i rregullores* Numëruesi, emëruesi dhe raporti i mbulimit me likuiditet Banka plotëson të dhënat e mëposhtme, në kolonën 010.	
010	**1. Rezerva e likuiditetit** Banka raporton vlerën nga {F5; rr 200; k 010}.
020	**2. Flukset dalëse neto** Banka raporton vlerën nga {F5; rr 230; k 010}.
030	**3. Raporti i mbulimit me likuiditet (%)** Banka raporton raportin e mbulimit me likuiditet, të përllogaritur sipas nenit 5 të rregullores. Raporti i mbulimit me likuiditet është raporti i rezervës së likuiditetit të bankës, me flukset dalëse neto të likuiditetit, gjatë një periudhe stresi prej 30 ditësh kalendarike dhe duhet të shprehet në përqindje.
Përllogaritjet e numëruesit	
Neni 14 dhe aneksi 1 i rregullores Formula për llogaritjen e rezervës së likuiditetit. **Rezerva e likuiditetit** = *aktivet e nivelit 1 + aktivet e nivelit 2A + aktivet e nivelit 2B – rregullimet për cap-in 15% – rregullimet për cap-in 40%* Banka plotëson të gjitha të dhënat, në kolonën 010 të rreshtit përkatës.	
040	**4. Aktivet e nivelit 1 (vlera sipas nenit 10): të parregulluara** Banka raporton vlerën e aktiveve totale të nivelit 1 të parregulluara, nga formulari F1.
050	**5. Flukset dalëse nga kolaterali në formën e aktiveve të nivelit 1, brenda 30 ditëve** Banka raporton flukset dalëse nga kolateralet (garancitë) në formën e aktiveve të nivelit 1, të përfshira në transaksionet e financimit të garantuar, transaksionet e huadhënies së kolateralizuar, transaksionet e *collateral swaps* ose transaksionet e derivativëve të kolateralizuar, që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike.
060	**6. Flukset hyrëse nga kolaterali në formën e aktiveve të nivelit 1, brenda 30 ditëve** Banka raporton flukset hyrëse nga kolateralet (garancitë) në formën e aktiveve të nivelit 1, të përfshira në transaksionet e financimit të garantuar, transaksionet e huadhënies së kolateralizuar, transaksionet e *collateral swaps,* ose transaksionet e derivativëve të kolateralizuar, që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike.
070	**7. Flukset dalëse në *cash* brenda 30 ditëve, nga transaksionet e garantuara** Banka raporton flukset dalëse në *cash* (aktiv i nivelit 1), të përfshira në transaksionet e financimit të garantuar, transaksionet e huadhënies së kolateralizuar, transaksionet e *collateral swaps* ose transaksionet e derivativëve të kolateralizuar, që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike.

080	**8. Flukset hyrëse në *cash* brenda 30 ditëve, nga transaksionet e garantuara** Banka raporton flukset hyrëse në *cash* (aktiv i nivelit 1), të përfshira në transaksionet e financimit të garantuar, transaksionet e huadhënies së kolateralizuar, transaksionet e *collateral swaps* ose transaksionet e derivativëve të kolateralizuar, që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike.
090	**9. Aktivet e nivelit 1 (vlera e rregulluar, para llogaritjes së *cap*-it)** Banka raporton në këtë rresht, shumën e aktiveve të nivelit 1 të rregulluar, përpara llogaritjes së *cap*-it. Shuma e rregulluar merr parasysh transaksionet e financimit të garantuar, transaksionet e huadhënies së kolateralizuar, transaksionet e *collateral swaps,* ose transaksionet e derivativëve të kolateralizuar, që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike.
100	**10. Aktivet e nivelit 2A (vlera sipas nenit 10): të parregulluara** Banka raporton vlerën e aktiveve totale të nivelit 2A të parregulluara, nga formulari F1.
110	**11. Flukset dalëse nga kolaterali në formën e aktiveve të nivelit 2A, brenda 30 ditëve** Banka raporton flukset dalëse nga kolateralet (garancitë) në formën e aktiveve të nivelit 2A, të përfshira në transaksionet e financimit të garantuar, transaksionet e huadhënies së kolateralizuar, transaksionet e *collateral swaps* ose transaksionet e derivativëve të kolateralizuar, që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike.
120	**12. Flukset hyrëse nga kolaterali në formën e aktiveve të nivelit 2A, brenda 30 ditëve** Banka raporton flukset hyrëse nga kolateralet (garancitë) në formën e aktiveve të nivelit 2A, të përfshira në transaksionet e financimit të garantuar, transaksionet e huadhënies së kolateralizuar, transaksionet e *collateral swaps* ose transaksionet e derivativëve të kolateralizuar, që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike.
130	**13. Aktivet e nivelit 2A (vlera e rregulluar, para llogaritjes së *cap*-it)** Banka raporton në këtë rresht, shumën e aktiveve të nivelit 2A të rregulluar, përpara llogaritjes së *cap*-it. Shuma e rregulluar merr parasysh transaksionet e financimit të garantuar, transaksionet e huadhënies së kolateralizuar, transaksionet e *collateral swaps* ose transaksionet e derivativëve të kolateralizuar, që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike.
140	**14. Aktivet e nivelit 2B (vlera sipas nenit 10): të parregulluara** Banka raporton vlerën e aktiveve totale të nivelit 2B të parregulluara, nga formulari F1.
150	**15. Flukset dalëse nga kolaterali në formën e aktiveve të nivelit 2B, brenda 30 ditëve** Banka raporton flukset dalëse nga kolateralet (garancitë) në formën e aktiveve të nivelit 2B, të përfshira në transaksionet e financimit të garantuar, transaksionet e huadhënies së kolateralizuar, transaksionet e *collateral swaps* ose transaksionet e derivativëve të kolateralizuar, që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike.
160	**16. Flukset hyrëse nga kolaterali në formën e aktiveve të nivelit 2B, brenda 30 ditëve** Banka raporton flukset hyrëse nga kolateralet (garancitë) në formën e aktiveve të nivelit 2B, të përfshira në transaksionet e financimit të garantuar, transaksionet e huadhënies së kolateralizuar, transaksionet e *collateral swaps* ose transaksionet e derivativëve të kolateralizuar, që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike.
170	**17. Aktivet e nivelit 2B (vlera e rregulluar, para llogaritjes së *cap*-it)** Banka raporton në këtë rresht, shumën e aktiveve të nivelit 2B të rregulluar, përpara llogaritjes së *cap*-it. Shuma e rregulluar merr parasysh transaksionet e financimit të garantuar, transaksionet e huadhënies së kolateralizuar, transaksionet e *collateral swaps* ose transaksionet e derivativëve të kolateralizuar, që maturohen brenda 30 ditëve kalendarike.

180	**18. Rregullimet për *cap*-in 15%** Banka raporton në këtë rresht, vlerën që rezulton nga përllogaritjet sipas formulës së mëposhtme: Rregullimet për *cap*-in 15% = Max (aktiveve të rregulluara të nivelit 2B – 15/85*(aktivet e rregulluara të nivelit 1 + aktivet e rregulluara të nivelit 2A), aktive të rregulluara të nivelit 2B - 15/60* aktivet e rregulluara të nivelit 1, 0)
190	**19. Rregullimet për *cap*-in 40%** Banka raporton në këtë rresht, vlerën që rezulton nga përllogaritjet sipas formulës së mëposhtme: **Rregullimet për *cap*-in 40%** = Max (aktivet e rregulluara të nivelit 2A + aktivet e rregulluara të nivelit 2B – rregullimet për *cap*-in 15%) - 2/3* aktivet e rregulluara të nivelit 1, 0)
200	**20. Rezerva e likuiditetit** Banka raporton në këtë rresht, rezervën e likuiditetit e cila llogaritet: Rezerva e likuiditetit = a) aktivet e nivelit 1 (vlera e rregulluar, para llogaritjes së *cap*-it); plus b) aktivet e nivelit 2A (vlera e rregulluar, para llogaritjes së *cap*-it); plus c) aktivet e nivelit 2B (vlera e rregulluar, para llogaritjes së *cap*-it) minus: d) rregullimet për *cap*-in 15%; e) rregullimet për *cap*-in 40%.
	Përllogaritjet e emëruesit
	Aneksi 2 i rregullores Formula për përllogaritjen e flukseve dalëse neto të likuiditetit. Banka plotëson të gjitha të dhënat, në kolonën 010 të rreshtit përkatës. *FD = flukse dalëse* *FH = flukse hyrëse* *FDN = flukse dalëse neto*
210	**21. Flukset dalëse totale** Banka raporton vlerën e flukseve dalëse totale, nga formulari F2.
220	**22. Flukset hyrëse subjekt i cap-it 75%** Banka raporton vlerën e flukseve hyrëse totale, nga formulari F3.
230	**23. Flukset dalëse neto** Banka raporton në këtë rresht, vlerën e flukseve dalëse neto që rezulton nga përllogaritjet sipas formulës së mëposhtme: **Flukset dalëse neto të likuiditetit =** totali i flukseve dalëse – Min (Totali i flukseve hyrëse; 0.75* Totali i flukseve dalëse)

VENDIM
Nr. 33, datë 3.4.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË USHTRIMIT TË KOMPETENCAVE NË BANKËN E SHQIPËRISË PËR RIMËKËMBJEN DHE NDËRHYRJEN E JASHTËZAKONSHME NË BANKA"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 6, pika 6, të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë", si dhe nenet 10, 11, 12 dhe 15, të Statutit të Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 90, datë 2.12.2015, me propozim të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme dhe të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për përcaktimin e nivelit të ushtrimit të kompetencave në Bankën e Shqipërisë për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Sejko

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i organeve të brendshme të Bankës së Shqipërisë dhe i drejtuesve të njësive organizative të saj, të cilët nxjerrin aktet administrative individuale në zbatim të kompetencave të Bankës së Shqipërisë, sipas ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë " (më poshtë referuar si "ligji nr. 133/2016").

Neni 2
Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ushtron kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:

a) merr vendim për vendosjen e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme sipas nenit 21, pika 1, të ligjit nr. 133/2016;

b) përcakton përdorimin e "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme", sipas nenit 74, pika 1 (me përjashtim të germës "f") dhe pika 4, të ligjit nr. 133/2016;

c) vendos për pagimin e kontributeve të jashtëzakonshme, bazuar në nenin 77, pika 1, të ligjit nr. 133/2016,

d) pezullon pagesën e kontributit të jashtëzakonshëm, sipas nenit 77, pika 5, të ligjit nr. 133/2016;

e) vendos për zgjatjen e afatit fillestar për mbledhjen e kontributeve të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme", sipas nenit 75, pika 2, të ligjit nr. 133/2016;

f) vendos për transferimin nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave të fondit të kompensimit të depozitave të siguruara pranë Bankës së Shqipërisë gjatë zbatimit të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në bazë të nenit 78, pika 1, e ligjit nr. 133/2016;

g) vendos për zhvlerësimin ose konvertimin e instrumenteve të kapitalit përpara ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas nenit 45, pika 1, e ligjit nr. 133/2016;

h) vendos për emetimin e instrumenteve të kapitalit bazë të nivelit të parë për zotëruesit e instrumenteve përkatëse të kapitalit, sipas nenit 46, pika 3, të ligjit nr. 133/2016;

i) vendos për zbatimin e instrumentit të shitjes së aktivitetit tregtar, sipas nenit 26, pika 1 dhe nenit 27, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 133/2016;

j) vendos për krijimin e bankës urë, sipas nenit 28, pikat 1, 10, 11, 12, të ligjit nr. 133/2016, që përmban:

i. aksionet ose instrumentet e tjera të pronësisë, aktivet, të drejtat dhe detyrimet e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme që do të transferohen te banka urë;

ii. miratimin e statutit të bankës urë;

iii. emërimin (shkarkimin) e administratorëve të bankës urë;

iv. strategjinë e biznesit dhe profilin e rrezikut të bankës urë;

k) vendos për transferimin, sipas nenit 28, pikat 7 dhe 8, të ligjit nr. 133/2016:

i. të të drejtave, aktiveve ose detyrimeve nga banka urë te banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose aksionet apo instrumentet e tjera të pronësisë te zotëruesit e tyre fillestarë;

ii. të aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë ose aktivet, të drejta apo detyrimet nga banka urë te një palë e tretë;

l) vendos për përfundimin e aktivitetit të bankës urë, sipas nenit 28, pika 14, të ligjit nr. 133/2016;

m) përcakton shumën e rikapitalizimit nga brenda (zhvlerësimi ose konvertimi) sipas nenit 33, pika 1, të ligjit nr. 133/2016;

n) vendos për kryerjen e rivlerësimit të shumës së rikapitalizimit nga brenda pas vlerësimit përfundimtar, sipas nenit 33, pika 4, e ligjit nr. 133/2016;

o) vendos për anulimin, transferimin dhe zvogëlimin e aksioneve të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, sipas nenit 34, pika 1, të ligjit nr. 133/2016;

p) vendos për përfundimin e detyrimeve e marrëveshjeve mbi produktet derivative, sipas nenit 36, pika 2, të ligjit nr. 133/2016;

q) vendos për zbatimin e raportit të konvertimit të detyrimeve në kapital, sipas nenit 37, të ligjit nr. 133/2016;

r) vendos për zbatimin e instrumentit të ndarjes së aktiveve, sipas neni 29, pika 1, të ligjit nr. 133/2016;

s) vendos për krijimin e shoqërisë së administrimit të aktiveve, sipas nenit 29, pikat 5 dhe 6, të ligjit nr. 133/2016;

t) vendos për rikthimin e aktiveve dhe detyrimeve nga shoqëria e administrimit të aktiveve drejt bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, sipas nenit 29, pika 7, të ligjit nr. 133/2016;

u) vendos për zbatimin e vendimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të autoriteteve të huaja pa marrëveshje bashkëpunimi, sipas nenit 70, pika 7, të ligjit nr. 133/2016.

Neni 3

Kompetencat e administratorit përgjegjës për mbikëqyrjen

Administratori përgjegjës për mbikëqyrjen ushtron kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:

a) urdhëron bankën, bazuar në nenin 8, pika 6, të ligjit nr. 133/2016:

i. të ulë nivelin e rrezikut, përfshirë rrezikun e likuiditetit;

ii. të mundësojë marrjen në kohë të masave për rikapitalizim;

iii. të rishikojë strategjinë dhe strukturën e saj të veprimtarive kryesore,

iv. të bëjë ndryshime në strategjinë e financimit, në mënyrë që të përmirësojë aftësinë për rimëkëmbje të veprimtarive kryesore e të funksioneve me rëndësi kritike;

v. të bëjë ndryshime në strukturën e drejtimit të brendshëm të saj;

b) urdhëron administratorin e përkohshëm për mbledhjen e asamblesë së aksionarëve të bankës me qëllim rritjen e kapitalit, bazuar në nenin 19, pika 9, të ligjit nr. 133/2016;

c) urdhëron vendosjen e sanksioneve dhe gjobave, sipas nenit 80, pika 1, shkronjat "a" dhe "c", të ligjit nr. 133/2016;

d) merr vendim për emërimin e një ose disa administratorëve të përkohshëm, sipas nenit 19, pika 1, të ligjit nr. 133/2016.

Neni 4

Kompetencat e administratorit përgjegjës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme

Administratori përgjegjës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme ushtron kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:

a) urdhëron bankën sipas nenit 40, pika 2, të ligjit nr. 133/2016, të kryejë:

i. ndryshime në regjistrat publikë përkatës;

ii. pezullimin e përkohshëm të tregtimit, heqjen nga tregtimi apo listimi të aksioneve apo titujve të borxhit në një treg të rregulluar;

iii. listimin e aksioneve të reja ose instrumenteve të tjera të pronësisë në një treg të rregulluar;

iv. rilistimin në një treg të rregulluar të titujve të borxhit që janë zhvlerësuar pa qenë nevoja e publikimit të një prospekti;

b) urdhëron bankën të hartojë planin e riorganizimit të aktivitetit tregtar, vlerëson zbatimin e tij, si dhe kryerjen e ndryshimeve të tjera të këtij plani, sipas nenit 39, pikat 1, 2 dhe 5, të ligjit nr. 133/2016;

c) vendos sanksione dhe gjoba, sipas nenit 80, pika 1 (përveç shkronjave "a" dhe "c"), të ligjit nr. 133/2016;

d) miraton politikën e investimit të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme", sipas nenit 73, pika 1, të ligjit nr. 133/2016;

e) vendos për përdorimin e "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme", sipas nenit 74, pika 1, shkronja "f", të ligjit nr. 133/2016;

f) urdhëron pagimin e kontributeve vjetore në "Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme", sipas nenit 76, pika 1, të ligjit nr. 133/2016;

g) miraton kriteret për përzgjedhjen e audituesit të "Fondit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme", sipas nenit 79, pika 4, të ligjit nr. 133/2016;

h) miraton planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas nenit 12, të ligjit nr. 133/2016;

i. urdhëron bankën, sipas nenit 23, pikave 1, 4, 6, 13, 14, të ligjit nr. 133/2016, për:

i. emërimin e administratorit të posaçëm;

ii. zgjatjen e afatit të emërimit të administratorit të posaçëm;

iii. zëvendësimin e administratorit të posaçëm;

iv. dhënien e miratimit paraprak të funksioneve dhe të drejtave të administratorit;

v. vendosjen e kufizimeve dhe të drejtave të administratorëve;

j) urdhëron bankën, sipas nenit 48, pika 1 shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d", "dh", të ligjit nr. 133/2016, për:

i. kryerjen e ndonjë transferimi pa ndonjë detyrim ose barrë;

ii. heqjen e të drejtës së bankës për të zotëruar aksione të tjera;

iii. autoritetin përkatës të ndërpresë apo pezullojë pranimin për tregtim;

iv. përcaktimin që marrësi të trajtohet sikur të ishte objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

v. anulimin ose ndryshimin e kushteve të kontratave ose të sigurohet që marrësi merr vendin e tij si palë;

k) urdhëron vazhdimin e aktivitetit tregtar të transferuar nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme te një subjekt tjetër (që marrësi të marrë të drejtat dhe detyrimet, si dhe zëvendësimin e tyre në çdo procedurë ligjore), sipas nenit 48, pika 2, shkronjat "a" dhe "b", të ligjit nr. 133/2016;

l) urdhëron ofrimin e shërbimeve dhe sigurimin e infrastrukturës nga banka, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas nenit 49 të ligjit nr. 133/2016;

m) urdhëron pezullimin e pagesave dhe shlyerjen e detyrimeve, të cilat lindin nga një kontratë në të cilën banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme është palë, sipas nenit 52, pika 1, të ligjit nr. 133/2016;

n) urdhëron pezullimin e ekzekutimit nga kreditorët mbi pasuritë e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, të cilat shërbejnë si mjete që sigurojnë ekzekutimin e detyrimeve, sipas nenit 53, pika 1, të ligjit nr. 133/2016;

o) urdhëron pezullimin e përkohshëm të së drejtës për zgjidhjen e kontratës nga palë të treta, të cilat mund të kenë marrëdhënie kontraktore me bankën në ndërhyrje të jashtëzakonshme, sipas nenit 54, pika 1, të ligjit nr. 133/2016;

p) emëron vlerësuesin për kryerjen e vlerësimit për të informuar për plotësimin e kushteve për ndërhyrje të jashtëzakonshme ose të vlerësimit të përkohshëm, sipas nenit 24, pikat 3 dhe 11, të ligjit nr. 133/2016;

q) emëron vlerësuesin për kryerjen e vlerësimit për të informuar vendimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme ose të vlerësimit të përkohshëm nga Banka e Shqipërisë, sipas nenit 24, pikat 5 dhe 11, të ligjit nr. 133/2016;

r) emëron vlerësuesin për kryerjen e vlerësimit pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme sipas nenit 57, pika 1, të ligjit nr. 133/2016;

s) kërkon pezullimin e proceseve gjyqësore në të cilat banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme

është palë pranë gjykatës kompetente, sipas nenit 69, të ligjit nr. 133/2016;

t) nënshkruan marrëveshjet e bashkëpunimit me autoritetet përgjegjëse për ndërhyrjen e jashtëzakonshme të vendeve të tjera.

Neni 5

Kompetencat e drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes

Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes ushtron kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:

a) kërkon përditësimin më të shpeshtë nga banka të planit të rimëkëmbjes, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit nr.133/2016;

b) njofton lejimin e paraqitjes së planeve të thjeshtuara të rimëkëmbjes për disa banka, sipas nenit 7, pika 6, të ligjit nr. 133/2016;

c) vlerëson planet e rimëkëmbjes së bankave, kërkon rishikimin e planit të rimëkëmbjes për korrigjimin e mangësive, kërkon plotësimin e ndryshimeve specifike, sipas nenit 8, pikave 1, 2, 3 dhe 4, të ligjit nr. 133/2016;

d) i kërkon bankës rishikimin e veprimtarisë së saj, për të trajtuar mangësitë ose pengesat për zbatimin e planit të rimëkëmbjes, sipas nenit 8, pika 5, të ligjit nr. 133/2016;

e) i kërkon bankës të marrë një ose disa nga masat e ndërhyrjes së hershme, sipas nenit 17, pika 1, të ligjit nr. 133/2016;

f) urdhëron bankën të shkarkojë nga detyra një ose disa prej administratorë të saj, anëtarë të këshillit drejtues dhe/ose të drejtorisë dhe të emërojë administratorë të rinj sipas nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 133/2016.

Neni 6

Kompetencat e drejtorit të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme

Drejtori i Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme ushtron kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:

a) urdhëron mbledhjen e informacionit nga banka dhe dega e bankës së huaj për planifikimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas nenit 12, pika 5, të ligjit nr.133/2016;

b) urdhëron heqjen e pengesave nga banka dhe dega e bankës së huaj, sipas nenit 15, pika 5, të ligjit nr. 133/2016;

c) urdhëron heqjen e pengesave nëse veprimet e bankës janë të pamjaftueshme, sipas nenit 15, pika 6, të ligjit nr. 133/2016;

d) i paraqet kërkesë asamblesë së aksionarëve të bankës për rritjen e kapitalit aksionar për të hequr pengesat për rikapitalizimin nga brenda, sipas nenit 41, pika 1, të ligjit nr. 133/2016;

e) i kërkon bankës të paraqesë një opinion ligjor nga studio ligjore ndërkombëtare për zbatueshmërinë e dispozitave kontraktore të rikapitalizimit nga brenda (instrumente të qeverisura nga ligji i huaj), sipas nenit 42, pika 4, të ligjit nr. 133/2016;

f) i paraqet kërkesë bankave për të mbajtur në çdo kohë autorizimin paraprak për të emetuar numrin përkatës të instrumenteve të kapitalit të zakonshëm të nivelit të parë, sipas nenit 46, pika 4, të ligjit nr. 133/2016;

g) i paraqet kërkesë bankës apo degës së bankës së huaj për mbledhje informacioni për qëllimet e përcaktimit të kërkesës minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuara, sipas nenit 32, pika 1, të ligjit nr. 133/2016;

h) urdhëron plotësimin në cilësi dhe sasi të kërkesës minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuara mbi baza individuale dhe të konsoliduara (e brendshme dhe e jashtme), sipas nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 133/2016;

i) urdhëron marrje informacioni për qëllimet e planifikimit dhe zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, bazuar në nenin 47, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 133/2016.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 700 lekë